

Qershor 2020
Numri: 147
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA

QETËESIA

në Familje




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Në shumë shoqëri është vënë në rrezik vetë ekzistenca e familjes, kurse në disa shoqëri të tjera, duke përfshirë edhe shoqërinë islame, vihet re një çorientim i koordinatave të përcaktuara nga Kurani.

Në vend që të jetë burim qetësie, familja është shndërruar në burim zënkash, grindjesh, krizash dhe divorcesh.

Kjo gjendje është tregues i qartë i humbjes së dashurisë dhe mëshirës në familje. Kjo gjendje në fakt është tregues edhe i një problemi tjetër më të madh, kjo gjendje tregon që ka probleme në marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e gjithësisë, burimin e mëshirës dhe dashurisë.

Në momentin që marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin dobësohen, atëherë fillojnë problemet. Kjo është e vlefshme si për familjen, ashtu edhe për shoqërinë.

Është gabim i madh të mendosh që këto probleme nuk kanë lidhje me marrëdhënien e njeriut me Krijuesin.

Sepse dashuria dhe mëshira që ne kemi, burojnë prej emrave të bukur të Allahut, “El Vedud” dhe “Er Rahman. Er Rahim”.

Nëse dëshirojmë që në familjet tona të mbjellim dashurinë dhe mëshirën, jemi të detyruar të lidhemi me burimin e tyre.

Por cila është pika lidhëse e njeriut me burimin e dashurisë dhe mëshirës? Pika lidhëse është ibadeti.

Pra, për të krijuar një atmosferë dashurie, dhembshurie dhe mëshire në familje, nuk duhet harruar në asnjë mënyrë ibadeti ndaj Allahut.

Familja nuk duhet shndërruar në një arenë për sundim dhe pushtet. Familja është mjedisi ku gjithësecili është në statusin e adhuruesit. Në fakt, gjithë jeta shoqërore është e tillë. Të gjithë njerëzit, si i pasuri, i varfri, i shëndetshmi, i sëmuri, sunduesi, i sunduari etj., me gjithë statusin e veçantë që mund të kenë në shoqëri, përballë Allahut janë në statusin e adhuruesit.

Nëse ndërgjegjësimi për ibadetin vendoset në zemër, realizohet edhe diçka tjetër, siç është vetëdija për mbikëqyrjen hyjnore. Pra, njeriu fillon të jetojë me vetëdijen e plotë sikur e shikon Allahun. Pas kësaj, njeriu hyn në garë për të fituar dashurinë dhe pëlqimin e Allahut.

Vetëdijësimi për ibadetin lind ndjeshmërinë për respektimin e të drejtave të tjetrit.

Respektimi i të drejtave të tjetrit në mjedisin familjar është neglizhuar. Mirëpo, e vërteta është se çdo fjalë e rëndë, fyerje apo përdorim force ndaj njëri-tjetrit është objekt i gjykimit hyjnor. Dhe përballë gjykimit hyjnor nuk ka dallim midis femrës dhe mashkullit.

Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për një shoqëri që mendon thellë.

Për të arritur qetësinë në familje, është e domosdoshme dashuria dhe mëshira. Nga ajeti kuptojmë që Allahu e ka krijuar njeriun të aftë dhe të prirur për të dashur dhe mëshiruar. Po ashtu, nga ajeti kuptojmë që, kur hyhet nën çatinë e familjes, Allahu e rrit përqendrimin e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Pra, njeriu që bën përpjekje për përmbushjen e qëllimit hyjnor, patjetër që do të drejtohet nga dashuria dhe mëshira. Kurse mungesa e dashurisë dhe mëshirës në familje sjell ndërprerjen e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Qershor 2020

VITI: XIV

NUMRI: 147

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja

Bukuria e delikatesës
Dr. Adem Ergyl

16



10

Martesa dhe divorci
Mehmet Dinç



Kurani
Mesut Kaja

20



24



34

Lumturia familjare
Në jetën e dy botëve
Osman Nuri Topbash

- 5 Qetësia në familje
Ahmet Tashgetiren
- 7 Kriza në familje
A. Jasin Demirxhi
- 13 Nivelet shpirtërore
Sadik Dana
- 14 Çfarë është thelbësore për lumturinë?
Ali Riza Temel
- 19 Gjëra të mrekullueshme
Mehmet Xhoshar
- 24 Xhemati, pasuria më e shtrenjtë e imamit
Doç. dr. Fikret Karaman
- 26 Realiteti i njeriut në vijën e pafund të plusëve dhe minuseve
Dr. Adem Ergyl
- 29 Singëriteti i zemrës dhe i gjuhës
Mustafa Erish



48

Dy fytyrat e vdekjes 30

Xhemal Nar

Një Ajet - Një Hadith 32

Ndihma e Allahut dhe e engjëjve të Tij
për besimtarët sipas Kuranit 38

Doç. dr. Kerim Bulladë

Morali i bukur dhe modeli 42

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Vraponi pas mëshirës së Allahut 44

Idris Arpat

Të përfitosh nga ibadeti 46

Rabia Christine Brodbeck

Kjo botë 48

Nuredin Jëlldëz

Urtësia në historitë e Kuranit Fisnik 50

Nuredin Jëlldëz

Mos mendo kurrë se Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit 54

Prof. dr. Omer Çelik

40



Sfidat e myslimanit me modernitetin
në procesin e globalizimit
Emre Topollu

Çfarë qenieje është djalli
dhe si e mashtron njeriun
Abdurrahim Somunxhu

52





Qetësia në familje

— Ahmet Tashgetiren —

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rrum, 21)

Si çdo gjë tjetër edhe marrëdhënia bashkëshortore është një nga mirësitë e shumta dhuruar njeriut nga ana e Krijuesit të gjithësisë.

Sepse është Ai, që krijoi njeriun çift.

Është Ai që mbolli dashurinë në zemrat e njeri-tjetrit.

Është Ai që gdhendi mëshirën në qeniet e tyre.

Në këtë mënyrë, ata bashkëshortët arritën qetësinë dhe lumturinë bashkëshortore dhe familjare.

Familja është një institucion shumë i rëndësishëm, mbarëvajtja e të cilit i intereson gjithë shoqërisë.

Në të gjitha këto ka mesazhe të qarta për mendimtarët.

Themeli i familjes sipas Islamit, është dashuria, mëshira dhe prehja.

Ajeti kuranor i fton të gjithë të mendojnë dhe reflektojnë thellë mbi familjen.

Nga ajeti kuranor kuptojmë që familja nuk është

një dukuri individuale, që fillon dhe mbaron me një grup të vogël individësh. Përkundrazi, ajo është bërthama e shoqërisë, prej së cilës varet ekzistenca e shoqërisë. Prandaj Kurani e fton shoqërinë të mendojë thellë mbi familjen.

Nëse në familje nuk ka dashuri, por urrejtje, shoqëria duhet të shqetësohet.

Nëse në familje nuk ka mëshirë, por ashpërsi, shoqëria përsëri duhet të shqetësohet.

Nëse familja ka një sëmundje, atëherë shoqëria është e rrishtuar nga kjo sëmundje.

Nëse familja vuan nga ndonjë sëmbim, atëherë duhen rishikuar koordinatat e tri pikave që prek ajeti kuranor.

A KA PROBLEME FAMILJA NË DITËT TONA?

Sigurisht që ka.

Shenjat e sëmundjes së familjes janë të përhapura në të gjitha shoqëritë.

Në shumë shoqëri është vënë në rrezik vetë ekzistenca e familjes, kurse në disa shoqëri të tjera, duke përfshirë edhe shoqërinë islame, vihet re një çorientim i koordinatave të përcaktuara nga Kurani.

Në vend që të jetë burim qetësie, familja është shndërruar në burim zënkash, grindjesh, krizash dhe divorcesh.

Kjo gjendje është tregues i qartë i humbjes së dashurisë dhe mëshirës në familje. Kjo gjendje në fakt është tregues edhe i një problemi tjetër më të madh, kjo gjendje tregon që ka probleme në marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e gjithësisë, burimin e mëshirës dhe dashurisë.

Në momentin që marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin dobësohen, atëherë fillojnë problemet. Kjo është e vlefshme si për familjen, ashtu edhe për shoqërinë.

Është gabim i madh të mendosh që këto probleme nuk kanë lidhje me marrëdhënien e njeriut me Krijuesin.

Sepse dashuria dhe mëshira që ne kemi, burojnë prej emrave të bukur të Allahut, “El Vedud” dhe “Er Rahman, Er Rahim”.

Nëse dëshirojmë që në familjet tona të mbjellim dashurinë dhe mëshirën, jemi të detyruar të lidhemi me burimin e tyre.

Por cila është pika lidhëse e njeriut me burimin e dashurisë dhe mëshirës? Pika lidhëse është ibadeti.

Pra, për të krijuar një atmosferë dashurie, dhembshurie dhe mëshire në familje, nuk duhet harruar në asnjë mënyrë ibadeti ndaj Allahut.

Familja nuk duhet shndërruar në një arenë për sundim dhe pushtet. Familja është mjedisi ku gjithësecili është në statusin e adhuruesit. Në fakt, gjithë jeta shoqërore është e tillë. Të gjithë njerëzit, si i pasuri, i varfri, i shëndetshmi, i sëmuri, sunduesi, i sunduari etj., me gjithë statusin e veçantë që mund të kenë në shoqëri, përballë Allahut janë në statusin e adhuruesit.

Nëse ndërjegjësimi për ibadetin vendoset në zemër, realizohet edhe diçka tjetër, siç është vetëdija për mbikëqyrjen hyjnore. Pra, njeriu fillon të jetojë me vetëdijen e plotë sikur e shikon Allahun. Pas kësaj, njeriu hyn në garë për të fituar dashurinë dhe pëlqimin e Allahut.

Vetëdijësimi për ibadetin lind ndjeshmërinë për respektimin e të drejtave të tjetrit.

Respektimi i të drejtave të tjetrit në mjedisin familjar është neglizhuar. Mirëpo, e vërteta është se çdo fjalë e rëndë, fyerje apo përdorim force ndaj njëri-tjetrit është objekt i gjyqimit hyjnor. Dhe përballë gjyqimit hyjnor nuk ka dallim midis femrës dhe mashkullit.

Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për një shoqëri që mendon thellë.

Për të arritur qetësinë në familje, është e domosdoshme dashuria dhe mëshira. Nga ajeti kuptojmë që Allahu e ka krijuar njeriun të aftë dhe të prirur për të dashur dhe mëshiruar. Po ashtu, nga ajeti kuptojmë që, kur hyhet nën çatinë e familjes, Allahu e rrit përqendrimin e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Pra, njeriu që bën përpjekje për përmbushjen e qëllimit hyjnor, patjetër që do të drejtohet nga dashuria dhe mëshira. Kurse mungesa e dashurisë dhe mëshirës në familje sjell ndërprerjen e dashurisë dhe mëshirës në zemrat e njerëzve.

Një mësim tjetër që nxjerrim nga ajeti, është se martesë është një rrugëtim drejt realizimit të dashurisë dhe mëshirës.

Mbushja e zemrave me dashuri dhe mëshirë duhet të jetë mision i familjes, shkollës, xhamisë, medias etj. Dashuria dhe mëshira duhet të jenë pjesë e programeve edukative. Mbrujtja e zemrave me dashuri dhe mëshirë, do të sjellë manifestim të cilësive hyjnore në qenien tonë.

Nevoja për dashuri dhe mëshirë është e domosdoshme më tepër se kurrë në ditët tona, kur dashuria dhe mëshira midis bashkëshortëve dhe individëve është rrënuar.

Por në dashuri dhe mëshirë duhet të kërkojmë përmasën hyjnore të tyre. Prandaj zemrat duhet të përgatiten, në mënyrë që të jenë të përshtatshme për manifestimin e mëshirës dhe dashurisë.

Gjuha dhe zemra duhet të jenë vazhdimisht në gjendje dhikri dhe lutjeje.

Sepse dashuria dhe mëshira në familje kërkon përpjekje. Për zhvillimin dhe kultivimin e dashurisë dhe mëshirës, bashkëshortët së pari duhet të ndërtojnë ambientin e përshtatshëm për dashurinë dhe mëshirën.

Edhe fëmijët që do të rriten në një ambient plot dashuri, në të ardhmen do të krijojnë familje me bazë dashurinë dhe mëshirën.

Nga kjo pikëpamje, familja është shkolla e dashurisë dhe mëshirës.

Të mos harrojmë se qetësia dhe prehja në familje është një dhuratë hyjnore.

Nëse nuk ia ndërpresim rrugën dashurisë dhe mëshirës, kjo dhuratë patjetër do të arrijë tek ne.

Të mos harrojmë se lumturia e dy botëve fillon prej këtu.

E lusim Allahun të kultivojë në zemrat tona dashurinë dhe mëshirën, me të cilat mund të arrijmë lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër!



KRIZA në Familje

— A. Jasin Demirxhi —

Fakti i ashtuquajtur globalizëm, që sjell me vete shumë probleme bashkë me favorët e saj, është një realitet i pamohueshëm që i ka dhënë frymë perëndimore botës së sotme. Familja që përbën bërthamën e shoqërisë, vjen në krye të institucioneve më të prekura nga ky proces bashkëveprimi dhe transformimi.

Ndërsa trajtojmë çështjen “**edukimi i dashurisë në familje**”, deshëm të shikonim edhe gjendjen e familjes në botën islame. U përpoqëm të vëzhgojm shkatërrimin e globalizimit në institucionin e familjes në botën islame.

Cilat çështje vijnë në rend të ditës, të cilat lidhen me strukturën e familjes në Lindjen e Mesme, që përfshin shumicën dërrmuese të botës islame? Në cilat fusha janë më të fokusuar shqetësimet në këtë kontekst? Çfarë propozojnë ekspertët e fushës dhe akademikët në pikën e zgjidhjes së problemeve që hasen në fushën e familjes? Në mediat Arabe kemi kërkuar përgjigjet e këtyre pyetjeve.

Pamë se gjendja e shteteve në Lindjen e Mesme nuk është shumë e ndryshme nga panorama që shikojmë në vendin tonë. Madje, disa shtete nën

drejtimin e dikujt, janë ballë për ballë me një tablo më serioze se ne.

Pamë se bota islame ka disa probleme të përbashkëta në çështjet, si rritja e shpejtë e raportit të divorceve, rritja mesatare e moshës së martesës, dhuna ndaj grave dhe degjenerimi kulturor që po ndodh pothuajse në të gjitha shtetet e Lindjes së Mesme, duke filluar nga vendet e Gjirit deri në Egjipt, nga shtetet e Afrikës së Veriut deri në Iran.

RAPORTI I FRIKSHËM I DIVORCEVE NË BOTËN ISLAME

Pika që theksohet dhe nënvizohet më shumë në mediat e Lindjes së Mesme, që trajtojnë çështjet e familjes, është rritja e shpejtë e raportit të divorceve. Sidomos në vendet e Gjirit, rritja e raportit të divorceve është e frikshme. Bazuar në statistikat e ofruara nga autoritetet e Kuvajtit, 40 % e martesave zyrtare që u kryen në gjysmën e parë të vitit 2009 në Kuvajt, përfunduan në divorc. Me fjalë të tjera, pothuajse një në dy martesë kishin rezultuar në divorc.

Ndërsa, përsëri sipas shifrave të dhëna për vitin

2009, në Arabinë Saudite, nga 60 mijë ceremoni martesore, 16 mijë prej tyre kanë përfunduar me divorc. Ky raport tregon se në Arabinë Saudite, që njihet si vend konservator, në çdo tri martesa një nuk funksionon, pra shfuqizohet. Raporti i divorceve në Emiratet e Bashkuara Arabe arrin në 44 %, në Katar 30% dhe në Rabat, i cili është kryeqyteti i Marokut, arrin deri në 46%.

Në aspektin ekonomik mund të shohësh një tablo të njëjtë edhe në vendet e tjera të Lindjes së mesme, të cilat janë më të prapambetura se vendet e Gjirit. Për shembull, raporti i divorceve në Egjipt, i cili njihet si vendi më i populluar dhe me popullsi më fetare në rajon, me të vërtetë është shtrirë deri në limite shqetësuese. Sipas të dhënave nga burimet zyrtare të Egjiptit për vitin 2009, 40% e martesave që ndodhën në Egjipt përfunduan me divorc.

Opinioni publik arab, po diskuton tashmë me këmbëngulje arsyet e kësaj rritjeje. Ai po heton shkaqet që shkaktojnë prishjen e martesës si dhe zgjidhjet e tyre. Në lidhje me shkaqet e kësaj rritjeje të shpejtë në raportin e divorceve, renditen disa arsye si, shkatërrimi (*erozioni*) ekonomik, psikologjik, social dhe kulturor.


Ish-anëtar i Fakultetit Juridik në Universitetin Amman të Jordanisë, **Mahmud Sartavi**, një prej juristëve më të shquar në botën arabe, e lidh arsyen e rritjes progresive të divorceve me zbatimin e gabuar dhe arbitrar të legjislacionit islam.

Sipas të dhënave që na jep **Sartavi**, shumica e të divorcuarve në Arabinë Saudite janë maturantë të universiteteve ose gjimnazeve. Sipas studimit, raporti i divorceve është në rritje, në proporcion me rritjen e nivelit të mirëqenies dhe shembull për këtë janë treguar vendet e pasura të Gjirit.

Ndërsa në analizat e tjera theksohet shpesh se pasuria që vjen me zbulimin e naftës ka sjellë dukshëm ndryshimin e mënyrës së jetesës së popujve arabë, që shquhen për konservatorizëm; shkatërrimi kulturor po përhapet me një ritëm të përshpejtuar dhe bashkë me këto struktura, ka evoluar procesi i shpërbërjes së familjes.

Sipas **Abdullah el Hamoud**, kryetar i Organizatës së ndihmave të Arabisë Saudite "**Awasser**", 70% e arabëve që jetojnë jashtë shtetit martohen në shtetet ku banojnë. Sipas **Hamoud**-it, kjo situatë sjell me vete shumë probleme.

Çdo vit dalin për udhëtime turistike mesatarisht 7 milion persona prej banorëve të shteteve Saudite dhe të vendeve të Gjirit, të cilët shquhen si turistët



që harxhojnë më shumë para në botë. Bëhet e ditur se midis këtyre, numri i atyre që nënshkruajnë martesë të përkohshme, të cilat quhen martesa verore po rritet nga dita në ditë.

Në shtetet si Egjipti, Maroku, Jemeni, Siria dhe Libani, e veçanërisht arabët e pasur, nënshkruajnë këto lloj martesash. Bëhet e ditur se shumica e vajzave të reja në Egjipt martohen përkohësisht me arabë të pasur dhe më pas mbeten në mes të katër rrugëve.

PLAGA SOCIALE QË PËRGGJAK LINDJEN E MESME

Kundrejt rritjes së shpejtë në raportin e divorceve, rreziku tjetër që shfaqet në popujt e Lindjes së Mesme është rritja progresive në mesataren e moshës së martesave, e cila zë vend shpesh në mediat arabe.

Sipas studimit të specialistit të Shkencave Shoqërore në Jordani, **Dr. Ismail Ez-Zejud**, me temë "**Problemi i qëndrimit në shtëpi në Botën Arabe**", raporti i të rinjve sirianë që janë beqarë është 50%, ndërsa raporti i të rinjve Jordanezë, që sapo kanë hyrë në moshën e martesës e ka kaluar 55%-in.

Bëhet e ditur se në Kuvajt dhe Bahrejn, raporti i vajzave që kanë mbushur 35 vjeç dhe nuk kanë mundësi të martohen, arrin deri në 30%.

Hulumtimi i specialistit tregon se në Irak, raporti i



të rinjve, të cilët kanë mbushur moshën e martesës dhe nuk kanë mundësi të martohen, ka arritur në një nivel të frikshëm, në 85%...

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikës së Egjiptit, numri i të rinjve në Egjipt me popullsi prej 77 milion banorë, të cilët kanë mbushur 35 vjeç dhe nuk janë martuar ende, arrin në 9 milionë; 6 milionë prej tyre janë meshkuj, ndërsa 3 milionë janë femra.

Ndërsa në Arabinë Saudite me një popullsi prej 28 milion banorësh, bëhet e ditur se numri i vajzave që ka mbushur 30 vjeç dhe që nuk ka mundësi të martohet e ka kaluar 1 milionëshin.

Shifrat zyrtare në Algjeri tregojnë se 51% e popullsisë së përgjithshme femra nuk është martuar fare. Theksohet se pjesa më e madhe prej 4 milion e vajzave beqare e kanë kaluar moshën 30 vjeç.

Këshilltari psikologjik Tehani Abdulhamid, nxjerr një përfundim tjetër përkrah justifikimeve ekonomike dhe sociale në lidhje me arsyet e mbetjes në shtëpi, që është kthyer në një plagë të thellë sociale në botën Arabe. Sipas **Tehanit**, “Bota arabe po përjeton skizofreninë kulturore.” Tehani e shpjegon kështu këtë përcaktim: “Bota arabe, që prej shumë kohë më parë, është nën ndikimin e kulturës perëndimore dhe përipiqet t’i zgjidhë problemet sociale që has, me metodat e mjekimit të planifikuara nga perëndimi.”

Tehani thotë se ky përcaktim mund të shpjegohet si vijon: “Familjet në botën arabe kanë filluar ta konsiderojnë të turpshme martesën e hershme, duhe u ndikuar nga retorika e botës perëndimore. Madje, fëmijët ndiejnë një lehtësim shpirtëror, për shkak të vonimit të martesës së tyre. Megjithatë, ata nuk janë të vetëdijshëm se kanë rënë në një rrugë qorre të pakapërcyeshme. Sepse perëndimi i prezanton fëmijët me seksualizëm që në moshë të re.”

Tehani thekson se, për të zgjidhur problemet e pamundësisë për t’u martuar, duhet të hiqen shumë pengesa ekonomike, sociale dhe tradicionale që dalin para martesës dhe na bën të ditur se duhet të fillojmë nga rruga për të cilën Profeti ynë i Nderuar ka thënë:

“Kur të vijë dikush, prej të cilit jeni të kënaqur nga feja dhe karakteri i tij, jepini vajzën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, në tokë shfaqet një kaos dhe trazirë e madhe.”

“O i Dërguari i Allahut, - i thanë - po në qoftë se ai është i varfër dhe nuk është aristokrat?”

Ai urdhëroi kështu: “Kur t’ju vijë dikush (për t’ju kërkuar vajzën), nga feja dhe karakteri i të cilit jeni të kënaqur, martojeni atë.” dhe e përsëriti këtë tre herë.

Nuk dihet se sa përgjigje do të marrin këshillat e **Tehan-it**, por kjo plagë sociale që ka përfshirë kryekëput botën arabe, është kandidatë për të hapur rrugën e problemeve shumë më të mëdha. Madje e ka hapur.

Problemi i shpikjes së disa llojeve të martesave me disa fetva, të cilat i kanë kundërshtuar shumica e autoriteteve fetare, sot e ka lënë popullin arab në mesin problemeve shumë serioze.

Si përfundim, degjenerimi kulturor që konsulenti psikologjik **Tehani Abdulhamid** e ka përkufizuar “**skizofreni kulturore**”, sot është një ngjarje që ndodh jo vetëm tek popujt arabë, por tek shumica e shteteve në botën islame.

Me zhvillimin e mundësive ekonomike e teknologjike dhe me përcjelljen e rregullave të mirësjelljes deri tek fshati më i largët në kulturën perëndimore, në popujt islamë po dëshmohej një transformim i jashtëzakonshëm, jo vetëm në sensin ekonomik, por edhe në atë social. Nga ky transformim merr pjesë dhe vazhdon të marrë shumë pjesë, madje edhe struktura e familjes konservatore... Për fat të keq...

MARTESA DHE DIVORCI

— Mehmet Dinç —

Jemi në një nga periudhat më sfiduese, që po përballojnë familjet në ekzistencën e tyre. Përveç shifrave të divorcit që rriten çdo ditë, ngjarjet e divorceve që shikojmë dhe dëgjojmë të gjithë, tregojnë se kanë ndryshuar shumë gjëra që dimë në lidhje me familjen. Përveç kësaj, divorcet janë vetëm maja e ajshbergut. Ekziston edhe një përmasë shumë herë më e madhe, por e nëndheshme, që nga dhuna brenda familjes, deri në vrasje, nga grindjet deri në mosmarrëveshje të thella.

Shtëpitë tona, të cilat duhet të jenë çerdhet e lumturisë, tashmë kanë filluar të perceptohen si qeli hidhërimi dhe si pasojë e kësaj, dikush ka filluar të zgjasë afatin e qëndrimit në punë për të mos shkuar në shtëpi, dikush tjetër gjen punë të reja për veten, dikush tjetër ka filluar të takohet me shokët e tij përditë; ndërsa ata që detyrohen të shkojnë në shtëpi, e ndërtojnë gjithë programin e tyre të qëndrimit në të duke parë televizor, duke lënë pas dore bashkëbisedimin brenda familjes, përveç disa fjalëve të domosdoshme.

Ndryshojnë ditët e para të martesës, muajt e parë,

madje edhe ata të fundit janë të ndryshme. Dashuria, mirëkuptimi, toleranca dhe sakrifica, që tregojnë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit në muajt e parë, me kalimin e kohës humbet e zhduket.

Mirëpo, përse njerëzit vijnë deri në këtë pikë? Këtu të shkon mendja te fjala e Tolstoit, të cilën e ka shkruar si parathënie në librin Ana Karenina: “Të gjitha familjet e lumtura ngajnë me njëra-tjetrën; por çdo familje e hidhëruar ka një hidhërim tipik-unik”. Megjithatë, përsëri në këtë artikull do të përpiqemi të cekim ato veprime që zakonisht i largojnë njerëzit nga familja dhe të përcaktojmë shndërrimin e individëve që bëjnë pjesë në të njëjtën shtëpi.

1. TË MARTOHEM, POR TË HIQEM SIKUR JAM VETËM

Njerëzit kanë një sistem jete me të cilin janë mësuar. Kur martohen, dashur pa dashur ky stil i jetës do të ndryshojë. Ata do të duhet të ndërtojnë një stil jete dhe një sistem të ri bashkë me bashkëshortet e tyre. Por pas martesës, njerëzit që shikojmë zakonisht në jetën e përditshme nuk duan të ndry-



shojnë sistemin dhe huqet e tyre paramartesore. Veçanërisht burrat dhe pikërisht ata që martohen në moshë të re, sistemin me të cilin janë mësuar duan ta vazhdojnë edhe pas martesës. Ndërkohë që një pjesë e tyre është mësuar ta kalojnë pjesën më të madhe të mbrëmjes apo darkës jashtë me shokët e vet, një pjesë tjetër është mësuar të qëndrojnë vetëm, para kompjuterit, pa shoqërimin e askujt. Megjithatë duan të kalojnë kohë bashkë me bashkëshortet e tyre pas martesës, përsëri duan të vazhdojnë huqet e vjetra, përveç disa sakrificave që i bëjnë me vesh-tirësi, pa asnjë dëshirë. Ndërsa, kur bashkëshortet e tyre thonë ndonjë fjalë të çfarëdodhshme, bezdisen, mërzhiten shumë ose u duket sikur po u kërkojnë diçka të jashtëzakonshme dhe i fajësojnë ato. Në të vërtetë, martesë nuk është një jetë e vetmuar dhe njeriu nuk mund ta vazhdojë jetën e tij të vetmuar pas martesës.

2. E SHKUARA NUK KA KALUAR ENDE

Procesi martesor zakonisht kalon me vështirësi dhe mundime. Veçanërisht, proceset e detajuara dhe të lodhshme, si kërkesa, fjala, fejesa, martesë, formimi i shtëpisë së re etj., mund të bëhen shkak për konfliktin e dy familjeve, që kanë kultura të ndryshme, të cilat ndoshta nuk e njohin njëra-tjetrën. Një fjalë që thuhet, një veprim që kryhet ose një gjest që braktiset gjatë atij procesi, mund të bëhet burim ftohesh dhe zemërimesh që mbarten deri në vitet e mëvonshme. Kam takuar një grua që mendonte se në vitin e nëntë të martesës, pas fëmijës së dytë, bashkëshorti i saj vazhdonte të mbante qëndrim të rreptë duke e përçmuar atë, ngaqë në blerjen e pajës kjo kishte pasë marrë 1 metër fund, në vend që të merrte 1.5 metër. Po në të vërtetë, në çdo proces që zhvillohet me kaq detaje dhe me mundime, dashur pa dashur do të ketë dhe ka pengesa dhe mangësi. Të qenët dashamirës, tolerantë, lehtësues dhe falës nga ana e bashkëshortëve, me në krye të mëdhenjtë e familjes gjatë këtij procesi, është kusht për të zhvilluar për një kohë të gjatë një martesë të lumtur.

3. AMBICIET NIK DINË TË NDALEN

Nuk ka asgjë më të natyrshme dhe normale se sa ambiciet e qarta që kanë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit. Por është kusht i domosdoshëm që të dyja palët të jenë të logjikshëm dhe të mirëkuptueshëm

gjatë zhvillimit dhe procesit të këtyre ambicieve. Martesa nuk është një bashkëjetesë, që jetohet dhe programohet për një afat të caktuar. Për rrjedhim, bashkëshortët mund të mos kenë mundësi t'ia përbushin pretendimet njëri-tjetrit në çdo kohë.

Për shembull: është e padrejtë që një grua për shkak të ambicieve apo pretendimeve me tepri të presë që burri i saj, të jetë gjithmonë një njeri që mirëmban fizikun dhe veshjen e vet, i aftë të kujdeset për nevojat e shtëpisë dhe fitimin e ushqimit, të ketë preokupim maksimal në lidhje me të gjitha çështjet që lidhen me fëmijët e tij dhe të ketë gjithmonë performancë të shkëlqyer në zgjidhjen e problemeve të veta. Është normale që një bashkëshorte të presë që bashkëshorti i saj të jetë i mirëmbajtur, i aftë dhe i interesuar për të, por nuk është e mundur dhe e drejtë t'i presë këto në çdo moment në nivelin më të lartë, ngaqë ajo që pret është diçka e pamundur. Përsëri, mund të jetë e pamundur që një zotëri të jetë gjithnjë fytyrëqeshur, orator, të shpreh interes, të ndihmojë gjithnjë bashkëshorten e tij, të jetë tolerant dhe i mirëkuptueshëm në çdo situatë, të kujtojë dhe të kryejë çdo gjë që i thotë bashkëshortja e tij. Në këtë drejtim është e rëndësishme për një martesë të lumtur që zonja të tregojë mirëkuptim, duke mos humbur dashurinë e bashkëshortit të vet.

4. FATI I MARTESËS NUK ËSHTË VETËM NË DORËN E DY NJERËZVE:

Në martesë, të dy palët duhet të forcojnë ekzistencën e familjes së tyre, ta lehtësojnë dhe ta pasurojnë atë. Por për fat të keq, kjo nuk ndodh në praktikë, përkundrazi ata ndërmarrin një funksion shkatërrues, vështirësues dhe prodhues të problemeve. Në shumë aspekte, si p.sh. përcjellja e një problemi ose mosmarrëveshjeje midis bashkëshortëve të mëdhenjtë, ankesa e të mëdhenjve për një bashkëshort tek tjetri për shkaqe të ndryshme, reflektimi i mosmarrëveshjeve që kanë të mëdhenjtë midis tyre tek marrëdhëniet e tyre me çiftet, mospozicionimi i mirë i bashkëshortëve, i bashkëshorteve dhe i të mëdhenjve brenda familjes, e dëmtojnë shumë martesën. Ndërhyrja e të mëdhenjve në marrëdhëniet midis bashkëshortëve, në situatat e ndryshme në shtëpi ose në qëndrimin e tyre në edukimin e fëmijëve, padrejtësia e qartë që bëjnë midis fëmijëve dhe sjelljet e dyzuara, etj., e rrënojnë martesën.



Situata që krijohet në fund, nuk i bën të lumtur as bashkëshortët e as familjen e gjerë. Për rrjedhim, është shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e martesës që të mëdhenjtë të ndërmarrin një veprimtari më kreative e riparuese dhe të preokupohen me punë më të dobishme, në vend që të merren me nuset ose me dhëndurrët e tyre në kohën e lirë.

5. EKZISTOJNË LISTA TË ZEZA:

Asnjë martesë nuk kalon gjithnjë e lumtur dhe e gëzuar. Çdo marrëdhënie ka kohë të vështira dhe periudha të mërzitshme. Ato që përjetojnë dhe thuhet gjatë këtyre periudhave, shkruhen në listat e zeza; dhe sa herë që gjendet mundësia për t'i hapur këto lista, pa asnjë dyshim, martesë ndikohet negativisht nga kjo gjendje. Megjithatë, dje ndodhi ajo që ngjau dje, sot po ndodh ajo që po ngjet sot. Nëse ia shtojmë asaj që ndodhi sot edhe atë që ndodhi dje, bëhet e pamundur zgjidhja e saj. Prandaj, për një martesë të lumtur lista e zezë duhet të griset e të flaket një orë e më parë.

6. ZAKONET E KËQIJA I VRASIN MARRËDHËNIET:

Një zakon i keq (*huq, ves*), që ka njëri prej bashkëshortëve, si: duhani, alkooli, kumari, etj, mund të bëhet shkak për amortizimin dhe këputjen e lidhjes martesore. Ashtu si alkooli dhe kumari, edhe varësia ndaj televizorit dhe kompjuterit mund t'i hap rrugë problemeve në çift. Një zotëri i martuar me një zonjë, e cila gjendet para televizorit kur ai hyn në shtëpi dhe e lë atë para televizorit kur shkon të flejë, ose një zonjë e martuar me një zotëri, i cili sa hyn në shtëpi ngulet para televizorit dhe që gjithashtu kalon të gjithë kohën para kompjuterit, nuk mund ta mbajnë të shëndoshë për një afat të gjatë martesën e tyre.

7. MARTESA KËRKON PËRGATITJE

Para martesës, një zonjë dhe një zotëri, patjetër dhe padyshim duhet të përgatiten për martesë. Kjo përgatitje duhet të ketë një gamë të gjerë përtej lavatriçes, lavastoviljes, pajës, tantellave, etj. Ajo fillon nga njohuritë seksuale deri tek njohuritë psikologjike, nga aftësia për të gatuar deri tek aftësia për të bërë pazarin e shtëpisë. Nuk është e drejtë dhe e logjikshme për njeriun, i cili studion dhe merr edukim për vite të tëra për të hyrë në punë, të mos lexojë diçka dhe të mos marrë aspak edukim para se të martohet.

8. DËSHTIMET E TË TJERËVE

Njerëzit që janë të shqetësuar për shkaqe të ndryshme në martesën e tyre, dëshirojnë në mënyrë të

pavetëdijshme, të infektojnë të gjithë me një psikologji shqetësimi. Mendojnë se problemi nuk ekziston vetëm tek ata ose vetëm tek martesë e tyre, por te çdo martesë dhe te çdo i martuar. Prandaj, japin këshilla, që lënë mbresa negative, veçanërisht tek ata që sapa janë martuar, rrëfejnë tregime dhe shkëmbejnë eksperiencë negative me njëri-tjetrin. Megjithatë, nuk ekziston asnjë rregull që ta përjetojnë të gjithë atë që kanë përjetuar ata në jetën e tyre dhe ato që kanë parë në jetën e të tjerëve. Ndoshta ka më shumë martesë të mira se sa martesë të këqija, megjithëse nuk është bërë asnjë trajtesë për martesat e këqija. Prandaj, nuk duhet t'ua vësh shumë veshin fjalëve të këtyre njerëzve; sado që të jenë pranë, sado që të duken të sinqertë, duhet të mos i lejoni të flasin shumë për këtë çështje.

9. DISTANCA NË SHOQËRI

Është e pashmangshme që njerëz të ndryshëm të marrin pjesë në jetën tonë. Por secili është i dobishëm kur është në vendin e duhur. Në këtë kontekst, njeriu ka bashkëshort, miq, shokë etj. Por bashkëshorti mbetet bashkëshort dhe shoku mbetet shok. Personi nuk duhet t'ua tregojë shokëve tërë jetën, punën dhe sekretet e veta. Ai këtë gjë duhet ta bëjë me bashkëshortin e vet, përjetimet e bukura duhet t'i ndajë me bashkëshortin dhe jo me shokët. Personi që shkon me shokun e tij për shëtitje, që bashkëbisedon me të, që i njeh dhe i di më mirë shokët e vet se sa bashkëshortin e tij, që nuk ndan asgjë përtej çatisë dhe krevatit me bashkëshortin e vet, domethënë shokun e vet e ka kthyer në partner (*bashkëshort*). Një prej rreziqeve më të rëndësishme për martesën është edhe shoqëria.

10. MOS LEJO QË I YTI TË BËHET I HUAJ

Megjithëse bashkëshortët nuk kanë njohje të plotë ndaj njëri-tjetrit para martesë, përpjekja e tyre për t'u njohur pas martesë, për të njohur botkuptimin e ndjenjave dhe mendimeve të njëri-tjetrit, ka rëndësi nga aspekti i solidarizimit me themele të shëndosha. Ai që nuk bën asnjë përpjekje për të njohur bashkëshortin e vet, që di më shumë gjëra për një këngëtar ose futbollist se sa për bashkëshortin e vet, rreth një filmi serial që transmetohet në televizor, pas një kohe të shkurtër do të fillojë të largohet nga bashkëshortja dhe pas një farë kohe do të fillojë të jetojë me një të huaj që nuk e ka njohur kurrë. Martesa nuk do të vazhdojë dot pas një kohe të shkurtër, sepse dy të huaj nuk mund të jetojnë gjatë me njëri-tjetrin, duke mos ditur se çfarë duan dhe çfarë presin prej njëri-tjetrit.



Nivelet Shpirtërore

— Sadik Dana —

Abdullah ibn Abbasi, radijallahu anhuma, ka thënë:

Një ditë isha pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Pejgamberi (a.s.) më tha:

“Bir! Po të mësoj disa fjalë. Zbatoji urdhrat dhe ndalesat e Allahut, në mënyrë që ta kesh pranë Atë! Kur të kërkosh diçka, kërkohje nga Allahu! Kur të kërkosh ndihmë, kërkohje nga Allahu! Dije këtë: Nëse të gjitha krijesat bashkohen për të të bërë ndonjë dobi apo për të të dhënë ndonjë të mirë, nuk mund të të japin më shumë se ajo që të ka shkruar Allahu. Po ashtu, nëse të gjitha krijesat bashkohen për të të dëmtuar, nuk mund të të shkaktojnë ndonjë humbje më të madhe se ajo që të ka faktuar Allahu. Punët e lapsit kanë mbaruar dhe fletët janë tharë, pasi shkrimet mbi to janë plotësuar.” (Tirmidhi, Kijame, 2518; Musned, Vëll. 1, fq. 293-303.)

Ky hadith fisnik duhet të jetë si një pasqyrë në zemrën e çdo besimtari dhe çdo punë duhet të bëhet në përputhshmëri me të. Nëse besimtari vepron kështu deri në frymën e fundit të tij, në sajë të mëshirës dhe ndihmës së Allahut Teala, do të jetë i fortë përballë vështirësive në dynja dhe në ahiret.

Në këtë hadith fisnik tregohet qartë se çdo njeri duhet ta dijë që çdo gjë është në dorën e Allahut të Madhëruar dhe se çdo gjë bëhet me lejen hyjnore. Prandaj, të gjithë duhet të sillen dhe të veprojnë sipas kësaj.

Nëse njeriu e percepton se zotëruesi i çdo krijese është Allahu Teala, e kupton se njerëzit, çfarëdo pozite që të kenë, janë një grup të paafetsh, të shkretë dhe se në dorë nuk kanë asgjë tjetër përveç autoritetit të dhënë nga Zoti për të vepruar. Atëherë, ai nuk mbësh-

tetet te të afërmit, madje, as te familja dhe te fëmijët. Nuk i beson pasurisë dhe famës së tij. E di se çdo gjë shfaqet me ndihmën e Allahut të Lartësuar, i shtohet dija, besnikëria, dashuria dhe nënshtrimi ndaj Zotit, nuk pret asgjë prej krijesave, e di se çdo vështirësi merr fund me durim dhe se në fund të çdo vështirësie ka mirësi e lehtësim.

Ibrahim Dussuki, thotë:

“Unë dëshiroj t’i shoh të lumtur fëmijët e mi.”

Këtë duhet ta kuptojmë në formën: Të qeshur, miqësorë e të lumtur.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

“Atë ditë, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shuara, 88-89.)

Zemra është pesë llojesh:

Zemër e vdekur: Kjo është zemra e të pafeve dhe e qafirëve.

Zemër e sëmurë: Kjo është një zemër e mbushur me dashuri ndaj kësaj bote.

Zemër neglizhente: Kjo është një zemër e luhatshme që përpiqet ndërmjet dynjasë dhe ahiretit.

Zemër e zgjuar: Kjo është një zemër e preokupuar me dhikër.

Zemër e gjallë: Kjo është zemra e profetëve, e sahabëve dhe e evlijave.

Allahu, dhu’l-xhelali ve’l-ikram, na e mbrojtë zemrën, e cila është vendi ku shikon Ai, nga çdo dashuri ndaj gjërave të kësaj bote, nga dashuria ndaj dynjasë dhe nga e keqja e vetes dhe e djallit të mallkuar! Na bëftë prej robërve të Tij që e kanë zemrën e pastër, sado që bëjmë gabime apo shfaqim dobësi! Amin!

Ibrahim Dussuki, thotë:

“Qëndrimi me njerëz të përlyer nga papastërtia e mëkatit, e vret shikimin. Edhe syrin e zemrës, edhe syrin e ballit, dhe i lë pa shpirt në errësi. Kështu, bëhesh njeri që s’e ndan dot të mirën nga e keqja.”

ÇFARË ËSHTË thelbësore për lumturinë?

— Ali Riza Temel —

Njeriu vjen në këtë botë me tipare fizike të përcaktuara, sepse është Allahu që i jep njeriut formën që dëshiron. Një nga emrat e bukur të Tij është Formëdhënësi. Ngjyrat dhe format e ndryshme janë shenja të fuqisë së Allahut.

Përderisa këto veçori janë të paracaktuara, njeriu nuk mund t'i ndryshojë. Duke qenë veçori jo të fituara, ato nuk mund të shërbejnë si mjet për të siguruar epërsi mbi të tjerët, sepse epërsia fitohet përmes veçorive të fituara me përpjekje dhe punë. Siç urdhëron edhe Allahu në Kuran: **“Çdo njeri është peng i veprave të veta.”** (Tur, 21.) Kurse Pejgamberi (a.s.), thotë: **“Allahu nuk ju vlerëson sipas pamjes dhe pasurisë, por sipas zemrës dhe veprave.”** (Ibn Maxhe, 4143.) Pra, thelbësore është zemra e pastër, besimi i patundur dhe veprat e mira.

Sigurisht që bukuria dhe pamja tërheqëse janë të dëshiruara nga njerëzit, por bukuria nuk mund të jetë kriter bazë, për më tepër kur ajo është relative, ndryshon nga individi në individ. Ajo që për dikë është e bukur, për një tjetër është e shëmtuar.

Pamja fizike është kalimtare. Bukuria e rinisë nuk mund të ruhet në pleqëri. Mund të fitosh një lloj bukurie ose mund ta zgjasësh bukurinë përmes makijazhit dhe operacioneve plastike, por kjo nuk është as e vazhdueshme dhe as zëvendësuese e bukurisë natyrale. Atëherë duhet të interesohemi më shumë për bukurinë e vazhdueshme. Pejgamberi (a.s.), na ka porositur që ndër katër cilësitë për të cilat preferohet martesë me një grua, të zgjedhim besimin dhe moralin e bukur. Sa fytyra të bukura ka, që zemrën e kanë katran dhe anasjelltas. Bilali (r.a.), ishte i zi si nata, por shpirti i tij rrezatonte dritë si diell, kurse fytyra e Ebu Lehebit ishte e bukur, por shpirtin e kishte katran të zi. Trupi, sa do të zbukurohet, një ditë në dhé do të përfundojë. Kurse shpirti do të udhëtojë në përjetësi.

Megjithëse thelbësore është bukuria shpirtërore dhe morale, njerëzit janë të dhënë më shumë pas bukurisë fizike, duke e neglizhuar krejtësisht bukurinë shpirtërore. Në lidhje me vlerësimin sipas bukurisë së jashtme dhe shpirtërore, dua të jap një shembull të spikatur:

Sa'd es- Sulejmi (r.a.), ishte një skllav me ngjyrë, por një mysliman i mirë. Një ditë erdhi në xhami, fali namazin dhe u afrua pranë Pejgamberit (a.s.). Njerëzit pyesnin Pejgamberin (a.s.), për çështje të ndryshme të kësaj bote dhe botës tjetër. Sa'di u çua dhe i tha Pejgamberit (a.s.): “O i Dërguari i Allahut! A është pengesë ngjyra e zezë dhe mungesa ime e paraqitjes për të hyrë në Xhenet?” Pejgamberi (a.s.), tha : “Beto hem para Allahut se, nëse respekton Allahun dhe beson në mesazhin që ka sjellë i Dërguari i Tij, do të hysh në Xhenet.”



Mbi këtë, Sa'di deklaroi se nuk besonte zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut dhe dha fjalën që do të luftonte në rrugën e Allahut, pastaj shtoi: “Çfarë përfitimi kam unë nga gjithë kjo?” Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj: “Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e besimtarëve janë të vlefshme edhe për ty, sepse tashmë ti je vëllai i tyre.” Atëherë Sa'di tha: “Unë kam kërkuar vajzë për t'u martuar dhe për shkak të mungesës së paraqitjes dhe ngjyrës jam refuzuar në të gjitha rastet, megjithëse unë jam një njeri me soj të mirë në fisin tim.”

Përballë shqetësimit të Sa'dit, Pejgamberi tha: “Shko te shtëpia e Amr ibn Vehbit dhe thuaj që Pejgamberi (a.s.), e kërkon vajzën tuaj për mua. Sipas porosisë së Pejgamberit (a.s.), Sa'di shkoi te shtëpia e Amr ibn Vehbit, i ra derës, i përshëndeti dhe tha: “Unë vij nga Pejgamberi (a.s.), me porosinë që vajzën tuaj të ma jepni mua.” Amr ibn Vehbe e priti shumë ftohtë propozimin. Kur Sa'di po bëhej gati të refuzonte, vajza që e kishte dëgjuar bisedën, i tha babait: “Nxito tek Pejgamberi (a.s.) dhe pranoje propozimin para se të zbrësë ndonjë ajet, i cili do të të turpëronte midis gjithë arabëve, sepse Allahu në Kuran thotë: **“Nuk i takon asnjë besimtar apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”** (Ahzab, 36.) Mbas kësaj, Amri e kuptoi gabimin dhe me nxitim u nis për tek Pejgamberi (a.s.), për të kërkuar ndjesë dhe zbatuar porosinë e Pejgamberit (a.s.). Por Sa'di kishte arritur tek Pejgamberi (a.s.), para se të mbërrinte Amri dhe e kishte informuar për gjithçka. Kur e pyeti Pejgamberi (a.s.), se përse nuk ia dha vajzën Sa'dit, tha: “O i Dërguari i Allahut! Mendova se Sa'di nuk thoshte të drejtën, prandaj erdha këtu për të mësuar të vërtetën, tani që e mësova po e shpall këtu para të gjithëve që vajzën ia kam dhënë Sa'dit. Pejgamberi (a.s.), pasi përgëzoi Amrin për gjestin fisnik, urdhëroi martesën e Sa'dit me vajzën. Sa'di gjithë gëzim shkoi në treg për të blerë diçka për vete dhe nusen e re.

Në treg u dëgjua një zë: “O kalorësit e Allahut, shaloni kuajt dhe fitoni Xhenetin.” Kjo ishte një thirrje për xhihad. Sa'di hoqi dorë nga gjërat që kishte vendosur të blinte dhe me vrap shkoi te tregu i kuajve dhe armëve. Bleu një kalë dhe një shpatë dhe menjëherë mori pjesë në luftë. Luftoi derisa ra dëshmor. Pejgamberi i shkoi pranë, e përqafoi dhe i përkëdheli kokën. Kalin dhe shpatën ia ktheu bashkëshortes së tij dhe i urdhëroi t'u thoshin të afërmeve të bashkëshortes se Allahu e martoi Sa'din me një grua më të mirë se vajza juaj, pastaj lexoi ajetin: **“Punëdrejtët, me të vërtetë, do të jenë në**

vend të sigurt, midis kopshteve dhe burimeve, të veshur në petka mëndafshi të hollë dhe armaç, të ulur përballë njëri-tjetrit. Po, kështu do të jetë, dhe Ne do t'i martojmë ata me hyri sybukura.” (Duhan, 51-54.)

Kjo ngjarje e spikatur, na tregon që e rëndësishme nuk është pamja e jashtme, por zemra e pastër dhe e sinqertë. Zemra e pastër dhe e sinqertë është e fituar tek Allahu në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Shuara, 88-89.)

Vlera e vërtetë e njeriut çmohet përmes vlerave shpirtërore. Çdo gjë është e bukur, kur njeriu është i mirë, gjërat e bukura shëmtohen kur njeriu është i keq.

Një tjetër ngjarje shumë domethënëse, e cila shpall vlerën e vërtetë të njeriut është edhe kjo:

Një ditë, pranë Pejgamberit (a.s.), kaloi një burrë. Pejgamberi (a.s.), pyeti personin që kishte pranë: **“Si e njeht këtë burrë?”** Ai tha: “Është familje fisnike, nëse kërkon vajzë nuk i refuzohet, nëse hyn ndër-mjetës, i dëgjohej fjala.”

Pak më vonë, kaloi një burrë tjetër:

Pejgamberi (a.s.), përsëri e pyeti personin pranë: **“Po për këtë, çfarë mendimi ke?”**

Kësaj radhe tha: “Ky është një mysliman i varfër, nëse kërkon një vajzë refuzohet, nëse ndër-hyn si ndër-mjetës, nuk i dëgjohej fjala, nëse flet nuk e dëgjon kush.”

Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: **“Ky i fundit është më i mirë se ai i pasuri aristokrat.”** (Buhari, Nikah, 15.)

Ngjarjet e lartpërmendura nuk tregojnë që i varfëri është më i mirë se i pasuri apo i dobëti është më i mirë se i forti, por që njeriu nuk duhet të diskriminohet për shkak të varfërisë dhe dobësisë. Sepse njeriu nuk vlerësohet sipas prejardhjes dhe pasurisë, por sipas devotshmërisë dhe moralit.

Në vlerësimin e njerëzve shpesh gabohet, sepse pasuria, pozita, fama dhe pamja të mashtrojnë. Për të vlerësuar saktë dhe drejt duhen përdorur kritere hyjnore.

Pejgamberi (a.s.), thotë: **“Në Ditën e Gjykimit do të dalë një person, që në botë ka qenë i njohur për madhësinë, por tek Allahu nuk do të ketë vlerë as sa krahët e një mize.”** (Rriyadus Salihin, 257.)

Në lidhje me ata që në pamje duken madhështorë dhe mahnitës, por në thelb janë bosh, Allahu thotë: **“Kur i shihni ata, pamja e tyre e bukur ju mahnit e, nëse flasin, ju i dëgjoni fjalët e tyre. E megjithatë, ata janë si trungje të mbështetura.”** (Munafikun, 4.)

Thelbësore është të jesh njeri me moral të bukur dhe jo njeri me pamje të bukur. Njëra është origjinale, kurse tjetra imitim. Allahu na bëftë prej njerëzve të vërtetë. Amin...



Bukuria Delikatësës

— Dr. Adem Ergyl —

Qëllimi ynë sublim është të bëhemi myslimanë dhe njerëz të mirë.

Si mund të bëhesh mysliman i mirë?

Siç ka thënë i Dërguari i Allahut, (a.s.):

“Njeri i mirë është ai që ka moral të lartë.” (Buhari, Menakib 23; Muslim, Fedail 68)

Atëherë, qëllimi ynë është të bëhemi njerëz me karakter të mirë dhe moral të lartë.

Ne e mësojmë moralin e lartë nga mësuesi i moralit, nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilin Allahu Teala e ka lavdëruar në Kuran, duke u shprehur: *“Me të vërtetë, ti ke një moral të lartë.”* (Kalem, 4)

Në këtë artikull, le të shtjellojmë butësinë që Ai (a.s.), na ka mësuar dhe e cila është njëra prej cilësive më të bukura.

ÇFARË ËSHTË BUTËSIA?

Butësi do të thotë të mos nxehesh e zemërohesh në situata të tensionuara dhe të sillesh me seriozitet e qetësi.

Do të thotë të mos marrësh hak nga ai person që i je zemëruar, edhe pse ke mundësi ta bësh këtë.

Atij që zotëron cilësinë e butësisë i thonë i butë.

Atëherë, i butë do të thotë njeri që nuk vepron me nxitim dhe zemërim.

Edhe Allahu i Lartësuar nuk i ndëshkon menjëherë robërit e Tij, edhe pse e shikon se ata vazhdimisht bëjnë mëkate dhe i kundërshtojnë urdhrat e tij.

Ky ajet fisnik e shpreh shumë bukur se sa mëkatarë janë njerëzit dhe sa i Butë është Allahu Teala:

“Sikur Allahu t’i dënonte njerëzit për shkak të mbrapshtive të tyre, nuk do të linte asgjë të gjallë në Tokë. Por Ai i lë ata deri në një afat të caktuar dhe, kur atyre u vjen afati, ata nuk mund ta shtyjnë atë e as ta shpejtojnë, qoftë edhe për një çast.” (en-Nahl, 61)

Domethënë, i butë:

Është ai që nuk nxiton.

Është ai që duron ndaj fatkeqësive.

Ngaqë Allahu Teala është i Butë, u jep shanse njerëzve të bëhen pishman dhe të pendohen për mëkatet që kanë bërë.

DHËMBI I PEJGAMBERIT (A.S.)

Tani le të shohim ca shembuj nga butësia e pa-fundme e mësuesit të dashur të moralit, Muhamedit (a.s.):

Ishte në luftën e Uhudit. Armiqtë e kishin rrethuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe i ishin afëruar shumë. Në ato momente, vëllai i Sa'd b. Ebu Vakkasit, që gjendej në rreshtat e armiqve, Utbe b. Ebu Vakkasi hodhi një gur. Ky gur theu dhëmbin e bekuar të Profetit të Allahut, (a.s.).

Jo vetëm kaq, por i theu edhe helmetën që Pejgamberi (a.s.), e kishte në kokë. Më e keqja, dy hallka të helmetës iu ngulën në faqen e Tij të bekuar. Sahabiu komandant prej ashëri mubeshshere (dhjetë të përgëzuarve me xhenet), Ebu Ubejde b. Xherrah, (r.a.), theu dy dhëmbët e parë duke u përpjekur t'i nxirrte ato hallka me dhëmbë.

Nga ana tjetër, Hazreti Aliu, (r.a.), i hidhte ujë plagës me mburojën e tij. Ndërsa gonxheja e trëndafilin të Krenarisë së Gjithësisë, Hazreti Fatimeja, (r.a.), lante gjakun që rridhte nga fytyra e babait të saj.

Kur pa se uji e bënte plagën të rridhte gjak më shumë, dogji një copë hasër dhe hirin e saj e hodhi mbi plagë. Në këtë mënyrë, arriti ta ndalojë gjakun. (Muslim, Xhihad 101)

Sepse ata nuk dinë gjë (për njësimin Tënd dhe për profetësinë time).” (Muslim, Xhihad, 104)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e mbajti veten edhe në momentet kur, sipas nesh, qafirët e meritonin më shumë mallkimin e tij. Ai (a.s.), nuk u lut që ata të ndëshkoheshin, por të faleshin dhe të udhëzoheshin në rrugën e drejtë.

Myslimanët, nga dashuria e thellë që ndjenin për të Dërguarin e Allahut, (a.s.), e mbajtën si kujtim dhëmbin e tij të thyer në këtë luftë. Allahu qoftë i kënaqur prej tyre. Edhe gjyshërit tanë fisnikë, këtë dhëmb të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), e vlerësonin më shumë se gjithë pasurinë e kësaj bote, e vendosën në dhomën e “Mantelit të të Dërguarit të Allahut” (a.s.), që edhe sot ruhet në muzeun e sarajës Top Kapi, Stamboll.

KUSH ËSHTË TRIM?

Ja, kjo është butësia që i ka hije të Dashurit të Allahut, (a.s.).

Në një kohë që askush nuk e frenonte dot veten

Zemrat e sahabëve ishin të copëtuara nga kjo ndodhi, që po e shikonin me një pikëllim të thellë. Gjendja e fytyrës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që s'kishin guxim ta shikonin, i dërmoi ata. Këtë ngjarje nuk e përballuan dot më shumë dhe i thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Mallkoi këta qafirë!”

Sigurisht se edhe zemra e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ishte e plagosur dhe e thyer kundrejt kësaj që kishte ndodhur. Megjithatë, kërkesën për të mallkuar qafirët e refuzoi me këto fjalë:

“Unë nuk jam dërguar për t'i larguar njerëzit nga mëshira e Allahut Teala.

Unë jam dërguar për t'i thirrur ata në rrugë të Allahut dhe si mëshirë për botët.

O Allah!

Udhëzoje popullin tim në rrugë të drejtë!

për shkak të zemërimit, Pejgamberi, (a.s.), e frenoi veten e tij dhe e mposhti zemërimin në sajë të butësisë që kishte.

Sa bukur e shpreh këtë gjendje i Dërguari i Allahut, (a.s.), në një hadith fisnik:

“Trim nuk është ai që mund kundërshtarin në mundje. Trim i vërtetë është ai që mposht zemërimin e tij kur zemërohet.” (Buhari, Edeb 76; Muslim, Birr 107, 108)

Burrat më trima të botës, sigurisht se janë profetët. Ata janë trimat që duruan ndaj ligësive të qafirëve të verbër shpirtërisht, që nuk i besonin fesë së Allahut Teala dhe i ofendonin të dërguarit e Tij.

Edhe ata kanë përjetuar shkatërrimin e durimit dhe u është mbushur kupa. Disa prej tyre kanë humbur durimin e disa janë treguar më të matur.

Këtë gjendje e shpreh kjo fjalë që transmetohet





si thënie e Umerit, (r.a.), i cili po e shikonte me admirim këtë qëndrim të matur të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe e nxjerr në pah ndryshimin e të Dashurit të Allahut Teala:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut!

Nuhu (a.s.), e pati mallkuar popullin e tij duke iu lutur Zotit:

“O Zot! O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues!” (Nuh, 26)

Sikur ti t’i kishe mallkuar, të gjithë do të shkatërroheshim.

Këta njerëz të kanë lënduar shpinën, të kanë thyer dhëmbin dhe të kanë plagosur në fytyrë. Ndërsa ti nuk i mallkon. Mbi të gjitha, lutesh për ta duke thënë:

“O Zot! Udhëzoje popullim tim, sepse ata nuk dinë!” (Kadi Ijaz, esh-Shifa, Kushek, Bejrut 1420/2000, fq. 149)

PAKUJDESIA E BEDEVIUT

Tani le të shohim një shembull tjetër nga butësia e të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

Pejgamberi, (a.s.), kishte marrë një deve nga dikush që nuk ishte mysliman, për t’ia kthyer më vonë.

I zoti i devesë ishte shumë i pasjellshëm.

Devenë e kërkoi në një mënyrë shumë arrogante nga njeriu më i sjellshëm i botës.

Ai tha një fjalë të rëndë që e mërziti të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Megjithatë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk foli.

Por sahabët nuk rezistuan dot kundrejt këtij ofendimi.

Ata deshën ta ndëshkonin atë njeri të pasjellshëm.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ndërhyri menjëherë dhe tha:

“Mos e prekni atë! Sepse ai që ka dhënë borxh, ka të drejtë të flasë.”

Pastaj urdhëroi t’i jepnin një deve në moshën e devesë së tij.

Sahabët i thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Nuk po gjejmë dot një deve në moshën e devesë së tij, por ne kemi një deve më të mirë.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Atëherë jepini atë! Sigurisht se më i miri prej jush është ai që e paguan borxhin e tij në mënyrën më të mirë.” (Buhari, Vekalet 6; Muslim, Musakat 120-122)

Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e tregoi edhe një herë madhështinë e butësisë së tij.

Butësia dhe dija janë cilësi motra. Butësia u shkon edhe më shumë dijetarëve.

Mund të themi edhe kështu:

Butësia është treguese e dijes. Ai që nuk ka butësi, nuk ka edhe dije.

Butësia është stoli dhe fryt i dijes.

Ndërsa injoranti nuk ka butësi. Ai ka vetëm zemërim. Sipas tij, zemërimi është më i ëmbël se mjalti.

Injoranti nuk mund të rrijë pa u nxehur. Ai e zemëron edhe atë që ka përballë, në mënyrë që të përjetojë zemërim të reja. Nëse bashkëbiseduesi e frenon veten dhe nuk zemërohet, kjo e shkatërron injorantin.

Ne, le të jemi të butë dhe të qëndrojmë larg zemërimit, sepse i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Zemërimi është prej shejtanit.” (Ebu Davud, Edeb 4)

Ne, le të jemi të butë siç na urdhëron Allahu Teala, i cili është i “Butë” dhe le t’i kërkojmë mbrojtje Atij nga shejtani i mallkuar siç veprojme gjithmonë.



GJËRA

të mrekullueshme

— Mehmet Xhoshar —

Kur themi gjëra të mrekullueshme, siç edhe kuptohet, në mendje na vijnë gjëra të jashtëzakonshme dhe të admirueshme. Për të qenë e mrekullueshme diçka, sigurisht se duhet të jetë e mbinatyrshe, përndryshe, nuk është e mrekullueshme.

Kur bëhet fjalë për gjërat e mrekullueshme, në mendje vijnë shtatë mrekullitë e botës. Sigurisht se nuk është e drejtë që këto mrekulli t'i kufizojmë me numrin shtatë, sepse ka edhe shumë mrekulli të tjera që njihen dhe që nuk njihen.

Një mësues u kishte thënë nxënësve në klasë: “Shkruani gjërat e mrekullueshme të botës dhe shpjegoni shkakun e të qenit të tyre mrekulli.” Gjërat që së pari fëmijëve u kishin ardhur në mendje, ishin ato mrekulli që njihen në përgjithësi. Ndërtesat madhështore, historike dhe antike. Këto, siç mund t'ju kujtohen edhe juve, janë Piramidat e Egjiptit, Fari i Aleksandrisë, Tempulli i Artemidës në Efes, Kopshtet e varura të Babilonisë, Shtatorja e Zeusit në Olimpia... Kishte edhe prej nxënësve që këtyre u kishin shtuar veprat, si Murin Kinez, Tyrben e Taç Mahalit, që anglezët e quajnë poezi e ngrirë dhe xhamitë Sulejmanije e Selimije të Arkitekt Sinanit...

Njëri prej nxënësve e kishte përsosur shkrimin e tij jo me gjërat e mrekullueshme që fillimisht na vijnë në mendje, por duke shtjelluar njeriun dhe duke shkruar këto të vërteta rreth disa organeve të tij:

- Në trupin e njeriut ka aq fosfor, sa që mund të mbulojë kokën e 220 fijeve shkrepëseje, aq yndyrë sa që mund të mjaftojë për gjashtë kallëpe sapuni, aq karbon sa ka në 380 gr qymyr dhe aq hekur sa ka në një gozhdë 2.5 cm. Këto janë xhevahire që e mbajnë në ekuilibër strukturën e trupit. Formimi i tyre realizohet me masat më të përpikta. Ligji që ka vendosur Allahu, funksionon pa ndalur dhe përparon drejt synimit të tij.

- Sipas disa studimeve, gishtërinjtë janë aq të ndjeshëm, sa që mund të ndjejnë edhe një dridhje krejt të vogël. Para teshtimës, thithet pesë herë më shumë frymë se normalja. Shpejtësia e frymës që del kur teshtijmë është 100 milje në orë.

- Ne i perceptojmë gjërat që ndodhin rreth e rrotull me anë të organeve shqisore. Përveç këtyre që perceptojnë organet tona, ka edhe shumë krijesa të tjera të cilat ekzistojnë. Ne i japim lamtumirën jetës pa i njohur shumicën prej tyre. Edhe organet tona shqisore është e pamundur t'i njohim të gjitha.

- Kush është ai që e bën kockën të dëgjojë, beben e syrit të formuar nga një lëndë si yndyrë, të shikojë dhe gjuhën prej mishi që të flasë? Mbi të gjitha, si do ta njihim të ëmblën dhe të kripurën, nëse nuk do të kishim gjuhën? Gjuha njihet 4 lloj shijesh: Të kripurën, të thartën, djegësen dhe të ëmblën. Si mund t'i njohë gjuha, e cila është një copë mishi, përzierjet dhe ndryshimet e këtyre? Sikur të mos kishim sytë, nuk do t'i kuptonim ngjyrat. Nuk do t'i matnim dot largësitë. Nuk do t'i kuptonim format e krijesave. Thuhet se për syrin ka katër ngjyra: E kuqja, e verdha, bluja dhe e zeza... Të gjitha ngjyrat e tjera vijnë nga përzierja e këtyre. Syri i shikon këto dhe i ndan. Sikur të mos kishim veshët, nuk do ta dinim se nga cila anë vjen zëri. Faktikisht, nuk do t'i dëgjonim zërat dhe nuk do t'i kuptonim ato që thuhet. Nëse hunda jonë nuk do të ndjente aromën, nuk do mundeshim t'i merrnim erë trëndafilin. Industria kozmetike nuk do të zhvillohej. Erërat e mira të trëndafilin, të limonit, të karafilin, pishës etj... Si i njeh hunda, e cila është një copë mishi, këto aroma? Të gjitha këto organe tonat janë një det në të cilin po mbyten ekspertët. Sikur të mos kishim gojën, nuk mund të jetonim. Kuptimin e shenjave të gishtërinjve, pyetuan atyre që nxjerrin rezultate prej tyre. Sikur të mos ishte shqisa e prekjës, nuk mund ta dallonim pambukun nga hekuri. Çfarë percepton lëkura jonë? Të ftohtin – të ngrohtin, të lagurën – të thatën, të ngurtën – të butën...

Ai që thotë “m’u prishën nervat”, nuk ia ka haberin sistemit nervor. Qeliza nervore quhet neuron. Në tru, i cili është një central telefonik, ka me miliona prej këtyre. “Trupi ynë është një shtet. Truri është kryeqyteti, ndërsa qelizat janë ushtarët... Organet janë taborët e ndarë në njësi.”



— Mesut Kaja —

Kurani Fisnik është burimi më themelor i Islamit. Krahas faktit se Kurani është mëshirë, begati dhe shërim, ai shfaq një model jete gjithëpërfshirës në çështjet si ato të besimit, ibadetit, dispozitave etj. Umeti islam e cakton me të (Kuranin) qëndrimin e tij në të gjitha fushat e kësaj bote dhe të botës tjetër. Zgjidhjet e problemeve me të cilat janë përballur në çdo periudhë, i kërkojnë tek ai. Paqen dhe qetësinë e tyre e gjejnë në klimën e tij shpirtërore...

Për këtë arsye, mësimi i Kuranit është bërë çështja më jetike e myslimanëve. Myslimanët kanë shfaqur përpjekje shumë të mëdha që Kurani Fisnik të mësohet, të kuptohet dhe të zbatohet në formën më të drejtë siç ka zbritur në fillim. Me këtë synim janë krijuar shumë institucione dhe shkolla të ndryshme, që nga zanafilla e Islamit e deri në ditët e sotme.

Përpjekjen më të madhe në lidhje me këtë, padyshim e ka dhënë i Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilit i është zbritur Kurani. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik se detyra më kryesore e Pejgamberit (a.s.), është që t'ua lexojë njerëzve argumentet e Allahut dhe t'ua mësojë Librin (Kuranin). Kjo de-

tyrë kuptohet qartë edhe në duanë e Ibrahimit (a.s.) dhe Ismailit (a.s.):

“O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’ua lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë (rregullat e fesë) e t’i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!” (el-Bekare, 2/129)

Në Kuranin Fisnik, me shprehje të njëjta apo të ndryshme, shpeshherë përsëritet detyra e Pejgamberit, (a.s.), për t’ua mësuar njerëzve Librin, për t’ua predikuar atë dhe për t’ua shpjeguar.

Edhe vetë i Dërguari i Allahut (a.s.), tregon se është dërguar me këtë qëllim:

“Allahu më ka dërguar si një mësues.” (Ibn Maxhe, Mukaddime, 17; Ibn Abdulber, Ilm, fq. 15)

Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), mori urdhrin “Lexo!”, menjëherë filloi të shfaqte një përpjekje të madhe për këtë. Ajetet që zbrisnin ua lexonte e ua mësonte atyre që besonin, ndërsa femohuesit i informonte dhe i ftonte në besim.

Së pari, këtij synimi i shërbyen luginat e shkreta



të Mekës, kodrat e largëta dhe shtëpitë e lira. Pastaj erdhi një ditë dhe rrugët e panairit e Mekës jehonin me këtë thirrje. Filloi një lëvizje për mësimin e Kuranit. Njerëzit që e arrinin këtë, bëheshin besimtarë. Ata pastroheshin me dritën e Kuranit Fisnik e edukimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe qëndronin të fortë në rrugën e Allahut Teala. Ndërsa ata që nuk besonin, u bënë armiq të hapur të Allahut, të Dërguarit të Tij dhe të asaj që u shpall.

Që në periudhën e Mekës, disa prej sahabëve që kishin mësuar prej të Dërguarit të Allahut, (a.s.), shohim se filluan t'i shërbenin Kuranit. Njëri prej këtyre ishte Ebu Bekri (r.a.). Shumë zemra të gatshme, hynë në Islam me përpjekjen e tij.

Sipas një transmetimi, ai kishte ndërtuar një xhami të vogël në oborrin e shtëpisë. Aty falte namaz natë e ditë dhe lexonte Kuran. Ky njeri i veçantë, që kishte një zemër të butë dhe sytë të përlotur, bëhej edhe më i ndjeshëm kur hynte në klimën e Kuranit Fisnik. Gratë dhe fëmijët, që mblidheshin rreth e rrotull tij dhe dëgjonin atë lexim të sinqertë, hynin në besim. Edhe pse femohuesit i bënin shumë

presione dhe kërcënime, Ebu Bekri, (r.a.), nuk hoqi dorë nga aktiviteti i tij. (Ibn Is'hak, I, 218; Ibn Hisham, II, 219; Buhari, Mesaxhid, 52)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), dërgoi para hixhretit në Medine dy sahabë të mëdhenj e të zgjedhur si mësues. Ata ishin Mus'ab bin Umejri (r.a.) dhe Abdullah bin Ummu Mektum (r.a.). Qëllimi i këtyre dy mësuesve ishte t'u mësonin njerëzve Kuranin dhe parimet e Islamit. Në sajë të përpjekjeve të tyre të jashtëzakonshme, Jethribi u shndërrua në Qytetin e Islamit për një kohë shumë të shkurtër.

Ndërkohë që mësimi i Kuranit vazhdonte me të gjithë shpejtësinë e tij në periudhën e Medines, në anën tjetër institucionalizohej. Disa sahabë emigruan nga jashtë Medines vetëm për të mësuar Librin e Allahut dhe mënyrën e jetesës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Pranë xhamisë së Pejgamberit u ndërtua një vend me emrin Suffa për këta njerëz.

Suffa ishte universiteti i parë islam. Vetë i Dërguari i Allahut (a.s.), jepte mësim aty. Edhe disa sahabë të tjerë ushtruan detyrën si mësues për t'u mësuar atyre shkrim, këndim dhe në mënyrë të veçantë, Kuranin. Për shembull, Ubade ibn Samit, (r.a.), ishte njëri prej sahabëve që u mësonte atyre Kuranin. Me kalimin e kohës, Suffa nuk e përballonte dot më fluksin e madh të njerëzve që vinin të merrnin dituri.

Në fillim të vitit të dytë të hixhretit, u hap një shkollë e re vetëm për mësimin e Kuranit Fisnik, e cila u quajt Daru'l-Kurra. Që në kohën kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte në jetë, numri i këtyre arriti në nëntë. Pejgamberi (a.s.), shkonte shpesh te këto shkolla dhe kontrollonte mësimin. Në këto shkolla mësohej leximi i saktë i sureve, mësimi i tyre përmendsh dhe shpjegoheshin temat e besimit, ibadetit e dispozitave të sheriatit në këto sure. (M. Hamidullah, Islam Peygamberi, II, 768, 771)

Ubade ibn Samit tregon: "Kur dikush vinte në Medine, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e dërgonte te ndonjëri prej nesh që t'i mësonim Kuranin." Ky transmetim na shpreh qartë se Kurani duhet të funksionojë në zemrën, damarët dhe në të gjithë egon e njeriut. Njeriu duhet ta lexojë mesazhin hyjnor, në mënyrë që të kuptojë shpirtin e Islamit, urtësinë e dërgimit të pejgamberëve nga ana e Allahut Teala dhe konceptet e kësaj bote e të ahiretit. Ai duhet të marrë frymë në atmosferën shpirtërore të Librit të Lartë dhe të hyjë në botën e kuptimit.

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut, (a.s.), vazhdonte mësimin e Kuranit, Allahu (xh.xh), zbriti urdhrin:

“Ky është një Kuran, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t’ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”

(Isra, 106)

“Ky është një Kuran, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t’ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.” (el-Isra, 106)

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), lexonte Kuranin, e lexonte ngadalë dhe me tertilë. Ai dëshironte që njerëzit të depërtonin lehtë në Kuran dhe ta kuptonin atë. Ai (a.s.), ishte aq i përpiktë ndaj mësimit të Kuranit, sa që e vlerësonte çdo shans. Sahabët e dëgjonin Kuranin Fisnik në hytbe, në namaz, në mësim, në vaza, në fetva dhe në çështjen e dispozitave të sheriatit. Ata inkurajoheshin që ta mësonin Kuranin dhe t’ua mësonin atë të tjerëve në çdo rrethanë. (Shik. Zerkani, Menahil, I, 128)

Madje, një sahab shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i kërkoi që ta kurorëzonte me një grua. Pejgamberi (a.s.), e urdhëroi të sillte diçka dhe t’ia jepte asaj si meher. Edhe pse ai u përpoq shumë të gjente diçka për mehrin, nuk nuk ia doli. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti se mos dinte ndonjë gjë përmendsh nga Kurani Fisnik. Kur mori një përgjigje pozitive, e kurorëzoi me kusht që t’ia mësonte ato gruas me të cilën e martoi. (Buhari, Fedailu’l-Kur’an, 22)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Më i miri prej jush është ai që mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve.” (Buhari, Fedailu’l-Kur’an, 21) Në një transmetim tjetër shprehet në këtë formë: *“Më i virtytshmi prej jush...”* (Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 15) Tani le të mendojmë: A mund të rrinin sahabët pa bërë asgjë kur dëgjonin këto hadithe dhe të tjera të ngjashme me këto? A mund të nënvlerësonin në çështjen e mësimit të Kuranit për veten e tyre dhe për t’ua mësuar atë të tjerëve?

Abdullah ibn Abbasi, (r.a.), thotë:

“Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), ndërroi jetë unë isha dhjetë vjeç. Deri atëherë unë i pata lexuar dhe mbledhur ajetet muhkem.” (Ibn Kethir, Fedailu’l-Kur’an, I, 150)

Në këtë transmetim shohim përpjekjen e këtij sahabiu që në moshë të vogël për ta mësuar dhe lexuar Kuranin Fisnik. Përsëri nga transmetimi kuptojmë se ai i kishte mësuar në mënyrë të rregullt ajetet muhkem dhe dispozitat për të cilat bëhej fjalë në to. Ndërsa një çështje tjetër që na bën shumë përshtypje, është interesimi i madh i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që shfaqte ndaj tij. Një shenjë tjetër e rëndësisë që i Dërguari i Allahut (a.s.), i jepte atij është edhe fakti se e merrte për të shëtitur dhe lutej për të:

“O Allah! Bëje atë që ta kuptojë fenë mirë dhe mësoja komentimin e Kuranit!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 266)

Së fundi, ky sahabi i nderuar të gjithë jetën e tij ia dedikoi Librit të Allahut Teala, tefsirit të tij dhe meritoi titujt si “Përkthyesi i Kuranit” dhe “Dijetari i Umetit”.

Pasi i Dërguari i Allahut, (a.s.), ndërroi jetë, sahabët e zgjedhur të Tij nuk e shkëputën mësimin e Kuranit Fisnik. Ata, me frymëzimin që morën nga Pejgamberi (a.s.), dhanë përpjekjet më të mëdha në këtë çështje. Ubej b. Ka’bi dhe Zejd b. Thabiti, (r.a.)ma, i vazhduan mësimet e Kuranit në Medine. Ibn Mes’udi në Kufe, Muadh b. Xhebeli në Palestinë, Ebu’d-Derda në Damask dhe Ebu Musa el-Eshari në Basra. Madje, thuhet se në hallkën e mësimit të Kuranit që Ebu’d-Derda jepte pas namazit të mëngjesit në Damask, merrnin pjesë deri në gjashtëqind nxënës. (A. Ajdënlle, “Ebu’d-Derda” DIA, X, 311)



Mësimi i Kuranit Fisnik vazhdoi me të njëjtin ritëm edhe në kohën e tabiinëve. Ebu Abdurrahman es-Sulemi, i cili ishte prej tabiinëve, duke folur për hadithin që e përmendëm më lart, tha: “Ja, ky është hadithi që më ka bërë të ulem këtu dhe t’ua mësoj Kuranin të tjerëve.” Ai e dha këtë shërbim për një kohë të gjatë, duke filluar nga periudha e Hazreti Osmanit (r.a.), e deri në periudhën e Haxhxhaxhit.

Transmetohet se metoda e tij për mësimin e Kuranit ishte njëzet ajete në mëngjes dhe njëzet ajete në mbrëmje. Po ashtu, transmetohet se në mësimet e mëngjesit merrnin pjesë njerëz nga të gjitha klasat dhe së pari u jepte mësim tregtarëve, që të mos vonoheshin në punë. (Ibn Sa’d, Tabakat, VI, 172)

Hadithi në fjalë dhe transmetimet që kanë ardhur nga selefët, e shpjegojnë aq mirë rëndësinë e kësaj çështjeje, saqë nuk lënë nevojë për fjalë të tjera. Së pari, vjen përgjegjësia e mësimin. Mësimi i Kuranit është i hapur për çdo lloj moshe. Familjarizimi me Kuranin nuk ka kufizim moshe. Gjallërimi dhe udhëzimi i njeriut me Kuranin, nuk ka kufizim vendi apo kohe. Mevlana, duke marrë frymëzim nga ky hadith, është shprehur:

“Urtësia e Kuranit është gjëja e humbur e besimtarit. Ai e merr atë kudo që ta gjejë.”

Nga ana tjetër, mësimi i Kuranit Fisnik është shumë i rëndësishëm edhe sot siç ka qenë edhe në të kaluarën. Madje, është edhe më i rëndësishëm. Brezat, në çdo ditë që kalon, po largohen nga shpirti i Islamit e nga Kurani dhe po degjenerohen. Në këtë çështje, fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për një interesim të madh. Ata kanë nevojë për mësimin e Kuranit prej njerëzve të specializuar në këtë fushë.

Nisur nga ky aspekt, ata nuk duhet të privohen nga institucionet ekzistuese, nga shkollat dhe nga mësuesit që japin mësimin e Kuranit Fisnik. Edhe për njerëzit që ua mësojnë Kuranin të tjerëve, ka plot shembuj dhe sakrificat të të Dërguarit të Allahut dhe të atyre që e ndoqën Atë (a.s.). Po ashtu edhe sprovat dhe sakrificat që janë bërë në këtë rrugë kohët e afërta, akoma janë të paharrueshme për memoriet tona.

Ibn Arabiu na këshillon kështu, në lidhje me këtë temë:

“Ndiq fjalën më të bukur! Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Asnjëherë mos nënvlerëso ta lexosh atë duke medituuar thellë. Nëse vepron kështu, shpresohet që Allahu Teala të të japë frymëzimin e mirësisë së kuptimit të asaj që ke lexuar. Jepi rëndësi mësimin të Kuranit! Nëse vepron kështu, bëhesh mëkëmbës i Rrahmanit, sepse ai që ua mëson Kuranin të tjerëve, të mos harrojë se Rrahmani është ai që e ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar bejanin (Kuranin). (Rahman, 1-4; Ibn Arabi, Ögütler Pınarı, përkth. Adem Ergyl, fq. 159)

T’i japësh rëndësi mësimin të Kuranit për vete dhe për të tjerët, do të thotë që ta takosh një njeri me Kuranin. Ta njohësh atë me frymëzimin dhe begatinë e fjalës hyjnore, do të thotë t’ia bësh të qartë urtësinë e jetës e vdekjes dhe t’i japësh dije rreth të kaluarës e të ardhmes. Do të thotë ta shpëtosh nga gjëra të padobishme dhe ta mbartësh në horizonte të pafundme. Shkurtimisht, mësimi i Kuranit Fisnik është mbrojtje e orientimit të brezave dhe dorëzim i amanetit të pasardhësit.



Xhemati

PASURIA MË E SHTRENJTË E IMAMIT

— Doç. dr. Fikret Karaman —

QËLLIMI I SHËRBIMIT FETAR

Në përgjithësi historia dhe jeta e kombeve është ndriçuar përmes fesë, diturisë dhe urtësisë së sjellë nga pejgamberët. Në këtë mënyrë, me kalimin e kohës njerëzimi ka siguruar përparimin e tij, duke zhvilluar shkencën, mendjen, vullnetin, punën, përpjekjen dhe përvojën e vet. Pasuritë botërore, si kultura, qytetërimi, arti dhe vlera të tjera janë prodhim i një pune të gjatë. Roli i unitetit dhe përpjekjes njerëzore është i padiskutueshëm në rritjen e këtyre sukseseve. Por fatkeqësisht, në themel të padrejtësive dhe despotizmit është përsëri elementi njeri. Duke u nisur nga kjo, arrijmë në konkluzionin se paqja, qetësia dhe stabiliteti botëror janë lidhur pazgjidhshmërisht me mendimin, vullnetin, veprimin dhe sjelljet e njerëzve. Për këtë arsye, qëllimi kryesor i dërgimit të pejgamberëve e librave

hyjnorë ka qenë disiplinimi i sjelljeve të njeriut. Thënë ndryshe, synimi i përbashkët i çdo fushe dhe profesioni është edukimi i një njeriu dhe qytetari të mirë. Nga kjo pikëpamje, qëllimi kryesor i shërbimit fetar është ndihma për të besuar drejt, për të adhuruar saktë dhe për të përmirësuar sjelljet e njeriut. Në fakt, qëllimi kryesor i fesë është sigurimi i lumturisë së njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër. Në këtë kontekst, synimi i imamit është sigurimi i një potenciali të pasur xhemati. Në këtë këndvështrim, xhemati përbën një thesar të pashtershëm për imamin. Prezantimi, këshillimi, negociimi, afrimiteti dhe konsultimi me xhematin kanë rëndësi vitale për arritjen e qëllimit. Kjo arrihet vetëm me ndërmjetësimin e imamit, sepse kuadrot fetarë janë në qendër të xhamisë, e cila konsiderohet si hapësirë e përbashkët sociale. Për këtë arsye, ata

janë në kontakt të vazhdueshëm me njerëzit dhe, që ky kontakt t'i shërbejë qëllimit, duhet të realizohet vetëm përmes një komunikimi sa më produktiv.

FEJA URDHËRON BASHKIMIN

Feja islame urdhëron për bashkim, unitet, solidaritet dhe kontribut social. Në asnjë mënyrë feja islame nuk e lejon përçarjen, ndarjen dhe grindjet. Kjo është e vlefshme brenda dhe jashtë xhamie. Sipas Kuranit, ndihma e ndërsjelltë konsiderohet themel i ekzistencës sonë dhe begati e çmuar dhuruar njeriut. **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.”** (Ali Imran, 103)

Për nga aftësia, inteligjenca dhe mënyra e të menduarit, njerëzit mund të jenë të ndryshëm. Divergjencat në pikëpamje dhe mendime janë më se normale, duke qenë se njerëzit janë të natyrave të ndryshme, por këto divergjencat duhet të mbesin vetëm në domenin e mendimit. Divergjencat nuk duhen shndërruar në urrejtje, mëri dhe inat, duke shkelur kufijtë e respektit dhe mirëkuptimit reciprok, për më tepër kur jemi të gjithë udhëtarë të një rruge, që Allahu e quan në Kuran rruga e drejtë: **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkonit rrugëve të tjera, që ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai, për t'u ruajtur nga të këqijat.”** (En'am, 153)

Siç konstatohet lehtë, bashkimi dhe uniteti shprehin një rëndësi të madhe për jetën sociale. Ndhima reciproke nuk është e nevojshme vetëm për botën e njeriut, por edhe për atë të kafshëve dhe bimëve. Pejgamberi (a.s.), duke na kujtuar rëndësinë e unitetit, bashkimit, solidaritetit thotë: **“Ju duhet të veproni bashkërisht. Ruajuni nga ndarjet dhe grupacionet, sepse shejtani është me atë që vepron vetëm dhe qëndron larg atyre që këshillohen me njëri-tjetrin...”** (et-Taxh; Kitabu'l-Fiten, v. 5, fq. 308) Bashkimi, uniteti, këshillimi, konsultimi dhe ndihma reciproke janë të vlefshme për çdo shoqëri dhe për çdo kohë. Xhamia dhe xhemati japin një kontribut të pazëvendësueshëm në realizimin dhe ruajtjen e vlerave të lartpërmenduar.

XHAMIA DHE XHEMATI

Në kuptimin etimologjik, xhamia shpreh vendin që bashkon dhe mbledh njerëzit. Kurse imamët janë

kuadrot fetarë që shërbejnë në këto vende. Në këtë mënyrë, detyra e tyre është e lidhur drejt-përdrejt me xhaminë. Kurse xhemati shpreh grupin e njerëzve që mbledhen së bashku për të kryer ritin e namazit në xhami. Islami nxit me këmbëngulje për kryerjen e ibadeteve kolektive. Përmes namazit me xhemat forcohen lidhjet shpirtërore midis njerëzve. Namazi me xhemat krijon mundësinë për t'u njohur, për t'u takuar dhe për t'u informuar rreth aktualitetit. Kjo siguron një mjedis të dashur, të respektuar dhe harmonik. Pejgamberi (a.s.), gjatë gjithë jetës e ka kryer namazin me xhemat. Madje edhe kur u sëmur rëndë, përpiqej të mos ndahej prej xhematit. Pejgamberi (a.s.), i këshillon besimtarët të falin namazin me xhemat edhe kur janë në udhëtim apo gjendje lufte. Kurse namazi i xhumasë dhe bajramit, është detyrim të falen me xhemat. Mospjesëmarrja në namazin me xhemat mund të përliqet vetëm në raste të tilla, si sëmundja, udhëtimi, errësira e natës, temperaturat tepër të larta ose tepër të ulëta, personi i moshuar që nuk është në gjendje të lëvizë dhe mungesa e sigurisë. Megjithë këto arsye të forta për të mos shkuar në xhami, Ebu Hurejre transmeton një hadith shumë kuptimplotë për rëndësinë e kryerjes së namazit me xhemat. Një ditë, një i verbër vjen tek Pejgamberi (a.s.) dhe, duke i kërkuar leje për ta kryer namazin në shtëpi, i thotë: **“O i Dërguari i Allahut! Unë nuk kam një njeri që të më shoqërojë për në xhami.”** Pejgamberi (a.s.), i dha leje, por kur u nis të ikte, i tha: **“A e dëgjon ezanin?”** **“Po”**, - tha i verbëri. **“Atëherë përgjigjiu thirrjes.”** (el-Xhezeri; Xhamiu'l Usul)

Nga ana tjetër, Pejgamberi na lajmëron se namazi kolektiv është njëzet e shtatë herë më i vlefshëm se namazi individual.

Që ky shërbim të arrijë synimet, duhet që kuadrot të jenë të arsimuar, të aftë dhe të zotërojnë përvojën e duhur për mirëfunksionimin e këtij shërbimi. Imamët duhet të njohin shumë mirë psikologjinë e xhematit, në mënyrë që të ketë një nivel të lartë dobishmërie. Nga ana tjetër, imami duhet ta ndjekë nga afër aktualitetin në të cilin jeton vendi i tij, sepse kjo e ndihmon të jetë koherent dhe në sinkron të plotë me zhvillimin e sotëm. Për nga detyra dhe roli që ka, imami duhet të jetë gjithëpërfshirës, të mos bëjë dallim midis individëve të xhematit. Imami duhet të organizojë aktivitete të ndryshme kulurore, shkencore, sportive etj., me xhematin, sepse kjo ruan dinamizmin dhe rrit bashkëpunimin midis tyre. Vetëm duke i qëndruar afër dhe vlerësuar si duhet, xhemati mund të bëhet një fuqi potenciale e madhe.



REALITETI I NJERIUT NË VIJËN E PAFUND TË PLUSEVE DHE MINUSEVE

— Dr. Adem Ergyl —

Ibn Ataullah el-Iskenderi ka thënë:

“Në qoftë se Zoti do të të kishte lënë ty në dorën tënde, nuk do të reshtje së numëruari gabimet dhe të metat që ke. Por, në qoftë se Zoti i Lartë do të tregonte Ekzistencën e Tij (me anë të emrave,tributeve dhe shfaqjeve hyjnore) mbi qenien tënde, atëherë nuk ka kufi për bukuritë tuaja, me të cilat do të lavdëroheshe.

Bëhu vetvetja, kapu pastributeve të Zotit, përpiqu të mos largohesh asnjë çast prej tyre dhe kujdesu të realizosh në formë të përkryer në personalitetin tënd të gjitha cilësitë që do të duhej të kishe, në mënyrë që të përmbushësh siç duhet detyrën tënde si rob i Zotit.”

Nga vepra el-Hikemu'l-ataijje

Njeriu është një krijesë tek e cila, brenda kornizës së veçantë që përvijoi Kurani për të, përjetohen batica dhe zbatika të shumta mes infinitit pozitiv dhe atij negativ. Me fjalët e Kuranit, një krijesë e veçantë që përmban në vetvete edhe avantazhin, edhe rrezikun që të ndërrojë në çdo çast vend mes horizonteve të “ahseni takvim” dhe humnerave të “esfeli safilin”.

Pretendimi i zgjidhjes totale të enigmës së ngritjeve dhe zbritjeve në jetën e njeriut do të thotë të kalosh aftësitë tuaja. Megjithatë, nuk është se nuk ekzistojnë edhe shenjat që tregojnë ekzistencën e kësaj bote enigmash. Prandaj në këtë artikull do të përfshijmë këtë urtësi të Ibn Ataullah el-Iskenderiut, i cili çeli qoftë edhe një dritare të vogël në lidhje me këtë botë:

“Në qoftë se Zoti do të të kishte lënë ty në dorën tënde nuk do të reshtje së numëruari gabimet dhe të metat që ke. Por, në qoftë se Zoti i Lartë do të tregonte Ekzistencën e Tij (me anë të emrave, at-

ributeve dhe shfaqjeve hyjnore) mbi qenien tënde, atëherë nuk ka kufi për bukuritë tuaja me të cilat do të lavdëroheshe.”

Në këtë botë asnjë gjë nuk mund të realizohet jashtë vullnetit të Zotit. Këtë njohuri të marifetit, Kurani Fisnik ua zbrit zemrave të besimtarëve nëpërmjet këtyre duave:

Thuaj (o Muhamed): “O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe ul kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.”
(Ali Imran, 26)

Besimtari, i zhytur në thellësinë shpirtërore që krijon në zemra ky ajet, sheh dhe ndjen madhësinë, fuqinë dhe vullnetin e pakrahasueshëm të Zotit dhe përcakton saktë kufijtë që duhet të ruaj si rob i Tij, si dhe etikën dhe edukatën që duhet të tregojë në këtë situatë. Sipas sqarimeve të Kuranit, njeriu “është krijuar i dobët”, “është përherë nevojtar për ndihmën dhe mbështetjen e Zotit”, “mund të bëhet idhujtar i egos së vet”, “është mosmirënjohës”, “është injorant” dhe “është i prirur për dhunë”. Në këtë gjendje, po të lihet të bëjë si të dojë, vetë njeriu do të shndërrohej në një krijesë të ngratë që nuk i njeh të vërtetat, “që shkon duke u rrokullisur poshtë e më poshtë” në rrugën e plotësimit të nevojave të tij vetjake që nuk njohin kufi, tek e cila mblidhen të gjitha të këqijat dhe gjërat e turpshme që nuk mund t’i ketë asnjë krijesë tjetër. Rruga e vetme e shpëtimit është vetëm orientimi që vjen nga mëshira dhe begatia hyjnore. Me një shprehje tjetër, njeriu duhet të përpiqet përherë të meritojë mëshirën e Zotit, të mos mbështetet vetëm tek vetja dhe punët që ka bërë, por të jetë nevojtar për Zotin dhe të ndjejë përherë përbrenda nevojën e vazhdueshme për lutje, dua dhe përgjërëm ndaj Zotit të gjithësisë. Këto fjalë që transmetohen nga profeti Jusuf (a.s.), janë shprehja më e bukur e kësaj të vërtete:

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Jusuf, 53)

Dhe Profeti (a.s.), që e njëjhte shumë mirë këtë enigmë, dëshironte në mënyrë të vazhdueshme të strehohej në mëshirën e Zotit. Prandaj, në varësi të asaj që raportohet, ai këshillonte të bëhej kjo dua ndaj çdo lloj situatë problematike:

“Allahu im! Unë kam shpresë vetëm tek mëshira Jote. Mos më lër në duart e egos sime, qoftë edhe sa hap e mbyll sytë. Bëj të jem i rregullt me jetën time të përditshme, sepse nuk ka Zot tjetër përveç Teje.”
(Ebu Davud, Edeb, 100-101/5090)

Në qoftë se njeriu lihet të veprojë sipas kërkesave që burojnë nga egoja e tij, ai do të rrokulliset



përherë e më shumë drejt humnerës së rrugës së gabuar. Askush nuk mund ta dijë se ku ndal kjo rrokullisje. Aq më shumë që nuk ka të keqe që njeriu nuk e bën për hir të ambicieve dhe kënaqësive të tij trupore. Historia e njerëzimit është e mbushur me shembuj të panumërt të kësaj të vërtete. Në këtë aspekt, mund të thuhet se çdo nefsi strehon brenda tij në mënyrë të natyrshme faraonin, Karunin dhe shejtanin. Kjo është edhe arsyeja përse njëri nga aspektet e misionit të dërgimit të profetëve qe de-tyra e purifikimit të njerëzve, duke i çliruar ata nga robëria ndaj nefsit.

Njeriu është krijuar me kapacitetin që edhe të mund të udhëtojë drejt infinitit negativ, për të cilin u fol më sipër, edhe të shkojë drejt infinitit pozitiv në sajë të mirësisë, shfaqjeve të panumërta dhe gostisë së Zotit të tij. Për sa kohë që vazhdon ky udhëtim në këtë drejtim, ai do të kundrojë edhe bukuritë e panumërta hyjnore, me fjalë të tjera, shfaqjet e bukurisë hyjnore. Enigma e vazhdimit të këtij udhëtimi është arritja e “mëshirës dhe udhëzimit hyjnor”. Ashtu siç ka shumë aspekte të kësaj shfaqjeje të mbushura me enigma dhe urtësi, është e vërtetë edhe se ka një sërë kodesh që i mësohen si shprehje e favorizimit hyjnor një grupi të caktuar njerëzish të devotshëm. Këto ajete mund të na japin drejtim në lidhje me arritjen e mëshirës hyjnore:

“Besimtarët dhe besimtare të jenë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zeqatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta



janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." (Tevbe, 71)

"Vërtet, ata që besuan dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë." (Bekare, 218)

"Kështu, ata që besojnë Allahun dhe mbështeten fort tek Ai, (ta dinë se) Ai do t'i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Vet dhe do t'i udhëzojë drejt Vetes përmes rrugës së drejtë." (Nisa, 175)

Në këtë ajet fisnik tregohet kodi i përfitimit të shfaqjes hyjnore, që është aq e nevojshme për udhëzimin e pafund në udhëtimin drejt "ahseni takvimit":

"Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirë!" (Ankebut, 69)

Ja pra, me këto rrugë që i mësohen nga mëshira hyjnore, njeriu tek i cili shfaqen mëshira dhe udhëzimi hyjnor shndërrohet në një ekspozitë të tillë stolish, të cilat as fjalët dhe as boja nuk mjaftojnë t'i përshkruajë. Ata që ngjyhen me bojën e Zotit, që është boja më e mirë (Bekare, 138), nuk i përfshijnë me forcën e shikimit të kësaj bote të gjitha dimensionet e kësaj të vërtete. Në qytetërimin tonë, kjo arritje është quajtur si niveli i "njeriut të përsosur".

Në vazhdim të urtësisë së mësipërme, Ibn Atullah vazhdon dhe thotë kështu, duke dashur t'i tregojë rrugën atij që kërkon të bukurën:

"Bëhu vetvetja dhe kapu pas attributeve të Zotit. Përpiku të mos largohesh asnjë çast prej tyre dhe shih të realizosh në formë të përkryer në personalitetin tënd të gjitha cilësitë që do të duhet të kishe, në mënyrë që të përmbushësh siç duhet detyrën tënde si rob i Zotit."

"Kur thuhet atributet e Zotit, në mendje të vijnë atributet e Tij të përkryera në pafundësi, siç janë madhështia e Zotit, që nuk ia ka nevojën askujt në gjithësi, i plotfuqishëm, që di çdo gjë që ndodh. Kur thuhet karakteristikat e robit të Zotit, para sysh të vijnë veçoritë e tilla të mangëta, si: paaftësia, dobësia, varfëria, nevoja, injoranca.

Të qëndrosh i lidhur pas karakteristikave të Zotit, do të thotë t'i përgjeroresh Atij në çdo veprim, të mbështetesh vetëm tek Ai dhe t'i besosh vetëm Atij, cilido qoftë veprimi që do të kryesh dhe zemra jote të qëndrojë larg çdo gjëje tjetër përveç Zotit. Zoti është e vërteta e madhe absolute për botën e krijesave. Në qoftë se njeriu vazhdon të vështrojë në madhësinë dhe përkryerjen e Tij, në fund fare do të bëhet i shenjtë (aziz). Çdo gjë në këtë botë, përveç Zotit, do të vijë përherë duke u zvogëluar në sytë dhe zemrën tënde. Në qoftë se do të lidhesh pas së vërtetës se Zoti është zotëruesi i vërtetë i të gjithë thesareve të kësaj bote dhe në këtë mënyrë edhe i pavarur nga çdo gjë tjetër, shumë shpejt edhe ti do ta kuptosh se nuk ke nevojë për gjë tjetër, përveç Atij dhe do të arrish fatin të ndjehesh i lirë nga çdo gjë tjetër me përjashtim të Zotit tënd. Në qoftë se lidhesh fort pas fuqisë dhe forcës së Zotit, nuk do të kërkosh për fuqi dhe forcë tjetër përveçse Tij, kur të jesh i dobët dhe pa përkrahje. Do t'i drejtosh vetëm Atij dhe vetëm prej Tij do ta kërkosh ndihmën. Shkurtimisht, për sa kohë që vazhdon ky interes ndaj Zotit, do të përfitosh nga gjithë atributet e Tij dhe do të arrish të përfitosh prej bukurisë dhe përsosmërisë së pakrahasueshme.

Për sa i përket arritjes së cilësive të robit të Zotit në egon tënde dhe shndërrimin në një rob të vërtetë të Zotit, rruga drejt saj është e tillë: Të tregosh modestinë maksimale ndaj Zotit, të distancohesh nga çdo lloj pretendimi për t'i dhënë vetes rëndësi dhe të shndërrosh ndjenjën e nevojës ndaj Zotit në shprehinë e natyrës tënde. Zhduke pandehmën se je i fortë dhe i fuqishëm. Kupto se fuqia dhe forca realizohen vetëm nëpërmjet bamirësisë dhe gostisë së Zotit. Mos pretendo të arrish tek e vërteta absolute duke ndjekur një rrugë tjetër nga ajo që të urdhëron Zoti. Shkurtimisht, të tregosh bindje të plotë me gjithë zemër ndaj urdhrave të Zotit, të kërkosh famën dhe nderin tënd pranë Tij dhe me Të, të shijosh lirinë dhe kënaqësinë e të qenit vetëm Rob i Zotit." (Ibn Axhibe, Ikadhu'l-himem, 295-296)

Sinqeriteti i zemrës dhe i gjuhës

— Mustafa Erish —

Sufjan ibn Abdullahu, (r.a.), i tha të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! Ma shpjego Islamin në atë mënyrë, që të mos kem nevojë më të pyes dikë tjetër përveç Teje.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

“*Thuaj i besova Allahut, pastaj ji i drejtë!*” (Muslim, Iman 62. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Zuhd 61; Ibn Maxhe, Fiten 12.)

Në shpjegimin e këtij hadithi, që përmendet në Rijadu’s-salihin, shtjellohen këto specifika:

Në drejtësi ka shumë rëndësi sinqeriteti i zemrës dhe gjuhës.

Zemra është kryetarja e të gjitha organeve të trupit.

Një zemër që i beson vetëm Allahut dhe përvetëson sinqeritetin, ndikon edhe te organet e tjera.

Gjuha është përkthyesi i zemrës.

Sinqeriteti dhe dredhia e gjuhës ndikojnë te sjelljet e organeve të tjera.

Në hadithin fisnik, thuhet:

“Çdo mëngjes, të gjitha organet i thonë gjuhës: ‘*Ki frikë Allahun për ne. Ne jemi të lidhura me ty. Nëse ti je e sinqertë, edhe ne jemi të sinqerta. Nëse ti nuk je e sinqertë, edhe ne nuk jemi të sinqerta.*’ (Shik. Rijadu’s-salihin, hadithi 1524.)

Në një hadith tjetër thuhet:

“*Përderisa zemra të mos jetë e sinqertë, robi nuk mund të ketë besim të vërtetë. Zemra nuk mund të jetë e sinqertë, përderisa gjuha të mos jetë e tillë.*” (Ahmed b. Hanbel, Musned III, 198.)

Atëherë, njeriu duhet të jetë i sinqertë në zemër dhe në gjuhë.



Ky është kuptimi i hadithit të të Dërguarit të Allahut (a.s.): “*Thuaj i besova Allahut, pastaj ji i drejtë!*”

Edhe Islami ky është.

Allahu i Madhëruar, që ka vendosur një rregull për çdo gjë që ka krijuar, kërkon nga ne një adhurim të sinqertë.

Kërkon të besojmë dhe të bëjmë një jetë sipas dispozitave të Islamit.

Na këshillon të jetojmë, duke e lavdëruar dhe falënderuar për mirësitë që na ka dhuruar.

Ndërsa, ata që jetojnë me sinqeritet në rrugën e drejtë të Islamit, i njofton për sihariqin që do t’u sjellin engjëjt në frymën e fundit.

Në Kuranin Fisnik, thuhet:

“*Me të vërtetë, atyre që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu’, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt* (para vdekjes) *e do t’u thonë: ‘Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.’*” (Fussilet, 30)

Sa përgëzim i madh!..

Çfarë ftese fisnike!..

Sa vend i mrekullueshëm që është xheneti!..

O Zot! Na bëj prej atyre që i fitojnë këto përgëzime!..

Na ndero me pamjen Tënde në xhenet!..

Na bëj prej atyre që e meritojnë këtë nderim dhe mirësi të madhe!..



Dy fytyrat e vdekjes

— Xhemal Nar —

Shkrimtari i famshëm rus, Tolstoi po përpëlitej në depresion. Atë e kishte kapur një sëmundje e rëndë dhe po përjetonte dhimbje të mëdha. Filloi të mendonte: “A t’i jap fund jetës sime me një plumb apo me një lak?!” Vetën e tij ia përngjasonte një udhëtari në mesin e shkretëtirës:

Udhëtari hidhet në një pus pa ujë për të shpëtuar nga një kafshë e egër, e cila i kishte dalë përpara. Pikërisht në ato momente, në fund të pusit shikon një kuçedër, që e priste me gojën hapur. Ky udhëtar i shkretë nuk guxonte të dilte sipër sepse mund ta copëtonte kafsha e egër, por as poshtë nuk zbriste dot, sepse e hante kuçedra. Kështu që u kap fort te një degë që kishte dalë ndërmjet gurëve të murit të pusit. Pas pak, duart fillojnë t’i mpihen dhe ai e kupton se do të jetë i detyruar të bjerë në tragjedinë që e pret në njërin nga dy anët, por prapëseprapë mbahet fort. Në ato momente shikon disa minj që sillshin rreth degës ku ishte mbajtur dhe po e brenin atë. Dega do të këputet dhe ai do të bjerë në gojën e kuçedrës. Atëherë, udhëtari e kupton se tashmë nuk i ka mbetur më asnjë mundësi për të shpëtuar. Ndërkohë që sheh rreth e rrotull i dëshpëruar, vë re se nga gjethet e degës po del mjaltë. Ai e nxjerr gjuhën dhe fillon ta lëpijë.

Faktikisht, kjo është një përrallë e lindjes. Tolstoi thotë:

“Edhe unë i ngjaj këtij udhëtari. Edhe pse e dija se vdekja po më priste në mënyrë absolute dhe se kuçedra ishte e gatshme të më copëtonte, kapesha te degët e jetës me një shpresë të fundit, edhe pse nuk e kuptoja pse kapesha te ato. Përpiqesha të lëpija mjaltin, i cili më kishte ngushëlluar deri atë ditë, por tashmë edhe atij nuk i kishte mbetur më shije. Ndërkohë që kuçedra e vdekjes e kishte hapur gojën dhe po priste të më gëlltiste, minjtë brenin degën e jetës në të cilën isha kapur. Ndërsa unë shikoja vetëm

kuçedrën dhe minjtë prej të cilëve nuk ikja dot. Sytë nuk i ndaja prej tyre. Mbi të gjitha, ky nuk ishte një shembull, por vetë e vërteta.”

Për ata që nuk i besojnë Allahut dhe Ditës së Gjykimit, vdekja është realiteti më i tmerrshëm. Ajo pothuajse është si një vrimë e zezë. Si perëndimi i diellit për të mos lindur kurrë më. Pothuajse është një vend ekzekutimi që shihet çdo moment. Është burimi i dhimbjes që i shkatërron dëshirat, shpresat dhe pasionet.

Ndërsa për besimtarin, vdekja është një dritare e hapur ndaj pavdekshmërisë dhe jetës së përhershme. Është momenti i takimit me të dashurin. Sipas Mevlanës, është shebi arus (nata e dasmës). Është kthim te atdheu i vërtetë dhe përfundim i kurbetit. Është shpëtim i shpirtit nga burgu i trupit. Është dalje e zogut nga kafazi. Të dënuarit vetëm gëzohen nga shkatërrimi i burgut. Ata nuk thonë:

“Ah sa keq që u prish ndërtesa.” Të gjithë festojnë, përveç atij të dënuarit që do të çohet për t’u ekzekutuar. Shpirti shpëton nga zënka e trupit dhe fillon të fluturojë me flatrat e zemrës. Mevlana e përshkruan kështu këtë gjendje:

“Kjo gjendje është si ëndrra e atij që e kanë burgosur në errësirën e burgut, por në gjumë e sheh veten si të jetë në bahçe me trëndafila. Ky njeri thotë: ‘O Zot! Mos më kthe te trupi im, që të shëtis në këtë bahçe me trëndafila. Tashmë, a dëshiron ai njeri të zgjohet dhe të jetojë i lidhur me zinxhirë e me pranga në fund të pusit?’

Vdekja është shpëtim nga kafazi i trupit dhe dalje nga pusi si Jusufi (a.s.). Vdekja, që kafirit i duket si gjyotinë, për besimtarin është një derë që hapet ndaj pavdekshmërisë. Mevlana e tregon kështu gëzimin e vdekjes:

“Aq sa gëzohet zogu kur e lë kafazin dhe fluturon,

po aq gëzohem edhe unë kur të vdes dhe të largohem nga trupi. Zogu në kafaz i vendosur në bahçe, i shikon trëndafilat dhe pemët. Zogjtë që cicërojnë rreth e rrotull jashtë kafazit, këndojnë këngë të bukura për lirinë. Zogu në kafaz i dëgjon ata dhe e sheh gjelbërimin. Pastaj nuk ka as oreks, as durim dhe as vendosmëri. E nxjerr kokën në çdo vrimë të kafazit dhe dëshiron të shpëtojë nga ai burg. Ai zog e ka zemrën dhe shpirtin jashtë. Çfarë do të bënte në këtë gjendje, nëse ia hapim derën kafazit?”

Edhe gjendjen e jobsimtarit Mevlana e ka përngjarë me gjendjen e një zogu në kafaz të rrethuar nga macet dhe thotë:

“Ky lloj zogu është i tmerruar nga frika. Ai kurrë nuk dëshiron të dalë nga ai kafaz. Madje, për shkak të së keqes që e pret, dëshiron të ketë edhe njëqind kafaze të tjera.”

Gjendja e jobsimtarit është si gjendja e fëmijës në barkun e nënës. Mirësia e Zotit e tërheq për të dalë jashtë, ndërsa ai përsëri ikën drejt mitrës. Edhe fëmija në bark të nënës nuk e di se jashtë mitrës ka një botë të madhe. Nuk e di se mirësitë në mitër janë nga begatia e botës së jashtme. Edhe uji dhe ushqimi në kafaz vijnë nga bota e jashtme. Zogu i trembur nga macet, shndërrohet në një mi që kërkon vrimë për t’u fshehur. Prandaj, shpirti i tij e ka bërë vatan vrimën e kësaj bote, sepse e ka prerë shpresën për të dalë jashtë. Por e vërteta është kjo: Sado që zogu të mbrohet, në fund nuk do të shpëtojë nga kthetrat e vdekjes.

Burimi i çdo lloj frike është frika e vdekjes. I sëmuri me kancer frikësohet më shumë nga vdekja se sa nga sëmundja, sepse kanceri sjell vdekjen. Heroizmi më i madh është mposhtja e frikës së vdekjes apo siç shprehet Ikbali: “Ta presësh vdekjen duke i buzëqeshur.” Dallimi më i rëndësishëm që e ndan besimtarin nga femohuesi është sjellja kundrejt vdekjes.

Besimi e kthen mosekzistencën në ekzistencë. Sa bukur ka thënë Junusi:

“Përse ke frikë nga vdekja?

Mos ki frikë dhe do të jesh i përhershëm.”

Tolstoi, që përjetoi gjithë këto vështirësi, më në fund shpëtoi nga fobia e tmerrshme e vdekjes në sajë të besimit dhe arriti të vërtetën e përhershme, që nuk mund ta vrasë as vdekja. Le ta dëgjojmë nga vetë ai se si e ka arritur këtë të vërtetë:

“Më së fundi, e hetova veten time dhe pashë se çfarë po ndodhte brenda meje. M’u kujtuan me qindra ngjarje rreth vdekjes dhe ringjalljes. Pashë se unë jetoja vetëm kur i besoja Zotit. Ndërsa kur e harroja Atë, apo kur nuk e besoja, zhdukej edhe jeta. Kur humbisja besimin ndaj ekzistencës së Zotit,

pothuajse këputeshin edhe lidhjet e mia me jetën. Sikur të mos kisha pasur qoftë edhe pak shpresë për të gjetur Zotin, do të kisha bërë vetëvrasje që kohë më parë. Por po jetoja. Po jetoja kur e ndjeja dhe e kërkoja Atë. Atëherë, Ai ekziston. Ai është një qenie, pa të Cilin nuk jetohet. Njohja e Zotit dhe zbatimi i urdhrave të tij, është diçka unike dhe e veçantë. Zoti është jetë. Përderisa jetoj duke e kërkuar Zotin, jeta pa Të është e pamundur.”

“Besimi i jep kuptimin e pafundësisë ekzistencës së vdekshme të njeriut. Domethënë, një kuptim që nuk zhduket nga vuajtjet, sakrificat dhe vdekja. Kjo do të thotë se kuptimi dhe mundësia e jetës mund të gjendet vetëm te besimi. Besimi është forca e jetës. Pa besim nuk jetohet.”

Tolstoi, në librin e tij me titull Ivan Iljiç, përshkruan gjendjen e dhimbshme të një njeriu që përpëlitej në dhimbje të padurueshme, që kishte frikë nga vdekja, që nuk e pranonte dot gjendjen e tij duke kundërshtuar Zotin, që nuk gjente rrugë përtej vdekjes dhe që po dirgjej. Ivan Iljiçi filloi të qante si fëmijë. Po qante për vetminë e tmerrshme dhe thoshte:

“Përse më bërë kështu? Përse më solle në këtë gjendje? Çfarë kam bërë unë? Çfarë kam bërë që po vuaj kaq shumë? Ç’është ky zemërim? Ç’nevojë kisha për këtë?”

Me këto shprehje ai po kundërshtonte Zotin, që pandehte se nuk e besonte. Faktikisht edhe kundërshtimi është shprehje e besimit, sepse njeriu nuk mund kundërshtojë një qenie që nuk e beson. Edhe Ivan Iljiçi, që përpëlitej nga dhimbjet dhe frika, më në fund e kuptoi të vërtetën. Në vetvete thoshte:

“Vdekja iku. Tashmë ajo nuk është më.” Tashmë, në vend të vdekjes kishte dritë. Vdekja kishte vdekur, zhdukja ishte zhdukur dhe kishte ardhur ekzistenca e përhershme.

Sikur të mos ishte ekzistenca e përhershme, të gjitha krijesat nuk do të ekzistonin. Të përkohshmit vijnë nga përhershmeria. Mevlana shprehet:

“Nëse nuk ekziston bota tjetër, atëherë, nga vijnë ata që vijnë dhe ku shkojnë ata që shkojnë?”

Le ta përfundojmë artikullin tonë me këtë strofë të një poeti:

“Vdekja nuk është as larg dhe as afër,

Çfarë mund të na bëjë vdekja, përderisa kemi arritur përhershmerinë?”



“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit.

Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona.

Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.”

(Furkan, 30)

Historia e Jahudive zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e Kuranit, sepse ata ishin një popull që Allahu i kishte nderuar me shpallje hyjnore, por nuk treguan respekt dhe besnikëri ndaj shpalljes, duke u zhytur në mëkate dhe mosbindje. Sthurja dhe zvetënimi që u ndodhi atyre mund t’u ndodhë edhe myslimanëve. Prandaj, kjo shërben si një paralajmërim për myslimanët për të mos rënë në gabimet e jahudive.

Në fakt, po t’i hedhim një vështrim shoqërisë myslimane, do të vëmë re që myslimanët janë prekur nga shumë sëmundje me të cilat kanë qenë prekur edhe jehuditë, si: injoranca fetare, dhënia pas pasurisë, mungesa e sinqeritetit, katranosja e zemrave dhe neglizhenca ndaj urdhëresave fetare. Nëse nuk nxjerrim mësimet e duhura nga Kurani, atëherë ne jemi të destinuar t’i përsërisim vazhdimisht gabimet në të cilat kanë rënë jehuditë. Kurani na tregon që jehuditë nga njëra anë pretendojnë se xheneti u përket vetëm atyre, kurse nga ana tjetër nuk e dëshirojnë vdekjen dhe bëjnë gjithçka për të shpëtuar prej saj. Shkaku kryesor i këtij absurditeti është dhënia pas kësaj bote. Madje, ata janë të dhënë më shumë se politeistët, të cilët e mohonin botën e përtejme. Por fatkeqësisht, një pjesë e mirë e myslimanëve janë prekur nga kjo sëmundje.

Kurani po ashtu, na tregon për sjelljet e rabinëve, të cilët edhe ata ishin dhënë pas përfitimeve materiale të kësaj bote. Kurani e përshkruan kështu gjendjen e tyre: **“Pas tyre erdhi një brezni, e cila e trashëgoi Librin (Teuratin), por duke marrë gjërat e pavlefshme të kësaj bote dhe duke thënë: ‘Do të na falet çdo gjë!’ Edhe nëse u binin në dorë gjëra të ngjashme, prapë i merrnin**

ato.” (Araf,169)

Kurse ajeti Kuranor: **“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe u bë nga të humburit. Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.”** (Araf,175-176), tregon gjendjen në të cilën përfunduan ata.

Dijetarët e fesë u dhanë pas interesave dhe përfitimeve të kësaj bote, duke harruar dhe duke u larguar prej qëllimit që pretendonin se përfaqësonin. Ata filluan ta përdornin fenë në shërbim të interesave të tyre. Nuk i shërbenin më përhapjes së Tevhidit, por interesave dhe plotësimit të kënaqësive vetjake. Predikimi i tyre fetar përbëhej nga fjalë të thata pa entuziazëm. Ata u bënë shkak për devijimin dhe shthurjen e popullit, i cili i merrte si model njerëzit e fesë. Dijetarët e fesë, të zënë me punët e kësaj bote, nuk ishin më në gjendje për të këshilluar popullin. Kurani këtë gjendje e përshkruan kështu: **“Përse rabinët dhe dijetarët nuk i ndalojnë ata të thonë fjalë të ulëta (për Zotin) dhe të hanë fitimet e paligjshme? Sa keq veprojnë ata!”** (Maide, 63)

Si përfundim, pasioni për pasurinë e kësaj bote i çoi ata në një degjenerim të plotë moral. Dituria që zotëronin nuk u bëri asnjë dobi.

Pejgamberi -(a.s.)-, ka thënë:

“Lutja është adhurim.”

Lutja shpreh dobësinë dhe nevojën tonë për ndihmën e Krijuesit të gjithësisë. Lutja shpreh vetëdijen e plotë të besimtarit për mbikëqyrjen dhe kujdesin e Allahut ndaj krijesave të Tij. Besimtari është i vetëdijshëm se të gjitha pritshmëritë mund t'i realizojë vetëm përmes ndihmës së Allahut. Prandaj, lutja është një tregues i rëndësishëm i sinqeritetit, tevekulit dhe ibadetit. Kurani na informon se qëllimi i krijimit të njeriut është ibadeti, nga ky këndvështrim vlera e njeriut tek Allahu është e varur nga ibadeti. **“Thuaj: ‘Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj.’** (Furkan, 77)

Lutja është vetë adhurimi dhe jo më kot, surja e parë e Kuranit është lutje. **“Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzona në rrugën e drejtë!”** (el-Fatiha) Kjo sure u mëson besimtarëve mënyrën se si duhet të luten. Kurse nëpërmjet ajetit: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thujtu se) Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”** (Bekare,186) Allahu na informon se midis Allahut dhe njeriut nuk ekziston asnjë ndërmjetës.

Lutja ka qenë traditë e të gjithë pejgamberëve. Të kujtojmë këtu lutjen e Ademit për falje, lutjen e Ibrahimit për pasardhës të

devotshëm, lutjen e Nuhut për prapësitë e popullit, lutjen e Ejubit për të shpëtuar prej sëmundjes, lutjen e Junusit për të shpëtuar prej Peshkut, lutjen e Zekerijas për fëmijë, lutjen e Sulejmanit për pozitë dhe pushtet etj. Të gjithë këta janë shembuj të gjallë të lutjes dhe pranimit të lutjes nga ana e Allahut. Allahu kërkon prej nesh të trokasim vazhdimisht në derën e lutjes, në mënyrë që të ruajmë të gjallë komunikimin me Të. Kurani nuk mjaftohet vetëm me urdhëresat dhe inkurajimin për lutje, por njëkohësisht na mëson mënyrën si duhet të lutemi.

Lutja është një derë që Allahu e ka lënë të hapur për robërit e Tij. Praktimi i lutjes i shton vlerë njeriut, kurse braktisja e saj e çon deri në meritimin e dënimit hyjnor. Prandaj, vazhdimisht duhet të jemi në gjendje lutjeje. Lutja duhet të jetë pjesë e sjelljeve tona, jo vetëm në situata të vështira, por edhe në gjendje mirëqenieje. Lutja duhet të shndërrohet në stil jetese për besimtarin, ajo duhet të rrethojë çdo cep të jetës sonë. Lutja ka qenë pjesë e qenësishme e Pejgamberit (a.s.). Ai e praktikonte atë në çdo moment. Besimtari duhet të lutet për vete, për të tjerët dhe njëkohësisht të fitojë lutjet e të tjerëve. Lutja duhet të jetë e sinqertë, të dalë nga thellësitë e zemrës, sepse mundësia e plotësisht të një lutjeje, që nuk rrjedh nga zemra është pothuajse e pamundur. Ti lutemi Allahut ta bëjë lutjen pjesë të përditshme të jetës sonë.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Lutja është formë ibadeti.
2. Lutja është një mjet shumë i rëndësishëm për t’u afruar me Allahun.
3. Lutja është një armë shumë e rëndësishme për përballjen dhe zgjidhjen e problemeve dhe vështirësive.

Mjë Hadith



LUMTURIA FAMILJARE NË JETËN E DY BOTËVE

Babai im i shtrenjtë, Musa Efendiu në vitin 1987 shkroi një artikull. Shkrimi sillte në vëmendje disa skena nga jeta familjare dhe shoqërore të vendësve të Stambollit të kohës së fëmijërisë së tij dhe mbante titullin:

DALLIMI 60 VJEÇAR I EDUKATËS NË JETËN TONË SHOQËRORE

Mbase në aspektin kohor ky dallim është zgjeruar thuhet në një shekull por në aspektin praktik kemi krijuar një hendek shumë më të madh nga ajo shoqëri elitare.

Le të lexojmë disa rreshta plot mesazhe të vyera nga ky artikull dhe më pas të përpiqemi të hedhim dritë për një shoqëri të pastër, të thjeshtë plot dashuri dhe paqe. Musa Efendiu tregon:

“Isha afërsisht shtatë apo tetë vjeç. Mërzitem dhe pikëllohem shumë kur kujtoj sinqeritetin, dashurinë dhe mirësjelljen ndaj njëri-tjetrit të njerëzve të Erenkojit, aty ku kalova fëmijërinë time dhe vërej që nuk ka të krahasuar me ditët e sotme.

Të gjithë e donin njëri-tjetrin sinqerisht dhe ndanin çdo gëzim dhe çdo pikëllim sikur të ishin anëtarë të një familjeje të përbashkët. Të gjithë bëheshin bashkë në dasma dhe kalonin ditë të bukura dhe të këndshme.

Të sëmuret vizitoheshin, u thuheshin fjalë të ëmbla dhe më fytyra të qeshura thuhet iu lehtësoheshin sado pak dhimbjet.

Të varfërit, nevojtarët, të brengosurit ndihmoheshin për hir të Allahut nga çdo kush me aq sa kishte mundësi.

Të pasurit ishin përherë pranë të varfërve.

Doktorët u qaseshin të sëmurve me mëshirën e një prindi dhe shumë herë u blenin ilaçet të varfërve nga xhepi i tyre.



Kur kishte një rast vdekjeje të gjithë banorët e lagjes merrnin pjesë në xhenaze dhe ndjenin keqardhje sikur të ishin dashamirët më të afërt, ngushëllonin familjen dhe u bartnin atyre ushqim për ditë të tëra.

Të gjithë kishin respekt të plotë për njëri-tjetrin.

Në vend të të ashtuquajturve të ditur të kohëve tona, kishte shumë “të paditur” që dinin ç’është respekti dhe nderi.

Mbizotëronte vëllazëria midis njerëzve pa dallim moshe apo pasurie. Askush nuk mburrej me atë që hante e pinte, apo me çka vishej. Ata e dinin se gjithçka është mirësi nga Krijuesi Fuqiptotë prandaj e falënderonin Atë së tepërmi. Ata nuk shpërdoronin, ndërsa me pasurinë e



mbledhur mbronin të varfërit, vejushat, jetimët dhe lumturoheshin nga ndihma materiale dhe shpirtërore që u jepnin të rinjve në pamundësi për të krijuar familje.

Askush nuk sillej me dashakeqësi, smirë e përgojim. Edhe sikur të ndodhte e kundërta të gjithë e dinin se do haste në reagime qortuese nga të tjerët dhe do humbiste respektin në shoqëri.

Pas adhurimeve farz (të detyrueshme) “gëzimi i zemrës së besimtarit” vlerësohej si adhurimi më i rëndësishëm. Përherë thuheshin fjalë të ëmbla e që qetësonin shpirtin.

Njerëzit nuk trazonin njëri-tjetrin me poshtërimi e përbuzje. Të rinjtë sillleshin me respekt ndaj të moshuarve, ndërsa të moshuarit sillleshin me mëshirë ndaj të rinjve. Fjala e prindërve nuk bëhej dysh por respektohej pa kushte, plotësisht.

Të rriturit tregoheshin të kujdesshëm të sillleshin me pjekuri ndaj të vegjëlve në mënyrë që ata të mos llastoheshin, por të bëheshin individë të pjekur, seriozë e dinjitozë të së ardhmes.

KARAKTERI

Gjatë bajrameve dhe netëve të mëdha, veçanërisht gjatë 30 ditëve të muajit të Ramazanit, të pasurit shtronin sofrë gostie për të varfërit. Të gjithë gëzonin në ato sofrë, pa dallim pozite e pasurie. Bamirësit ndihmonin shumë të varfërit e jetimët.

RESPEKTI PRINDËROR

Më herët nuk ka patur ditë të veçanta feste për nënën apo babain siç shohim rëndom në ditët e sotme.

Fëmijët e edukuar me frymën islame tregojnë përherë respekt ndaj prindërve, u shërbejnë dhe plotësojnë çdo nevojë të tyre. Nuk ua diskutonin fjalën.

Një pasardhës i tillë i ushqen prindërit e tij gjatë gjithë jetës dhe i bën dhurata sipas mundësisë materiale. Nga kjo ndjen kënaqësi. Po aq fiton edhe kënaqësinë e Allahut Fuqiptotë.

EDUKIMI I FËMIJËS

Edukimit të fëmijës i kushtoj shumë rëndësi, doza e të ushqyerit nuk përcaktohej sipas tekave të fëmijës dhe nuk plotësohej detyrimisht çdo dëshirë e paarsyeshme. Në këtë mënyrë fëmija shtyhej të edukohej drejt një lloj bindjeje se jo çdo dëshirë e tij mund të realizohej. Po aq i kushtoj rëndësi edhe brumosjes së fëmijës me vlera fetare, kombëtare dhe shoqërore; edukimit të tij me moral të bukur, ndjesinë e turpfit dhe drejtësisë.

Anëtarët e familjes mbledheshin në sofrën e tyre të përbashkët për të konsumuar ushqimin në një klimë dashurie. Nuk kishte orare të ndara, të ndryshme për nënën, babain apo fëmijët. Mbas mbrëmjes zakonisht qëndrohej në shtëpi, nganjëherë vizitoheshin të afërmit ose u shërbehej mysafirëve me mikpritje, fytyrë të qeshur dhe gjuhë të ëmbël. Bisedat me fëmijët zhvilloheshin në atë nivel që ata të kuptonin.

*Edukimit të fëmijës
i kushtoj shumë rëndësi,
doza e të ushqyerit nuk
përcaktohej sipas tekave të
fëmijës dhe nuk plotësohej
detyrimisht çdo dëshirë e
paarsyeshme.
Në këtë mënyrë fëmija
shtyhej të edukohej drejt një
lloj bindjeje se jo çdo
dëshirë e tij mund
të realizohej.*

Fëmijët nuk shkonin askund pa marrë pëlqimin e prindërve dhe respektonin orarin e kthimit në shtëpi kur merrnin leje.

EDUKATA E TË FOLURIT

Nuk flitej në mënyrë të zbrazët dhe të pakuptimtë.

E folura me zë të lartë në prani të të mëdhenjve dhe njerëzve të ngritur, konsiderohej diçka e turpshme dhe sjellje e pahijshme. Fëmijët nuk uleshin asnjëherë në krye si rrjedhojë e edukatës më të cilën ishin brumosur në familjet e tyre.

QETËSIA SHPIRTËRORE DHE PAQJA QË BURONTE NGA NDJENJA E MJAFTUESHMËRISË

Atdheu i sapoçliruar nga forcat pushtuese të armikut (pas Luftës së Parë Botërore) dukej shumë i varfëruar. Për shkak të mungesës së ushqimit ishin shfaqur një sërë sëmundjesh. Xhepat ishin boshatisur. Varfëria mbizotëronte çdokund.

Sidoqoftë kjo skamje nuk shtyu askënd në pesimizëm e pikëllim. Sepse e rëndësishme ishte fitorja e arritur ndaj armikut. Të gjithë falënderonin Krijuesin Fuqplotë dhe zemrat ishin plot paqe dhe lumturi.

Sot bashkë me mirëqenien ka shumë probleme, shqetësime shpirtërore e pikëllime, ndërsa atëherë kishte skamje, por kishte më shumë qetësi shpirtërore.

Në vend të grumbullimit të pasurisë pa pyetur nëse është hallall (e lejuar) apo haram (e ndaluar), atëherë njerëzit mjaftoheshin me atë që kishin. Çdokush para se të mendonte rehatinë dhe përfitimin vetjak, shqetësohej për komshiun dhe të afërmit. I pari i familjes sillej me shumë butësi dhe mëshirë ndaj pjesëtarëve të tjerë. Të gjithë së bashku mundoheshin të praktikonin urdhrat e Krijuesit të Gjithësisë në mënyrë sa më të plotë.

Nuk kishte shpërdorim e harxhime pa kriter. Secili i llogariste shpenzimet sipas të ardhurave që kishte.

PËRGOJIMI

Një grua që nuk sorollatet përjashta është e mbrojtur nga sëmundja e përgojimit. Ajo jeton e lumtur në shtëpinë e saj, e lidh zemrën së pari me Allahun e më pas me bashkëshortin dhe fëmijët e saj, e ruan mendjen nga gjëra të zbrazëta dhe për këtë është e qetë, e lumtur, e paqtë. Prandaj është në një shkallë të lartë morali e si rrjedhojë është një element i respektuar dhe i nderuar i familjes së saj.

Ata që bien pre e sëmundjes së përgojimit nuk mund të jenë kurrë të lumtur. Si mund të jetë falënderues një person që është i zënë me të ardhurat dhe të metat e të tjerëve?!

EKUILIBRI NË TË USHQYER

Çështja e ushqimit nuk ishte diçka parësore siç është bërë sot. Atëherë njerëzit ushqeheshin me çfarë kishin dhe ishin falënderues ndaj Allahut. Edhe sikur të hanin bukë të thatë ishin të lumtur dhe nuk linin pas dore asnjëherë duanë e falënderimit. Edhe pse babai ynë ishte shumë i pasur, kalonin shumë ditë dhe nuk hanin mish, por asnjëherë nuk mërzhiteshim për këtë.

Askush nuk hante duke e tejmbushur stomakun. Njerëzit nuk ishin aq të dhënë pas konsumimit të mishit. Sëmundjet e stomakut, të zemrës apo sëmundjet shpirtërore ishin tepër të rralla. Çdo lagje kishte vetëm një doktor i cili ishte i mjaftueshëm për të gjithë. Po ashtu edhe sëmundjet reumatizmale ishin tepër të rralla për shkak se të gjithë praktikonin namazin, hanin pak, bënë ecje duke vënë në lëvizje muskujt e trupit.

VEESHJA

I kushtohej rëndësi veshjes së pastër, të rregullt dhe të bukur përkundër prirjeve të sotme për të pasur veshje të çuditshme, të çrregullta deri në kapërdisje.

Robat ishin të pastra, pa njolla e të hekurosura. Zakonisht visheshin derisa të vjetëroheshin. Këpucët ishin të lyera dhe të rregullta. Edhe ato përdorreshin derisa të vjetëroheshin.

Çdokush vishej sipas shijes së vet, por askush nuk mburrej me çfarë vishej e çfarë ushqehesh.

Njerëzit krenoheshin kur përdornin prodhime vendase. Rrallë ishin ata që përdornin mallra të huaja. Njerëz të tillë nuk shiheshin me sy të mirë, madje qortoheshin.

Allahu i Lartësuar i krijoi njerëzit në forma të ndryshme, disa të shkurtër, disa të gjatë, disa të shëndoshë, disa të dobët, disa brunë, disa ngjyrëgështenjë e disa bjondë. Diçka që i shkon njerit mund mos t'i shkojë tjetrit, shijet janë pafund. Sa qesharake, padituri dhe kufizim është të braktisësh një det të tërë shijesh në emër të ndjekjes së diçkaje të çuditshme të quajtur “modë”.

LËNGU I TRËNDAFILIT

Zonjat fisnike të asaj kohe përdornin lëngun e trëndafilin në vend të esencave, kremrave dhe pomadave të llojllojshme që dëmtojnë dhe irritojnë ndjeshëm lëkurën, ndonëse janë të paketuara me një ambalazh luksoz dhe mashtrues. Edhe gratë e moshuara shtatëdhjetë apo tetëdhjetë vjeçare kishin një fytyrë dhe lëkurë tejet të freskët. Lëngu i trëndafilin ushqen fytyrën, e mban atë të butë, nuk e irriton dhe parandalon gjithashtu edhe rrudhat.

TË ARDHURAT FAMILJARE

Zonja e shtëpisë ishte shumë e bindur ndaj bashkëshortit të saj. Ajo nuk kundërshtonte, përkundrazi mundohej ta ndihmonte bashkëshortin në çdo çështje. Nuk këmbëngulte për gjëra që ai nuk mund t'i merrte dot. Për këtë arsye në familje mbizotëronte lumturia dhe qetësia duke iu shmangur edhe problemeve financiare në të ardhura. Veshjet dhe orënditë shtëpiake përdorreshin me shumë kujdes, edhe pse të vjetëruara askush nuk kishte prirje t'i rinovonte pa arsye.

Përdorej përherë parimi: “Femra është ajo që e kthen shtëpinë e saj në xhenet.” Nën

i edukonin fëmijët e tyre me parimin e mos shpërdorimit dhe kursimit. Kështu fëmijët mbanin gjithnjë diçka të kursyer në xhepat e tyre, kësaj jo vetëm që nuk kishin nevojë të merrnin hua, por me paratë e tyre ndihmonin të varfërit dhe i mëshironin ata.

Njerëzit kishin frikë nga haku i robit dhe nga borxhi. Borxhliu pranonte të mbeste i uritur vetëm për ta paguar borxhin në kohë. Kësaj çdokush mund të merrte hua sepse njerëzit ishin brumosur me një moral të tillë, njerëzit ishin të drejtë, të palëkundur.

Gruaja, si zonjë shtëpie ishte përgjegjëse për edukimin e fëmijëve dhe menazhimin e shtëpisë, ndërsa burri ishte i zënë me punët e jashtme dhe siguronte çdo nevojë të familjes.

EDUKIMI SHPIRTËROR

Një fëmijë i brumosur me edukimin shpirtëror, larg çdo sjellje të pahijshme, kthehej në një shtyllë të rëndësishme të shoqërisë duke u bërë i dashur për të gjithë.

Prijësit fetarë dhe mësuesit e Kuranit gëzonin një respekt të thellë. Nderimi që i bëhej atyre ishte shumë më i madh në raport me njerëzit e tjerë.

DITËT SHPIRTËRORE

Nuk kishte sjellje të pamatura. Të gjithë ishin të lumtur, të gëzuar.

Në ditët e bajrameve dhe netëve të mëdha tregohej respekt dhe të gjithë vizitonin njëri-tjetrin; lexohej Kuran dhe këndohej Mevlud duke përhapur kështu në çdo shtëpi filladin e miskut hyjnor.

Është e vështirë t'i përshkruajmë ato ditë siç është e vështirë të përshkruajmë shijen e mjaltit. Me pak fjalë, ato ditë ishin përjetime që as nuk mund t'i imagjinojmë dot, ishin dimensione të tjera...

*Ata që bien
pre e sëmundjes
së përgojimit nuk mund
të jenë kurrë
të lumtur. Si mund
të jetë falënderues
një person që është
i zënë me të ardhurat
dhe të metat
e të tjerëve?!*



NDIHMJA E ALLAHUT DHE E ENGJËJVE TË TIJ PËR BESIMTARËT SIPAS KURANIT

Doç. dr. Kerim Bulladë

Në Kuran flitet për ndihmën që Allahu i Madhëruar u jep besimtarëve dhe për mbështetjen që engjëjt e Tij – me lejen e Allahut – u bëjnë besimtarëve. Po ashtu, flitet edhe për ndihmën që njerëzit i bëjnë Allahut (për fenë e Tij) dhe për njëri – tjetrin. Veçanërisht tërhiqet vëmendja e lexuesve të Kuranit, me panorama të atilla, si për shembull: pejgamberët dhe besimtarët kërkuan nga Allahu që t'i ndihmonte kundrejt femohuesve, shkatërruesve dhe mashtruesve. Në përgjithësi shihet se në Kuran kalon 143 herë folja “*nasara*” dhe derivatet e saj.¹

Ndihma që jep Allahu i Madhëruar për besimtarët përmendet përmes foljes “*emedde*”, e cila është në kuptimin e mbështetjes.² Kurse, përmes foljes “*istegase*”, e cila vjen në kuptimin e kërkesës për ndihmë, bëhet e ditur se është kërkuar ndihmë nga Allahu.³ Fjala “*istean*”, është përdorur në kuptimin e atij prej të cilit kërkohet ndihmë, kurse fjala “*mustean*”, si cilësi e Allahut. Përmes këtyre fjalëve, po ashtu është nënkuptuar kërkimi ndihmë nga Allahu me durim dhe namaz.⁴

Në secilin rekat që falin, besimtarët kërkojnë ndihmë nga Allahu duke thënë: “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.*” I besojnë vetëm Atij dhe pa ndihmën e Tij nuk mund të ketë lumturi as në këtë botë e as në tjetrën.

Ata kërkojnë ndihmë nga Allahu atëherë kur përballen me shqetësime të ndryshme, me fatkeqësi, atëherë kur përballen me dhunën e armiqve. Do të kërkojnë ndihmë nga Allahu duke besuar se mund të kalojnë të njëjtën sprovë, sikurse ata besimtarë që janë dhunuar, janë sprovuar me varfëri, skamje e pamundësi. Lidhur me temën në fjalë, Allahu thotë:

*“Vërtet mendoni të hyni në Xhenet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: ‘Kur do të arrijë ndihma e Allahut?!’ Ja, ndihma e Allahut është afër!”*⁵ Ky ajet, që mendohet të jetë shpallur ndër kohë që po zhvillohej Beteja e Hendekut, bën të ditur vështirësitë me të cilat janë përballur myslimanët. Ka transmetime se mund të jetë shpallur edhe gjatë Betejës së Uhudit. Kurse sipas një tjetër rrëfimi, ajeti në fjalë është shpallur për të ngushëlluar myslimanët që bënë hixhret, duke braktisur të gjithë përfitimet që kishin dhe shtëpitë e tyre në Mekë, duke u nisur për në Medinë, për të zgjedhur vetëm pëlqimin e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij.⁶

Më shumë sesa të dimë se cila ka qenë arsyeja e shpalljes së këtij ajeti, kur analizohet e vërteta vërehet se ata që bëjnë xhihad në rrugën e Allahut të Madhëruar, që do të kenë sprovë të forta në jetë, do t'i kalojnë me durim dhe maturi dhe do të shpërblehen me ndihmën e Allahut dhe me xhenet.

Në tesktin autentik të ajetit, fjala “*nasrullah*” që kalon, është në kuptimin e ndihmës së Allahut. Ky koncept përmendet në ajete të ndryshme, si “*en-nasru, nasrullah*” (ndihmë, mbështetje, ndihma e Allahut) dhe këto folje i atribuohen Allahut.⁷ Kjo gjë tregon se Allahu do t'i ndihmojë besimtarët e Tij, që gjenden në situata të ndryshme, si dhe do t'i forcojë dhe mbështesë ata. Allahu e shpjegon kështu të vërtetën e ndihmës që Ai bën për ta:

“Pa dyshim, Ne kemi nisur të dërguar para teje të popujt e tyre. Ata u paraqitën me prova të

qarta, por popuj i mohuan, prandaj Ne i ndëshkuam keqbërësit. Është detyra Jonë t'i ndihmojmë besimtarët."⁸

Allahu i Madhëruar e sheh ndihmën për besimtarët si një prej detyrave të Tij. Kundrejt kësaj Ai kërkon që besimtarët ta ndihmojnë Atë dhe të Dërguarin e Tij. Lidhur me këtë temë, në Kuran thuhet:

*"Vërtet, Allahu ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm."*⁹

*"Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit, me qëllim që Allahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm."*¹⁰

Allahu gjithashtu u është drejtuar besimtarëve në këtë mënyrë:

*"O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja."*¹¹

Dijetarët e komentimit të Kuranit e kanë analizuar këtë ajet në këtë mënyrë: *"Nëse ndihmoni fenë e Tij, të Dërguarin e Tij dhe ata që janë në rrugën e Tij, atëherë Allahu ju ndihmon ju kundrejt armiqve tuaj dhe ju jep mundësinë e triumfit. Në luftë nuk bën të mundur që t'ju rëshqasë këmba juaj. Ju dhuron durim dhe maturi."*¹² Shprehja *"Amenu"* (ata që besojnë), është komentuar si *"ata që i besojnë Muhamedit (a.s.) dhe Kuranit"*¹³ Siç duket, ata që i besojnë Allahut, ata që besojnë tek i Dërguari i Tij, si hallka e fundit e shpalljes hyjnore dhe që pohojnë Kuranin, që pranojnë Islamit si feja e vërtetë dhe akordojnë jetën sipas kësaj, të gjithë ata që bëjnë përpjekje në këtë prizëm, një ditë do të përballen me premtimin e ndihmës së Allahut.

Në ajetet poshtë shprehet qartë se Allahu i Madhëruar ka ndihmuar njerëz në kohë, hapësirë dhe ngjarje të ndryshme:

"Në të vërtetë, Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe në ditën e (luftës së) Huneinit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh. Por ai numër nuk ju solli dobi aspak, sepse toka ju duk juve e ngushtë, edhe pse është e gjerë dhe kthyer shpinën duke ia mbathur. Pastaj, Allahu zbriti qetësinë

*e Tij mbi të Dërguarin e Vet dhe mbi besimtarët, si dhe luftëtarë (engjëj), të cilët ju nuk i patë dot e i dënoi jobesimtarët. Kështu u 'shpërblyen' mohuesit."*¹⁴ *"Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur qetë të pafuqishëm, andaj frikësojuni Allahut, për të qenë falënderues. Atëherë ti (Muhamed) u thoshe besimtarëve: 'A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tri mijë engjëj të dërguar?'"*¹⁵

Ashtu sikurse ndodhi edhe në ditën e Huneinit, po ashtu edhe në Uhud, Bedër dhe Hendek, Allahu i Madhëruar nuk e ka lënë vetëm Hz. Pejgamberin e as sahabët e tij besnikë; u ka dërguar engjëjt si ndihmë, i ka ruajtur duke u dhënë një gjumë të ëmbël dhe duke hedhur shi mbi ta. Kurse femohuesve, krahas engjëjve u ka dërguar edhe stuhi të forta dhe ka bërë që të munden.¹⁶

Ndihmat që përmenden në ajete u premtohen të gjithë besimtarëve, që i shërbejnë fesë së Allahut dhe japin kontributin e tyre për përhapjen e saj. Brenda rrjedhës së historisë ka pasur plot shembuj të tillë. Kjo duhet të jetë edhe arsyeja se përse përmendet në Kuran ndihma që Allahu u bëri Pejgamberit (a.s.) dhe sahabëve besnikë të tij të së njëjtës kauzë. Mirëpo, për të ardhur ndihma e Allahut tek besimtarët, të gjithë faktorët si, renditja e engjëjve në rreshtat e besimtarëve -me lejen e Allahut, dërgimi i shiut e erës, dhurimi i sigurisë dhe garancisë psikologjike janë të lidhura me durimin, maturinë dhe devotshmërinë e besimtarëve.¹⁷

Me lejen e Allahut, sa e sa popuj, edhe duke qenë të vegjël në numër, kanë mundur dhe kanë dalë fitimtarë mbi popujt që ishin në shumicë. Ndaj dhe ne duhet të bëjmë gjithnjë këtë dua që bënte Taluti dhe ushtarët e tij dhe duhet të përpiqemi të arrijmë në atë nivel sinqeriteti:¹⁸ *"Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët tona dhe na ndihmo kundër këtij populli jobesimtar!"*¹⁹ Këtë të vërtetë nuk duhet ta heqim kurrë nga mendja: *"Nëse ju ndihmon Allahu, s'ka kush t'ju mposhtë e, nëse ju lë pa ndihmën e Tij, kush është ai që do t'ju ndihmojë, përveç Tij?! Pra, vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët."*²⁰

Shënimet: 1) M. Fuad Abdulbaki, *Mu'xhemu'l-Mufehres li Elfâdhil'El-fâdhil'Kur'âni'l-Kerîm*, Çağrı Yayınları, İstanbul, padatë, f. 702-704. (Për arsye se numrat e ajeteve janë të shumta, nuk janë reflektuar fare në shënim. Mund t'i hidhet një sy referencës në fjalë). 2) Âl-i Imrân, 3/123-124; Enfâl, 8/9. 3) Enfâl, 8/9; Ahkâf, 46/17. 4) Fatiha, 1/5; Bekare, 3/45, 153; A'raf, 7/128; Jûsuf, 12/18; Enbijâ, 21/112. 5) Bekare, 2/214. 6) Kurtubî, Ebû Abdil-lah Muhammed b. Ahmed, *el-Xhamiu li Ahkâmil'Kur'an*, Bejrut, 1995, v. II, kapitulli. III, 33-34; Shevkânî, Muhammed b. Ali b. Muhammed esh-Shevkanî, *Fethu'l-Kadîr el-Xhamiu bejne Fennejil'Rivâjjeti ve'd-Dirâjjeti min Ilmi't-Tefsîr*, Tas'hîh, Ahmed Abdusselâm, Bejrut, 1994. I, 270. 7) Âl-i Imrân, 3/166; Enfâl, /10; , 72; Ankebût, 29/10; Rûm, 30/5; , 47; Saff, 61/13; Nasr, 110/1. 8) Rûm, 30/47. 9) Haxhixh, 22/40. 10) Hadîd, 57/25. 11) Muhammed, 47/7. 12) Zemahsherî, Zemahsherî, Ebu'l-Kâsim Xhârullah Muhammed b. Omer, *el-Keshshâfu an Hakâiki Gavâmid'it-Tenzîl ve Ujûni'l-Ekâvîl fi Vuxhûhi't-Te'vîl*, Tas'hîh, Mustafa Husejin Ahmed, Bejrut, padatë. IV, 318; Bejdâvî, Nâsiruddin Ebû Said Abdullah b. Omer el-Bejdâvî, *Envârû't-Tenzîl ve Esrârû't-Te'vîl*, (Brenda: Kitabun Mecmuatûn mine't-Tefâsîr), Bejrut, padatë. V, 500; Hazin, Alâuddin Ali b. Muhammed b. Ibrahim *Lubâbu't-Te'vîl fi Meâni't-Tenzîl*, (Brenda: Kitabun Mecmuatun mine't-Tefâsîr), Bejrut, padatë. V, 500; Nese'fî, Ebul-Berakât Abdullah b. Ahmed, *Medâriku't-Tenzîl ve Hakâiku't-Te'vîl*, (Brenda: Kitabun Mecmuatun mine't-Tefâsîr), Bejrut, padatë. V, 500. Shevkânî, *e njëjta vepër.*, V, 39. 13) Fîrûz Âbâdî, Ebû Tâhir Muhammed b. Jakub, *Tenvîru'l-Mikbâs min Tefsîr-i Ibn Abbâs*, (Brenda: Kitabun Mecmuatun mine't-Tefâsîr), Bejrut, padatë V, 500. 14) Teube, 9/25, 26. 15) Âl-i Imrân, 3/123, 124. 16) 125; Enfâl, 8/9; Teube, 9/26; Ahzâb, 33/9. 17) Âl-i Imrân, 3/125. 18) Bekare, 249. 19) Bekare, 2/250. 20) Âl-i Imrân, 2/160.



SFIDA E MYSLIMANIT ME MODERNITETIN NË PROCESIN E GLOBALIZIMIT

— Emre Topollu —

Padyshim që globalizmi është një nga konceptet më në modë të kohëve të sotme. Qoftë në sferën akademiko-shkencore, qoftë dhe në atë politiko-burokratike, në krye të të gjithë termave që përmenden më së shumti bën pjesë globalizmi. Ai që e do apo që e mbështet, sikurse edhe ai që e kritikon apo e kundërshton, sado pak qoftë, ndihet i varur nga ky koncept. Për disa, globalizmi është një proces kyç për të ndërtuar një botë më të re dhe më të mirë, si bazë e lirisë, transparencës dhe ndikimit të ndërsjelltë; kurse për disa të tjerë është një proces tmerrues, që hap një derë drejt një bote që bën ndarjen me një hendek të tërë mes të varfërve, pak të zhvilluarve, të zhvilluarve dhe kolonive.

Kësisoj, globalizmi mund të portretizohet si specializimi me bazë krahasimet mes përparësive dhe lidhja me botën në aspektin ekonomik; kurse në kuptimin politik të fjalës, përkufizohet si demokraci pluraliste, qeverisje civile, arritje e standarteve ndërkombëtare në çështjet e lirisë dhe të drejtave të individit. Nëse duhet ta shprehim më qartë, globalizmi është procesi i ndikimit gjithnjë në rritje mes individëve, shoqërive, shteteve dhe kombeve, duke nisur që nga politika në ekonomi, nga sporti në art, nga tregtia në kulturë. (Bulbul, 2009)

Globalizmi ka tre dimensione të përgjithshme: I pari është dimensionin ekonomik. Është më se e

qartë se shtetet nuk janë të mjaftueshme për veten e tyre nga aspekti ekonomik. Asnjë nga shtetet nuk mund të veprojnë në mënyrë të pavarur lidhur me lëndën e parë, fuqinë punëtore dhe tregun; pra është vërejtur se shtetet kanë nevojë për njëri-tjetrin. Mendimi më i drejtë u pa se është ndarja së bashku e burimeve që zotëronin, me qëllim që gjithnjë të kishin përfitime dhe një zhvillim të caktuar.

Një tjetër dimension i globalizimit është edhe ai politik. Bashkimet që përmendëm në dimensionin ekonomik, ndikojnë në strukturën politike në botë, pasi në shumë nga problemet politike qëndrojnë konfliktet, interesat dhe problemet ekonomike. Kësisoj, me globalizimin, koncepti “komb” humbet rëndësinë që bart në vetvete.

Si përfundim, është e nevojshme të flitet për dimensionin kulturor të globalizimit. Bashkimet mes kulturave kanë bërë që qytetërimet të përparojnë. Bashkë me globalizimin, kanë qarkulluar nëpër botë edhe idetë, mendimet dhe përshtypejt, e si pasojë është krijuar një treg global kulturor. (Topogllu, 2012)

Pikërisht mbi pikën e ndikimit ndërkulturor do të përqendrohet edhe punimi ynë.

Kur i hedhim një sy së shkuarës, vërejmë se kemi kaluar vite kur feja u ndalua në mënyrë kategorike; u dënuan besimtarët që ushtronin fenë, klerikët që mbanin gjallë praktikat fetare dhe u shkatërruan shumë tempuj ku adhurohej Zoti. Kurse, ndonëse në një shoqëri pluraliste, ne dita-ditës përballemi me pengesa diskriminuese ndaj myslimanëve, siç është rasti i diskriminimit ndaj femrave myslimane që mbajnë shami.

Ndërsa sot po përballemi me rrezikun e ri me emrat “Islami i moderuar”, “Islami tradicional”.

Në fillim mund të na shkojë mendja sikur ka mbaruar koha e politikave tëhuajëzuese dhe që ka nisur të lindë një sistem i ri. Patjetër që hidhen edhe hapa të rëndësishëm, në kuptimin pozitiv të fjalës, ose të paktën po bëhet përpjekje të hidhen hapa të tillë. Brenda këtij precesi, “identiteti mysliman” është koncepti që kohëve të fundit po diskutohet më së shumti dhe që nga myslimanë të ndryshëm mbështillet me kuptime të ndryshme dhe, si pasojë, ka marrë shumë plagë. Thënë ndryshe, burimi i problemit tonë është përgjigja e gabuar nga individë a grupe të ndryshme që i kanë kthyer përgjigje si kanë dashur pyetjes së mësipërme.

Mbase mund të duket si një qasje radikale. Por është mjaft e habitshme se si mund të ndodhë që pjesëtarët e një feje, kufijtë e së cilës janë vendosur përmes një Libri të Shenjtë; që mund të kenë përgjigje për pyetjet lidhur me çdo fushë të jetës sociale; që përmes Pejgamberit të dërguar për mbarrë njerëzimin janë hequr të gjitha pikëpyetjet; që përmes miqve të Allahut dhe Murshidëve u tregohet rruga e drejtë të gjithëve; pra që shkurtimisht bëjnë pjesë në një fe, gjykimet dhe koriniza e së cilës është mjaft e qartë dhe përsëri ata të kenë nevojë të marrin shembuj të tjerë?! Ose, thënë më qartë, jemi përballë një pyetjeje: “A mund të ketë Islam të moderuar?” apo “Si mund të jetë ky Islami i moderuar?”

Krahas gjithë këtyre problemeve, tema mund të koklavitet edhe më tej. Paralel me botëkuptimin “Islami i moderuar”, po përballemi me modelin “myslimanë të moderuar”. Duke penguar shaminë, duke u dhënë grave rol në jetën sociale më shumë sesa burrave, i jepet plagë serioze jetës familjare dhe përballemi me një moderim të qasjes fetare. Ata që janë bërë pre e këtij ndryshimi, bien në konflikt të hapur me ata që e jetojnë besimin ashtu sikurse duhet, si rrjedhojë kjo gjë sjell me vete probleme të ndryshme. Si përfundim, është më se e qartë se problemet e sotme për të cilët nuk marrim masa, nesër do të shndërrohen në shqetësime serioze. Veçanërisht bijave tona të reja, të cilat rropaten, ngaqë nuk arrijnë ta kuptojnë si duhet, duhet t’u qartësohet koncepti liri. **U duhet mësuar mirë atyre se liria fitohet përmes kujdesit ndaj fesë dhe devotshmërisë dhe vetëm atëherë kur shpirti të shpëtojë nga robëria e trupit, mund të arrihet liria e vërtetë.**

Pika më delikate e shqetësimeve në fjalë është kur bëhet fjalë për një përpjekje zbutëse të rregullave gjatë procesit ‘të zbutësimit’ të Islamit. Shumë nga njerëzit që e konsiderojnë veten sot radikalë, po bëjnë një jetë në harmoni të plotë me Islamin ‘e moderuar’. Pra, është edhe mysliman radikal, por njëkohësisht edhe nuk lë asgjë pa plotësuar nga aspekti i epshit dhe kënaqësive të nefsit. Ose, thënë ndryshe, ato ngjarje dhe fenomene që pranoheshin si të gabuara më parë, tashmë përmes modernizimit konsiderohen si sjellje normale. Në një farë mënyrë kjo gjë do të thotë që të pranosh gabimin si të drejtë. **Në fakt, gabimi duhet të konsiderohet gabim në çdo situatë.**



Morali i bukur dhe Modeli

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Karakteristikë kryesore e të gjithë pejgamberëve, por në veçanti e Pejgamberit të fundit (a.s.), ka qenë shembulli dhe modeli i përsosur. Pejgamberët janë heronjtë e moralit dhe modelet shembullorë të njerëzve, sepse njerëzit ndikohen dhe zbatojnë më lehtë dhe shpejt shembullin praktik sesa teoritë e moralit të shkruara nëpër libra.

Nëse do të ishte e mjaftueshme teoria, nuk do të kishte nevojë për dërgimin e pejgamberëve. Allahu mund t'u dërgonte njerëzve një libër që

përfshin të gjitha ligjet, rregullat, parimet morale dhe virtytet e shoqërisë dhe njerëzit do t'i mësonin dhe zbatonin këto mësimet. Por Allahu nuk veproi kështu, Ai dërgoi profet nga mesi i njerëzve, në mënyrë që të shërbente si shembull për ta.

Ajeti kuranor: **“Ti je me virtyte madhore.”** (Kalem, 4) dhe hadithi profetik: **“Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e bukur”** (Muvatta, Husnul Huluk, 8.) vënë në dukje qëllimin kryesor të

dërgimit të profetëve.

Sipas këndvështrimit kuranor dhe profetik, morali i bukur konsiston në sundimin e Allahut mbi zemrën e njeriut, në druajtjen dhe frikën nga Allahu në çdo vend dhe në çdo kohë, në kryerjen e veprave të mira pas një veprë të keqe dhe në mirësjelljen përballë krijesave. Pra, sipas Islamit, morali zhvillohet rreth boshtit të imanit dhe frikës ndaj Allahut. Siç thotë edhe poeti Mehmet Akif:

“Vlerën moralit nuk ia jep as urtësia as ndër-gjegjja, virtyti i njeriut buron nga frika ndaj Allahut. Nëse në zemër nuk ekziston frika ndaj Allahut, nuk mbetet as ndikimi i urtësisë dhe as i ndërgjegjes.”

Në themel të moralit të bukur qëndron frika ndaj Allahut dhe mirësjellja ndaj njerëzve. Pejgamberi (a.s.), na informon se gjëja e parë që do të vendoset në peshore do të jetë morali i bukur dhe bujaria. Fenë e zbukurojnë dy virtyte: morali i bukur dhe bujaria. Tregues i bujarisë nuk është vetëm ndihma e treguar ndaj gjithësecilit, por edhe buzëqeshja, mirësjellja, përzemërsia dhe çiltërsia. Besimtarit ia jep nderin feja, fisnikërinë morali i bukur, kurse respektin mendja.

Një një fjalë të Tij Pejgamberi (a.s.), na informon që njeriu mund të arrijë pozita të larta dhe të nderuara në sajë të moralit të bukur, megjithëse adhurimet mund t'i ketë të pakta. Xhunejd Bagdati, duke synuar hapjen e hadithit, thotë: “Janë katër gjëra që e lartësojnë njeriun, edhe nëse veprat i ka të pakta, ato janë: butësia, modestia, bujaria dhe morali i bukur.”

Shumë dijetarë e kanë njësuar fenë me moralin e bukur, kurse moralin e bukur me tasavufin. Sipas Ebu Bekir Ketanit: “Tasavufi nuk është gjë tjetër përveçse moral”. Ai që është i lartësuar në moral, është i lartësuar edhe në tasavuf. Të gjithë të lartësuarit e kanë arritur këtë shkallë për shkak të moralit. Kulmi i përsosmërisë morale është Muhamedi (a.s.) dhe dashuria e Allahut fitohet duke ndjekur gjurmët e Pejgamberit (a.s.). Sipas Kuranit, njeriu më i nderuar tek Allahu është personi më i devotshëm. Parimi themelor i imanit është devotshmëria, kurse parimi themelor i Islamit është morali. Egoja qëndron e qetë ve-

tëm nga pamundësia. Nëse i jepet mundësi, ajo menjëherë hidhet në veprim, siç thotë një fjalë popullore: “Nëse dëshiron të njohësh natyrën e vërtetë të një personi jepi pasuri ose pozitë, pastaj shikoji sjelljet”. Nëse ai me gjithë fuqinë ekonomike, pozitën dhe autoritetin që ka vazhdon të sillet mirë dhe të bëjë bamirësi, sa mirë për të, por nëse sillet ndryshe, atëherë mirësjellja para pasurisë dhe pozitës ka qenë për shkak të pamundësisë.

Mbreti i urtësisë, Hasan Basriu e përkufizon moralin e bukur, si: “Buzëqeshje, fjalëmbëlsi dhe bamirësi ndaj njerëzve.”

Burimi dhe nxitësi i së keqes është egoja e njeriut. Prandaj parimi bazë i moralit është edukimi i egos. Sepse egoja e njeriut është më e rrezikshme se shejtani. Mendjemadhësia, dashuria ndaj kësaj bote dhe rënia pas epsheve vijnë prej egos.

Është shumë e rëndësishme që njeriu të fitojë ndjeshmëri ndaj së mirës dhe së keqes. E mira nuk është gjë tjetër veçse moral i bukur. Mëkati dhe e keqja janë veprimet që shkaktojnë shqetësime në zemër.

Rumi, në Mesnevinë e tij e përngjason personin me moral të bukur me devenë, kurse personin me moral të keq me mushkën: “Një ditë mushka i thotë devesë: ‘Si mund të ecësh me kaq lehtësi pa u rrëzuar nëpër këto rrugë të ngushta dhe të vështira, kur unë në të shumtën e rasteve në rrugë të tilla rrëzohem?’ I përgjigjet deveja: ‘Unë çdo hap e hedh duke shikuar, prandaj nuk rrëzohem, kurse ti nxiton, ti arrin të shikosh grimcat e rërës, por nuk shikon dot grackën që ke përpara. A mundet që një që shikon të jetë i barabartë me një të verbër. Butësia dhe qetësia janë themeli i moralit të bukur.’”

Morali i bukur fshin urrejtjen, mërinë dhe armiqësinë, duke ia lënë vendin butësisë, qetësisë dhe mëshirës. Në fakt, shpata e butësisë dhe mëshirës është më e mprehtë se shpata e armiqësisë dhe urrejtjes. Dhe modeli shembullor është Pejgamberi (a.s.). Në lidhje me këtë, Allahu në Kuran thotë: “*Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta* (o Muhamed). *Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.*” (Ali Imran,159.)



Vraponi pas mëshirës së Allahut

— Idris Arpat —

Në suren Ali Imran, Allahu urdhëron: “Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit. Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre, e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë (Ali Imran, 133-135)

Në këtë ajet Allahu thekson cilësitë e besimtarëve të devotshëm, të cilët në qendër të jetës së tyre kanë vendosur Allahun dhe dashurinë për Të. Këta besimtarë japin lëmoshë për hir të dashurisë ndaj Allahut, si në gjendje të mirë, ashtu edhe në gjendje të keqe. Në një ajet para këtij, Allahu urdhëron mbajtjen e pasurisë larg ndotjes së kamatës, përndryshe i pret një dënim i rëndë dhe i ashpër.

Kurse ajeti në fjalë nxit besimtarët për strehim tek mëshira e Allahut dhe vrapim drejt Xhenetit, gjerësia e të cilit është sa qiejt e toka. Ky nuk është një vrapim me hapa, por një vrapim me vepra dhe punë të mira.

Ajeti thekson faktin e përgatitjes së Xhenetit si vend pritjeje për të devotshmit. Sepse vepra të tilla si dhënia e lëmshës në kamje dhe skamje, mposhtja e zemërimit dhe mërisë dhe falja e padrejtësive që bëjnë njerëzit, janë vepra që mund të realizohen vetëm nga të devotshmit.

Cilësitë kryesore të besimtarëve të devotshëm në ajetin e mësipërm janë: lëmshja në kamje dhe skamje, në gjendje të mirë dhe gjendje të keqe, mosshkëputja për asnjë moment nga dhënia e lëmshës për nevojtarët. Të devotshmit nuk heqin dorë nga përgjegjësia e bamirësisë dhe ndihmës ndaj të varfërve dhe të dobëtve. Ata nuk presin të bëhen të pasur për të dhënë lëmshë dhe ndihmuar të varfrit, sepse dhënia e lëmshës për ta është bërë pjesë e qenësishme e karakterit të tyre.

Një cilësi tjetër karakteristike e tyre është edhe mposhtja e zemërimit dhe urrejtjes. Përmes energjisë dhe forcës shpirtërore që buron prej devotshmërisë arrijnë të mposhtin urrejtjen dhe zemërimin ndaj të tjerëve. Pejgamberi (a.s.), në lidhje me këtë thotë: *“Trim i vërtetë nuk është ai që mund kundërshtarin në dyluftim, por ai që mund zemërimin dhe urrejtjen.”* (Buhari, Edeb, 76.) Kurse në një hadith tjetër thotë: *“Atë që ruan gjakftohtësinë dhe i shmanget hakmarrjes, duke qenë i plotfuqishëm për hakmarrje, në Ditën e Gjykimit Allahu do ta nxjerrë në krye të njerëzve dhe do ta lërë të lirë të zgjedhë nga huritë e Xhenetit.”* (Ebu Davud, Edeb, 3)

Vetëm të devotshmit arrijnë të falin ata që u kanë bërë padrejtësi. Në këtë proces, ata kapen fort mbas durimit. Kur zemërimi merret nën kontroll, njeriu përfshihet nga një zjarr dhe duman i brendshëm dhe vetëm nëse hidhet një hap më para duke e falur armikun, atëherë prehet zemra dhe qetësohet ndërgjegjja. Vetëm në këtë mënyrë hapen para tij horizontet e kthjellëta dhe të gjera. Me këtë veprim ai bëhet shkak që edhe armiku të reflektojë dhe gjejë rrugën e vërtetë.

Të gjitha këto sjellje sublimë burojnë nga dëshira e zjarrtë për të fituar dashurinë e Allahut. Këto sjellje në asnjë mënyrë nuk janë për ndonjë përfitim material të kësaj bote.

Dhënia e lëmshës në çfarëdolloj gjendjeje, mund-

ja e zemërimit, falja e tjetrit dhe moskëmbëngulja në gabim, të gjitha këto janë sjellje që mund t'i realizojnë vetëm njerëzit me shpirt të madh. Këto janë vepra të jashtëzakonshme për të fituar dashurinë dhe mëshirën e Allahut. Në lidhje me shpërblimin e tyre, Allahu në një ajet më poshtë thotë: **“Pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!”** (Ali Imran, 136)

NDJESHMËRIA NDAJ NAMAZIT

Allah në suren Ibrahim, i urdhëron besimtarët të falin namazin **“Thuaju robërve të Mi, të cilët besojnë: ‘Le të falin namazin siç duhet.’** (Ibrahim, 31) Në suren Muminun shpall si shpëtimtarë ata që e falin namazin me kujdes dhe përqendrim **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre.”** (Muminun, 1-2) Kurse në suren Ankebut na informon që namazi e pengon besimtarin nga rënia në vepra të këqia. **“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar”** (Ankebut, 45)

Kur u pyet Pejgamberi (a.s.), për veprën më të pëlqyer tek Allahu, tha: *“Falja e namazit në kohën e vet.”* (Buhari, Mevakit, 5) Sahabiu Xherir ibn Abdullah tregon se i ka dhënë besën Pejgamberit (a.s.), për faljen e namazit, dhënien e zeqatit, mbajtjen e drejtësisë dhe këshillimin me çdo mysliman. (Buhari, Iman, 42)

Nga ajetet dhe hadithet e lartpërmendura theksohet fakti se namazi e lartëson dhe e pengon njeriun nga rënia në veprime të këqija, kurse namazi që nuk e pengon njeriun nga veprat e këqija nuk është gjë tjetër veçse një barrë e rëndë dhe një përgjegjësi e madhe.

Prandaj, pyetjet që duhet të bëjë sot çdo mysliman janë: **“A jemi të vetëdijshëm për namazin që falim? A e ndjejmë sa duhet madhështinë e namazit? Sa të vetëdijshëm jemi për ajetin e sures Fatiha, që e lexojmë në çdo namaz: ‘Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.’”**

Reziku më i madh për namazin është shndërrimi i tij në rutinë të përditshme. Atëherë namazi, nga burim energjie shpirtërore dhe fizike, shndërrohet në barrë e cila rëndon vazhdimisht mbi personin. Prandaj, duhet treguar kujdes që namazi të mos e humbasë gjallërinë dhe dinamizmin që e karakterizon.



TË PËRFITOSH NGA IBADETI

— Rabia Christine Brodbeck —

Me ardhjen në këtë botë të Zotërisë së Gjithësisë, Hz. Muhamedit (a.s.), është manifestuar njëkohësisht përsosmëria e dashurisë, e vërteta e mëshirës hyjnore dhe afiniteti hyjnor. A. Jusuf Aliu, në tefsirin e Kuranit Famëllartë, bën një shpjegim të tillë: “Nuri islam është mundësia më e madhe si begati. Nëse do të arrijmë ta kuptojmë, do të krenohemi me të.” “Nuri që është dërguar me Hz. Muhamed Mustafanë, ndriçon të gjithë ata që kanë merituar të jenë pjesë e shoqërisë së tij universale.” Nëse njeriu nuk do ta ndjekë nurin e Islamit, nuk mund të arrijë të shijojë përsosmërinë e fesë dhe nuk mund të mbërrijë në shkallën e të qenit i mahnitur. Nëse njeriu nuk e jeton traditën profetike, nëse nuk e organizon jetën sipas haditheve, nuk mund t’i jepet siguri lidhur me të qenit pjesë e ymetit.

Tradita profetike përfaqësohet nga tradita etike më sublimë e fesë islame. Sheriati përfaqëson të gjithë themelin e veprimtarisë së të qenit rob i Zotit. Brenda saj gjendet pasuria e brendshme e fesë islame. Sheriati nuk është i ndryshëm nga Pejgamberi (a.s.), i cili e solli atë. Atëherë kur Pejgamberi (a.s.), nderoi

botën me praninë e tij, bota u dritësua dhe Zotëria ynë tha: “Unë u dërgova që të përsos moralin e mirë.” Sheriati që u dërgua bashkë me të është përforcuar me etikën e vullnetit, fjalët dhe të gjithë praktikat. Të gjitha kushtet e fesë, që janë të nevojshme të kryhen, në fakt janë porsì një pasqyrë e drejtuar nga Resulullahu (a.s.). Ato pasqyrojnë nurin e edukatës së tij, si dhe bartin nga mëshira e pafundme e tij dhe nga vetëdija e robërisë së tij. Pejgamberi (a.s.), ka ardhur që të përsosë moralin e bukur dhe është bërë mbreti i Sheriatit. Ai është burimi i vetëm i nurit që ndriçon krijesat e botës. Mrekullia më e madhe e gjallë, që ka pasur e tërë bota është *moralit muhamedan* i Pejgamberit (a.s.). kurse mrekullia më e madhe e Pejgamberit (a.s.), është Kurani Famëllartë. E vërteta e Fjalës Hyjnore kurrë s’mund të jetë e pavarur nga Pejgamberi, të cilit i është shpallur ajo, pasi ai (a.s.), ishte “Kuran i gjallë”. Mrekullia më e madhe që ka krijuar Zoti i Madhëruar nuk është asgjë tjetër veçse *e vërteta muhamedane*, që shfaqet përmes moralit profetik. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: “Unë u dërgova që të përsos moralin

e mirë.” (Muvatta, Husnul-Khuluk, 8; Ahmed b. Hanbel, 2/381.). *Siratul-mustekim* është një rrugë e ndritshme. Ajo është rruga e cilësive dhe emrave të Allahut të Madhëruar. Ajo është “*Rruga muhamedane*” dhe përfaqëson “*moralin muhamedan*” të Pejgamberit tonë të dashur (a.s.). Ajo është rruga që të çon drejt Xhemalit dhe Kemalit të amëshueshëm të Zotit. Ndonëse Pejgamberi (a.s.), kishte statusin më të lartë që ka pasur ndonjë njeri ndonjëherë, i cili qe krenaria e Gjithësisë, ai sidoqoftë ishte njeriu më i thjeshtë nga njerëzit, më modesti.

Allahu i Madhëruar në Fjalën e Njesisë, të Dashurisë dhe të Tij e përmend edhe si rob edhe si resul. “Është robi dhe i dërguari i Tij”. Përmendja e profetësisë ngjitur me robërinë, nuk ka ndodhur që t’i jetë përmendur asnjë pejgamberi më parë. Fjala e Njesisë na tregon se baza e Islamit është e mbushur plot me thesarin e robërisë. Pejgamberi (a.s.), ka fituar statusin më të lartë përmes robërisë së tij dhe është bërë njeriu i vetëm që ka fituar statusin e të qenit i dashuri i Allahut. Ai është imami i të gjithë ibadeteve. Ai është imami i imamëve. Ai (a.s.), është pasqyra më e përsosur dhe më e mrekullueshme e Allahut. Ai është burimi i nurit. Ai është elementi i së vërtetës. Ai është trupëzimi i dashurisë së përsosur. Ai është kryeprofeti, mësuesi i gjithësisë, dielli i revelacionit dhe profetësisë, sal-lall-llahu alejhi ue slem! Kurani përfshin të gjitha shpalljet hyjnore të tjera. Ndaj dhe profetësia e Pejgamberit tonë (a.s.), është përmblyllëse, është vula e profetësive. E gjithë urtësia e Kuranit është akumuluar tek Pejgamberi ynë (a.s.), që do të thotë se Kurani shpjegon qenësinë (zat), cilësitë, gnosën, jetën, zemrën dhe moralin e Pejgamberit tonë të dashur (a.s.). Qenia e tij është përmbledhur me fjalët e Kuranit. Pejgamberi (a.s.), zotëronte të gjithë statutet e *irshad*-it. Në Kuran thuhet: “**Thuaju** (o Muhamed): **‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’**” (Al’Imran, 31.) Ai është shembulli më i bukur për të gjithë njerëzimin dhe veçanërisht për ymetin e vet, si dhe ymeti i tij është ymeti më i përzgjedhur në mesin e të gjithë ymeteve të njerëzimit që kanë ardhur dhe që do të vijnë ndonjëherë.

Që të gjitha virtytet janë mbledhur tek ai njeri i begatë. Natyra, morali, bukuria dhe personaliteti i Pejgamberit (a.s.), janë shkaku pse Allahu krijoi gjithësinë dhe gjithçka çfarë mban brenda ajo. Zoti i botëve i është drejtuar të dashurit të vet (a.s.), duke i thënë: “*Sikur mos të ishte ti, nuk do të krijoja gjithësinë!*” Esenca e fesë islame është thesari i dashurisë; xheneti i miraxhit dhe i afinitetit janë mësime më sublim i dashurisë për të gjitha kohët. Zeniti i dashurisë është miraxhi. Kjo gjendje ka arritur të realizohet përmes namazit. Miraxhi është

nuri hyjnor, është dhuntia hyjnore dhe përmbledhja e *moralit muhamedan*. Është pikërisht shija hyjnore që ka shijuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili thoshte: “*Në namaz më është dhënë drita e syrit.*” Begatia e namazit u dhurua në shenjë respekti të lutjes që natën e Miraxhit i bëri Pejgamberi (s.a.s.), Zotit të Madhëruar. Sërish, si rrjedhojë e lutjes që ai bëri, do t’i bëjë shefat të gjithë ymetit në Ditën e Mahsherit. Në sajë të tij, mëshira dhe dhembshuria është përhapur në mbarë rruzullin tokësor. Me nurin e gnosës së tij (a.s.), i gjithë njerëzimi u bë organizma që përjetoj hallkat e Tevhidit që çelin lulet. Pejgamberi (a.s.), në mesin e njerëzve është njeriu më *dhakir*, më *shakir* dhe robi më i lartë. Robi më i lartë në këtë gjithësi është Pejgamberi ynë i dashur Muhamedi (a.s.), i cili mbarti në veten e vet fshehtësinë e përsosmërisë hyjnore mes Krijuesit dhe krijesave, robit dhe Zotit, robit dhe të Adhuruarit. Ai përfaqëson të vërtetën e Fatihës.

Ekziston një kusht hyjnor për ata besimtarë që duan të bëjnë ibadet të vërtetë; të tregosh dashuri të pafundme për njeriun që na solli më të lartin e ibadeteve! Pra, sa më shumë që ta duam Pejgamberin (a.s.), sa më shumë të kopjojmë moralin e bukur të tij, sa më shumë të përpiqemi që t’i ngjasojmë atij, sa më shumë të përpiqemi të dëgjojmë fjalët e tij dhe të mësojmë prej tyre, aq më shumë do të jemi brenda prehjes shpirtërore dhe çiltërsisë. Nëse do ta marrim shembull në namaz: Paramendoni sikur një njeri kur fal namaz, të ndihet sikur po ngjitet në Miraxh... Këtë mund ta përjetojë vetëm atëherë kur t’i shprehë dashuri e respekt të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili i dhuroi njerëzimit Sheriatin dhe dashurinë që ndjente për Allahun e Madhëruar. Sa më shumë që ta duam Pejgamberin tonë të dashur (a.s.), aq më shumë do të na ushqejë namazin tonë. Në varësi të përpjekjeve tona të sinqerta që do të shprehim për të ecur në rrugën e tij (a.s.), do të zbukurohet namazi dhe do të marrë jetë. Atëherë kur të jemi përpjekur që të mund të jemi pluhuri i këmbëve të tij, atëherë do të bëjmë sexhde më të vërteta. Sa më shumë që të jemi pjesëtarë të dhimbjeve të Pejgamberit (a.s.) dhe të shqetësimeve hyjnore të tij, sa më shumë të qajmë bashkë me të dhe të drithërohemi njëherazi, vetëm atëherë mund të meritojmë të shijojmë dhuntinë e të qenit pranë Rahmanurrahimit. Përderisa ai ka vendosur edhe jetën e vet për ne, edhe ne duhet t’ia tregojmë dashurinë që ndjejmë për të. Dashuria e vërtetë shprehet atëherë kur e marrim shembull atë, kur të gjitha ndjenjat, mendimet, ndjesitë, lëvizjet dhe veprat tona u ngajnë atyreve të tij. Shqetësimi i tij duhet të jetë edhe shqetësimi ynë. Shkurtimisht, edhe ne duhet të mund t’i ndajmë lotët, madhëshësinë, mërzinë, lumturinë e tij.

Kjo botë

— Nuredin Jëlldëz —



Elhamdulillah jemi besimtarë. Ngaqë jemi besimtarë, çdo gjë të dukshme apo të padukshme e shohim sipas besimit që kemi përvetësuar. Ne e pranojmë si të zezë atë që besimi ynë e quan të zezë, edhe nëse syri ynë e shikon të bardhë. Edhe këndvështrimi ynë ndaj kësaj bote mbi të cilën gjendemi, është i njëjtë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), na e ka shtruar përpara këtë botë si diçka që nuk ka vlerë “as sa flatra e një mize”. Edhe nëse një pjesë toke bën shumë shtrenjtë në një vend të caktuar, për ne është aq e vlefshme saqë mund ta matim me flatrën e një mize. Kështu kemi besuar dhe kështu dëshirojmë të dalim në audiencën e Allahut të Lartësuar.

Kjo vlerë e ulët e kësaj bote, aq sa është një rregull konciz për të besuar, po aq e vërteton edhe realitetin e dynjasë. Të qenët e saj e përkohshme, ia ul vlerën. Siç është vetë e përkohshme, edhe çdo gjë që gjendet mbi të është e përkohshme. Ajo vetë nuk është e përhershme dhe asnjë gjallesë mbi të nuk mund t'i japë përjetshmëri. Ajo është me huqe si mushka, që asnjëherë nuk i dihet se kur do ta hedhë atë që i ka hipur. Ne jetojmë në një botë ku lulet vyshken. Ne kemi një botë, së cilës i shteron uji, i nxehti i saj të përvëlton dhe i ftohti i saj të ngrin. Atij që nuk punon, nuk i jep për të ngrënë. Atë që ushqen, nuk e mbron. Ne kemi një botë, sëmundja e së cilës është ngjitëse. Zjarri i saj është i rrezikshëm. Atij që nuk fle, nuk i bëhet e dashur, por edhe atij që fle, nuk ia shkel syrin. Ajo kalon mbi ne si retë, na bën hije dhe na lag. Siç nuk mund ta nënshtrojmë renë, nuk mund ta nënshtrojmë edhe atë.

Të vdekurit që i ka nën vete, janë shumë më tepër se të gjallët që ecin mbi të. Edhe ata që i ka brengosur dhe i ka shkatërruar, janë më shumë se ata që i ka gëzuar dhe lumturuar. Ka pasur prej atyre që kanë humbur në errësirën e natës. Ka pasur edhe prej atyre që janë përvëluar dhe kanë vdekur në shkretëtirat e saj. Ajo duket si e pafundme, por, edhe pse duket e tillë, askujt nuk i jep vend më shumë se sa një varr. Ajo rrotullohet dhe bashkë me veten, rrotullon edhe ata që ka sipër. Mashtron, vyshket, kalbet, shtypet dhe zhduket. Edhe emri që ka, e tregon se çfarë është: Vend i ulët dhe me kohë të shkurtër. Ajo është shumë për një njeri dhe pak për dy njerëz.

Kjo botë është e mbushur me mirësi, por për çdo mirësi ka dhënie llogarie. Dynjaja të bën të punosh për të arritur ndonjë mirësi dhe pasi ta arrish, të bën të japësh llogari. Nëse pi një gotë

ujë, do të merresh në llogari për të. Nëse ha një kokërr fik edhe për atë do të japësh llogari ndaj degës së fikut. Madje, nëse merr qoftë edhe një frymë, do të japësh llogari për atë ajër që ke marrë. Kështu është kjo botë e mbushur plot me mirësi. Ato nuk vijnë pa mund. Edhe pasi të vijnë, ka llogari për to. Për këtë arsye, kjo botë për ne është e pavlefshme sa një flatër mize, edhe pse ka qaq shumë mirësi marramendëse. Ajo është e pavlefshme në llogarinë e Krijuesit të saj. Këtë e ka vërtetuar edhe përvoja mijëra vjeçare e njerëzve. Sado që të kenë ujë oqeanet e saj, sado që të jenë të gjera luginat e saj dhe sado që të jenë të larta malet e saj, e vërteta absolute është kjo: Ajo është e pavlerë dhe e përkohshme.

Kështu kemi besuar dhe kështu e shikojmë. Ka edhe një të vërtetë tjetër, që duhet ta besojmë: Bota është krijuar kështu, në mënyrë që të sprovohej. Asgjë nuk është e rastësishme. Allahu i Madhëruar e ka krijuar kështu. Ai dëshiroi të shikonte se kush do të bënte vepra të mira dhe kush do të bënte vepra të këqija, prandaj tabloja që kemi përpara është e atillë. Ai dëshiroi të shikojmë nga kjo botë, që nuk vlen as sa një flatër mize, në xhenetin që s'e ka parë asnjë sy dhe s'e ka imagjinuar asnjë mendje. Ai dëshiroi të na nxjerrë nga e përkohshmja për te e përhershmja. Ai kërkoi nga ne që të përgatisim prehjen e përhershme nga netët pa gjumë, buzëqeshjet e përhershme nga lotët dhe fatkeqësitë, dashuritë e pandashme nga miqtë dhe miqësitë provizore.

Besimi na urdhëron që ta shohim këtë botë si një flatër mize, kundërvlera e së cilës është xheneti. Ajo është e pavlefshme, por është baza e së vlefshmes. Ajo është një hiç, por çdo gjë fitohet me të. Ajo është e përkohshme, por do të jetë dera e përjetshmërisë. Prandaj ne nuk jemi për atë, por ajo është për ne. Llogarinë e kësaj bote do ta bëjmë sipas një ekuacioni: “Çdo gjë që ka kjo botë, dëshirojmë të jetë e jona, por ato nuk i propozim në zemrën tonë. Gjëja për të cilën them “është e imja”, është ajo gjë që qëndron në dorën time. Asaj që më bën egoist, nuk mund t'i them e imja. Unë jam amanet këtu. Po ashtu edhe ato që pandeh se janë të miat. Si mund të qëndrohet pafundësisht mbi këtë botë që është e përkohshme? Dynjaja është një sprovë e rëndë. Kjo sprovë është shumë edhe më e rëndë për ata që nuk mund t'i kuptojnë dimensionet e saj.



Urtësia NË HISTORITË E KURANIT FISNIK

— M. Sami Ramazanollu —

Historitë në Kuran tregojnë ngjarje të vërteta. Prandaj quhen “histori të vërteta”. Këto histori, siç pohojnë edhe disa orientalistë, nuk janë tregime që s’kanë lidhje me të vërtetat historike apo që thuhën për të dhënë këshilla. Historitë që tregohen në Kuran, janë të vërteta historike dhe lajme në lidhje me popujt e mëparshëm. Allahu i Madhëruar ka thënë në Kuran: **“Kështu pra, Ne po të tregojmë ty (o Muhamed) disa histori të së kaluarës. Ky (Kuran) që të kemi dhënë, është një Këshillë nga ana Jonë.”** (Taha, 99.) **“Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës. Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcua në rrugën e drejtë.”** (Kehf, 13.)

Këto shprehje të Kuranit Fisnik janë një mrekulli e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili nuk dinte shkrim e këndim, që të lexonte librat e vjetër dhe të mësonte prej tyre. Po ashtu, janë edhe një përgjigje për politeistët që Kuranit i thoshin **“esatiru’l-evvelin / përralla të të lashtëve”**. (Kalem, 15.) Sepse Kurani Fisnik nuk përbëhet nga përrallat e të lashtëve, por ai tregon lajmet dhe historitë e tyre.

Kurani është zbritur për t’i orientuar njerëzit në

rrugën e drejtë. Për këtë arsye, përdor metodën e urtësisë dhe këshillimit. Ngjarjet e përjetuara i tregojnë me një metodë ndikuese dhe kërkon që njerëzit të nxjerrin mësim nga ato, sepse të njëjtat ngjarje mund t’u ndodhin të gjithëve në çdo kohë.

Deklarimet, këshillat dhe urtësitë që Kurani i ka përdorur si metodë, janë të mbledhura bashkë në histori. Ndër pesë temat që përfshin Kurani (besimi, ibadeti, veprat, ndëshkimet, morali dhe historitë), ajo që është shtjelluar më gjerë është tema e moralit dhe historive. Me të vërtetë, synimi i dërgimit të profetëve është udhëzimi i njerëzve dhe edukimi i tyre me moral. Prandaj, relativisht gjysma e Kuranit Fisnik përbëhet nga historitë e pejgamberëve dhe popujve të mëparshëm, në mënyrë që njerëzit të marrin mësim.

Historia ka rol të madh në edukimin e njeriut. Tregimi i ngjarjeve që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën dhe i shkaqeve të tyre, e udhëzon dhe i jep mësim edhe njeriut të sotëm, sepse njeriu është i njëjtë me të tjerët në aspektin e krijimit, prirjeve dhe dobësive. Ajo që bënte fjalë për njerëzit dhe popujt e mëparshëm, bën fjalë edhe për njerëzit e sotëm.

Për shembull, fundi i dhimbshëm i femohuesve dhe tiranëve, shtrohet para syve në Kuran duke treguar padrejtësitë që u bënë shkak për mbytjen në det të Faraonit dhe ushtrisë së tij. Po ashtu, në historinë e Hz. Jusufit (a.s.), tregohen në mënyrën më të bukur gradat e mëdha që do të arrijnë dhe shpërblimet marramendëse që do të marrin për durimin ata që u kanë vënë gjoksin vështirësive dhe nuk e kanë humbur besimin e mbështetjen tek Allahu Teala.

Synimi i historive në Kuran nuk është dhënia e informacionit historik. Prandaj nuk tregohen vendet dhe koha të cilat shfaqin detaje. Qëllimi është “tregimi i disa cilësive në historitë e popujve të ndryshëm, shpjegimi i ngjarjeve që kanë ndodhur në jetën e Hz. Muhamedit (a.s.) dhe që u ngajjnë atyre që kanë ndodhur në jetën e pejgamberëve të tjerë, vërtetimi se e drejta dhe e vërteta do të fitojnë dhe do të jenë të larta gjithmonë, ngushëllimi i Pejgamberit e i besimtarëve dhe forcimi i vendosmërisë së tyre duke ua vërtetuar me shembuj historikë shkatërrimin dhe shkrirjen e atyre që kanë kundërshtuar pejgamberët”. (Mehmed Sofuogllu, Hyrje në Tefsir, fq. 97.)

Në Kuranin Fisnik tregohen historitë e Hz. Ademit, Hz. Nuhut, Hz. Hudit, Hz. Salihut, Hz. Ibrahimit, Hz. Ismailit, Hz. Is'hakut, Hz. Lutit, Hz. Jakubit, Hz. Jusufit, Hz. Shuajbit, Hz. Musait, Hz. Davudit, Hz. Sulejmanit, Hz. Idrisit, Hz. Lukmanit, Hz. Dhu'lKiflit, Hz. Iljasit, Hz. Uzejrit, Hz. Ejubit, Hz. Junusit, Hz. Zekerijja, Hz. Jahjas, Hz. Isait dhe Hz. Muhamedit (a.s.).

LAJMET E POPUJVE TË KALUAR

Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, në “historitë e së kaluarës” (Taha, 99.) zënë vend historitë e Hz. Dhu'lKarnejnit, As'habu'l-Kehfit, As'habu'l-Uhdudit, As'habu'l-Filit, As'habu'r-Resit, As'habu'l-Ejkes, Adit, Themudit dhe e popullit të Hz. Lutit e Hz. Nuhut. Veçanërisht shtjellohet edhe historia e Israsë, Hixhretit, Bedrit, Uhudit, Benu Nadirit, Ahzabit, Çlirimit të Mekës, Luftës së Hunejnit, Ngjarjes së Ifkut dhe historitë e hipokritëve. Në suren Jusuf, e cila tregohet si historia më e bukur / ahsen kis-sah, ka mësim të shumanshme. Prej tyre mund të përmendim: Shpërblimi i madh për durimin dhe rezistimin ndaj vështirësive, shpresa e pathyeshme

në çdo kohë ndaj Allahut Teala, mosbindja ndaj dëshirave të këqija të nefsit dhe shejtanit, lidhja me Allahun e Lartësuar, falja e atyre që bëjnë të këqija pa dije dhe edukimi i tyre me moral të lartë, vërtetimi se je një njeri i besueshëm duke e kryer në formën më të mirë detyrën që të është dhënë, mbajtja e amanetit dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Po, Kurani është për t'u kuptuar dhe për t'u jetuar. Ndërsa historia e bën më të lehtë dhe më të dashur leximin dhe kuptimin e tij.

HISTORIA SI MJET EDUKIMI

Rrëfimet historike, fetare dhe morale kanë një rëndësi të madhe në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve. Përshkrimi me një gjuhë dinamike dhe metodë letrare i ngjarjeve të përjetuara apo që mund të përjetohen, ka një ndikim shumë të madh te lexuesit. Përfundimet e tmerrshme të të këqijve dhe

imoralëve, më mirë tregohen me metodën e rrëfimit. Në këtë mënyrë, njerëzit largohen nga të këqijat. Edhe veprat e mira dhe shembujt e moralit të lartë duhet të tregohen në këtë mënyrë influencuese, që të rinjtë të inkurajohen për sjellje dhe vepra të mira.

Për t'ua bërë njerëzve Islamin të dashur, është përfutur shumë nga rrëfimet dhe historitë. Edhe nëse nuk ka ndonjë kundërshtim me fenë në tregimin e historive morale të këtij lloji duke synuar edukimin e të tjerëve, është e ndaluar të trillosh tregime duke u dhënë natyrë fetare për të inkurajuar apo për të ndaluar diçka që nuk ka bazë në Kuran dhe Sunet. Në historinë e njerëzimit ka pasur shumë rrëfyes që kanë trilluar dhe transmetuar histori për përfitimet e tyre personale, duke e keqpërdorur ndikimin që ato kanë te njerëzit. Ngaqë mistika Islame merret me përsosjen e moralit (tehzibu'l-Ahlak) dhe edukimin e nefsit, përfiton shumë nga historitë kur shtjellohet temat. Historitë që tregojnë mistikët, në shumicën e rasteve janë histori të Beni Israilëve dhe rrëfime e tregime që shpalosin moralin dhe sjelljet e personaliteteve shembullore.

Le t'i gjallërojmë kuvendet tona me historitë e pejgamberëve, dijetarëve, evlijave dhe luftëtarëve tanë. Nganjëherë, ato që thuhet, harrohen, por mesazhi kryesor i një historie është i pavdekshëm. Atëherë, përse të mos përfitojmë prej historive?

Historia ka rol të madh në edukimin e njeriut. Tregimi i ngjarjeve që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën dhe i shkaqeve të tyre, e udhëzon dhe i jep mësim edhe njeriut të sotëm, sepse njeriu është i njëjtë më të tjerët në aspektin e krijimit, prirjeve dhe dobësive.



ÇFARË QENIEJE ËSHTË DJALLI DHE SI E MASHTRON NJERIUN

— Abdurrahim Somunxhu —

Iblis është emri i djallit që ishte në xhenet. Pasi u dëbua nga xheneti, djalli mori emrin e vet. Xhindët dhe djajtë janë krijesa që nuk perceptohen nga organet tona të shqisave. Xhindët dhe djajtë zotërojnë vetëdije dhe vullnet. Këta janë të obliguar të respektojnë urdhëresat dhe ndalesat e fesë islame.

Djalli është prej xhindëve të egër dhe të devijuar. Në Suren Kehf, ajeti 50 thuhet se djajtë janë prej kategorisë së xhindëve. Djalli është një qenie që e shtyn njeriun në rrugë të gabuar, që e cyt zemrën e tij nga jashtë dhe i pëshpërit fshehtas. (Surja Nas, 5)

Në Suren Bekare, ajeti 34 përmendet njoftimi i Allahut ndërkohë që iblisi (djalli) jetonte me engjëjt në xhennet: “...Kur u thamë engjëjve (dhe xhindëve): ‘Përluni në sexhde para Ademit’, ata u përlën, përveç Iblisit (djallit), i cili nuk desh, u tregua mendjemadh dhe u bë mosbesimtar.”

Fakti se përse djalli nuk i bëri sexhde Ademit shpjegohet kështu në Suren A’raf, ajeti 12: “**Allahu tha: ‘Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?’ Ai (iblisi) u përgjigj: ‘Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta’.** (Tha se zjarri ka pozitë më të lartë se balta dhe kundërshtoi duke mos iu bindur urdhrat të bënte sexhde (t’i përkulej) Ademit).”

Edhe xhindët, si djalli dhe njerëzit, hanë, pinë, lindin, martohen, bëjnë fëmijë dhe vdesin. Profeti, (a.s.), i shikonte e i njihte xhindët. Ai ishte profet edhe i tyre. Ai gjykonte për zgjidhjen e problemeve midis xhindëve.

Sulejmani, (a.s.), ndërtoi Mesxhid-i Aksanë, duke vënë në punë edhe xhindët. Xhindët nuk e dinë të fshehtën. Në Suren Se’be ajeti 14 bëhet e ditur se xhindët nuk e dinë të fshehtën.

Krijimi i xhindëve daton para krijimit të njerëzve.

Njerëzit, të cilët i mashtroi për herë të parë djalli dhe u përpoq t'i nxirrte nga rruga e drejtë duke u betuar rrejtshëm, ishin prindërit tanë Ademi dhe Havaja (a.s.). Ademi, (a.s.), bashkë me nënën tonë, Hava, jetonin në xhenet. Teksa hëngrën nga pema që ua kishte ndaluar Allahu, djalli i këshilloi dhe i garantoi ata duke u betuar rrejtshëm se nuk do t'i dëmtonte asgjë, nuk do të dilnin nga xheneti dhe do të qëndronin përjetësisht në të. Në Suren A'raf, ajetet 19-22 përmendet: **“Dhe iu betua atyre (duke thënë): ‘Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!’**”

Djajtë i zbukurojnë gjërat e gabuara për të devijuar njerëzit nga rruga e drejtë. (Surja Ankebut, 38) Djalli është përpjekur ta nxjerrë nga rruga babain tonë, Ademin, (a.s.), i cili është njeriu dhe profeti i parë dhe ta nxjerrë bashkë me bashkëshorten e tij prej xhenetit. Vallë, a nuk mund të na devijojë nga rruga e drejtë djalli, si (nipër) pasardhës të babait tonë Ademit?

Në Suren A'raf, ajeti 17 thuhet se djalli do t'i largojë njerëzit nga rruga e drejtë: **“ (ai kundërshtoi Allahun duke thënë: ...) e pastaj, do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!”**

Çfarë dëshirojnë të bëjnë djajtë për t'i devijuar njerëzit në rrugë të keqe? Për këtë, në Suren Maide, ajeti 91 thuhet: **“Vërtet, djalli me pije alkoolike (që të dehin) dhe me bixhoz kërkon të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë (nga këto)?”**

Gjithashtu, në Suren Bekare, ajeti 268 bëhet e ditur se djalli i urdhëron njerëzit në varfëri dhe ligësi. Megjithatë, siç është djalli prej xhindëve që kanë devijuar, ashtu është edhe prej njerëzve. Për këtë, në Suren Nas, ajetet 4, 5, 6, thuhet: **“(Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve) ... nga sherri i**

djallit cytës (që u cyt njerëzve gjëra të këqija) që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindëve apo njerëzve!” Në këtë sure bëhet e ditur se ka edhe djaj prej njerëzve përveç djallit prej xhindëve.

Cila është detyra që na bie? Është ta njohim djallin si armik dhe të mos shkojmë pas gjurmëve të tij. Prej nesh kërkohet mbështetje te Allahu për t'u mbrojtur nga sherri dhe cytjet e këtij djalli. Në suren Mu'minun, ajeti 97 thuhet: **“Dhe thuaj: ‘O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet (shigjetat helmuese që i hedhin në zemër) e djajve ...”** Mënyra për t'u mbrojtur nga djalli është të mbizotërosh mendjen dhe të mbrohesh nga sherri i djallit, duke lexuar: **“Eudhu bil-lahi mine'sh-shejtani'rr-raxhim!”**, që është arma shpirtërore e besimtarit.

Si përfundim, kur të hyjë në xhenet i zgjedhuri për në xhenet dhe në xhehenem i zgjedhuri për në xhehenem; kur të mblidhen rreth djallit pasuesit e tij dhe t'i thonë se na mashtrove dhe u bëre shkak që ne të hyjmë në xhehenem, përgjigjen që jep djalli e mësojmë nga Surja Ibrahim, ajeti 22: **“Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do t'u thotë (atyre): ‘Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë.**

Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova (devijova nga fjala ime). Unë nuk kam pasur kurrfarë (force) pushteti mbi ju. Unë thjesht ju thirra (të mohonit dhe kundërshtonit) e ju m'u përgjigjët. Prandaj, mos më qortoni mua, por qortoni veten! Unë nuk jam shpëtimtari juaj e as ju nuk jeni shpëtimtarët e mi! ...”

Profeti, (a.s.), ka thënë: **“Çdo njeri ka një djall.”** Myslimani duhet të kërkojë gjithnjë mbrojtje prej Allahut. Nga Profeti këshillohet leximi i Ajetu'l-Kursij dhe i sureve Felek e Nas kundër ndikimit negativ të xhindit dhe djallit. (Buhari, “Vekale-Kujdestaria”, 10; Tirmidhi “Tib-Mjekësia”, 16)

Allahu na mbroftë nga e keqja e djajve prej njerëzve dhe xhindëve!

“Vërtet, djalli me pije alkoolike (që të dehin) dhe me bixhoz kërkon të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë (nga këto)?”



Mos mendo kurrë SE ALLAHU NUK E VËREN ATË QË BËJNË KEQBËRËSIT!

— Prof. dr. Omer Çelik —

Titullin e këtij shkrimi e mora nga ajeti 42 i sures Ibrahim. Ky mesazh hyjnor është një ngushëllim për të gjithë të shtypurit që rezistojnë ndaj mizorive anembanë botës, kurse për zemrën e keqberësve është një kërcënim.

Me keqardhje duhet thënë se skenat makabre në ditët e sotme po ndjekin njëra – tjetrën. Gjaku i myslimanëve po rrjedh pareshtur.

Lufta civile, që vazhdon prej dy vitesh e gjysmë në Siri, u bë shkak që me mijëra njerëz të vdesin, me qindra mijëra të mbesin pa strehim dhe pa asnjëfarë mbështetjeje. U vranë gra, fëmijë dhe të moshuar. Me mijëra njerëz u vranë si pasojë e armëve kimike.

Ato çfarë po përjetohen në Egjipt janë një tjetër vitrinë e makabritetit. U hap zjarr me plumba të vërtetë ndaj atyre njerëzve që bënë protestë paqësore, për të mbrojtur të drejtat e tyre më të natyrshme, ata njerëz që shprehnin se edhe sikur t'i vrisnin, nuk do të vrisnin njeri. Me mijëra njerëz u vranë pa mëshirë dhe me mijëra u plagosën.

Ato çfarë ndodhën në Irak, Palestinë, Afganistan, Turkistanin Lindor dhe në Birmani janë ngjarje të ngjashme me njëra-tjetrën...

Në fakt, keqbërja është një veçori e pandarë e natyrshmërisë së njerëzve profanë të çdo fushe njerëzore. Kur Allahu i Madh ua ofroi qiejve, tokës dhe maleve amanetin e robërisë ndaj Tij, ata nuk pra-

nuan të merrnin përsipër përgjegjësinë e rëndesës së këtij amaneti, pasi atë e panë si shumë “*dhalum*” (dhunë) dhe shumë “*xhehul*” (injurancë). Pikërisht kjo është edhe urtësia e dërgimit të peygamberëve dhe librave të shenjtë. Këto dituri të sakta, që vijnë nga Allahu, do ta kuronin sëmundjen e injurancës së njeriut; kurse kryerja e veprave të mbara, do t’ia shëronte njeriut sëmundjen e “mizorisë”. Mirëpo, njerëzit që rriten në mungesë me edukimin dhe arsimimin fetar, për arsye se nuk mund të kurojnë sëmundjen e dhunimit dhe të injurancës, në këtë mënyrë do të vijoje si burimi i së ligës dhe së keqes. Mizoria dhe padrejtësia më e madhe, do të burojnë prej tyre, pasi Zoti i Madhëruar ka njoftuar se femohuesit janë gjallesat më të liga që ecin mbi sipërfaqen e tokës. (Shih. Enfal, 55.)

Në procesin historik veçoria e të qenit të njeriut kaq mizor, shkatërrimtar dhe gjakatar, ka pasur pasqyrimë në përmbajtje dhe thellësi të ndryshme. Kur u hedhim një sy shembujve që jepen në Kuranin Famëlartë, përballemi me skena që njeriun e bëjnë të tmerrohet:

Shokët e Uhdudit u hodhën në mënyrë të pamëshirshme në gropën me flakë. Ndoshta ata ishin me mijëra... Vetëm pse besonin në Allah u hodhën të digjeshin në zjarr. Ata që e bënë këtë vepër makabre, u ulën të qetë duke parë se si do të digjeshin besimtarët.

Faraoni i dhunonte bijtë e Izraelit. Duke i asim-

luar, donte t'ua shuante rrënjët e tyre. Sipas një ëndrre të keqe që pa, vrau të gjithë fëmijët meshkuj që hapën sytë në këtë botë, duke menduar: "Ky është djali që do të më shkatërrojë pushtetin tim". Thuhet se janë vrarë me dhjetëra mijëra fëmijë të sapolindur...

Magjistarëve, të cilët nuk u vinin veshin kërcëni-meve "të var, të vras!", të Faraonit, iu prenë këmbët tërthorazi dhe u varën në pemët e hurmave. Ky fund i tyre ishte vetëm pse besonin Allahun. Dhe në frymën e fundit janë lutur duke thënë: **"O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!"** (Araf, 126), me kujdesin që "të mund të vdisnin si myslimanë".

Habibi Nexhari u martirizua duke u gjuajtur me gurë dhe duke u rrahur, vetëm pse mbështeti delegacionin që kishte ardhur për t'i ftuar njerëzit në besimin e vërtetë dhe, ngaqë ai ftoi të afërmit e vet tek e vërteta. Dhunohet dhe vritet. Mirëpo, kur është duke vdekur, me një zemër të gjerë dhe me ndjenjën e mëshirës, lutet: **"Ah, sikur ta dinte populli im se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!"** (Jasin, 26 - 27)

Sa e sa ngjarje tregohen në Kuranin Famëlartë, me qëllim që njeriu të marrë shembull...

Kjo do të thotë se skenat e tmerrshme makabre nuk ndodhin vetëm në ditët e sotme. Natyrisht që kjo gjë nuk bën që ta shikojmë mizorinë si diçka normale. Mizoria është mizori dhe duhet dënuar mjaft i ashpër. Mirëpo, shembujt që kemi dhënë lart janë për t'u analizuar shumë thellë, me mendje të shëndoshë dhe gjakftohtë. Besimtarit i jep fuqi dhe vendosmëri të veçantë fakti që ai është në një sprovë. Pejgamberit (a.s.), thuhet se është marrë fryma përballë dhunës dhe mizorisë dhe formave të ndryshme të saj, por sjellja e tij është bërë burim ngushëllimi dhe qëndrese për të gjithë njerëzit.

Nuk duhet harruar edhe ky detaj: nëse keqbërësi ka me vete keqbërjen dhe fuqinë e ushtrimit të dhunës, i dhunuari ka me vete Allahun. Allahu i Madhëruar herët a vonë do ta ndihmojë të dhunuarin. Do të largohen errësirat dhe do të lindë dielli i lumturisë dhe i gëzimit në atmosferën e prehjes së Islamit.

Mes duasë së të dhunuarit dhe Allahut nuk ka asnjë pengesë. Allahu përmbush medoemos duanë e të dhunuarit.

Atëherë kur i dhunuari fiton fuqi, ka të drejtë të rimarrë të drejtën e cenuar nga dhunuesi brenda kornizës juridike. Aq sa ka bërë dhunuesi ndaj të dhunuarit, i ushtrohet në të njëjtën masë ligjore edhe dhunuesit. Kjo është e drejta e tij më e natyrishtme. Mirëpo, kur je i fuqishëm, falja dhe durimi kanë një vend të veçantë për nga aspekti i krijimit

të paqes dhe qetësisë në botë. Për këtë ka shumë shembuj:

Kur mushrikët e braktisën Uhudin, Resulullahu (a.s.), shkoi pranë të vararëve. Ai u përball me një skenë që e lodhi shumë shpirtërisht. Pasi pa që ia kishin hapur barkun xhaxhait të vet, që e donte aq shumë, Hz. Hamzait, dhe ia kishin prerë hundën dhe veshët, psherëtiu në këtë mënyrë:

"Sikur të mos ishin mërztitur gratë dhe sikur të mos ishte një mënyrë që do të ndiqej pasi të iki unë nga kjo botë, do ta lija në atë mënyrë deri në çastin e ringjalljes, në Ditën e Kiametit, që ta hanin kafshët dhe shpendët grabitqare. Beto hem që, në vendin e tij, do të bëj kisas shtatëdhjetë mushrikë."

Pastaj kërkoi të sillej një mbulesë. Me atë mbuloi fytyrën e Hamzait (r.a.), kurse këmbët i mbetën jashtë. Resulullahu (a.s.), me atë mbulesë mbuloi fytyrën, ndërsa këmbët ia mbuloi me barin iz'hir. Dhe pasi e mori përpara, bëri dhjetë herë tekbir. Pastaj u mbloodhën të gjithë shehidët përreth dhe iu fal namazi i xhenazes. Kurse Hz. Hamzain (r.a.), e lanë në vendin ku e kishte lënë ai. Kështu që, për Hz. Hamzain u fal shtatëdhjetë herë namazi i xhenazes, sepse numri i atyre që kishin rënë shehidë në Uhud ishte shtatëdhjetë. Pasi përfundoi varrimi i shehidëve, u shpallën ajetet 126 - 127 të sures Nahl;

"Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar, por, nëse duroni, kjo është më e mira (rrugë) për të durueshmit. Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushto për shkak të dredhive të tyre!" I Dërguari i Allahut (a.s.), duroi dhe nuk i bëri askujt kisas. (Darekutni, IV, 118)

Allahu i Madhëruar thotë:

"Shpërblimi për të keqen është i njëjtë me atë të keqe. Por atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët." (Shura, 40)

Të kundërveprosh ndaj së keqes me të njëjtën masë është drejtësi, kurse të durosh të keqen që të bëhet dhe ta falësh atë që ta bën atë, është një virtut i lartë. Këto ajete, përmes Resulullahut (a.s.), këshillojnë të gjithë besimtarët të veprojnë me kujdes dhe me virtyte, të jenë të durueshëm dhe të matur.

Sa skenë e mrekullueshme është shembulli i faljes që tregoi Resulullahu (a.s.), ndaj armiqve të përбетuar të myslimanëve gjatë çlirimit të Mekës!

Me shpresën që të vijnë ditët e lumtura, të paqta dhe të gëzuara, kur mund të marrim fuqi dhe pushtet për të shpëtuar nga të qenit të dhunuar; kur mund të mbrojmë të drejtat e atyre që janë dhunuar, ashtu sikurse mbrojmë të drejtën tonë; kur të manifestojmë shembuj faljeje që bëjnë njerëzit të ngrohën me Islamin, madje edhe vetë mizorët...



SADAKAJA NUK E PAKËSON PASURINË

— Naim Drijaj —

Allahu (xh.sh.), thotë: *“Ata që shpenzojnë pasurinë e tyre për hir të Allahut, pa e shoqëruar atë me përgojime apo fyerje, do të shpërblehen nga Zoti dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo të pikëllohen.”* (Bekare, 262)

Ibn Abasi (r.a.), ka thënë: “Dy gjëra janë prej shejtanit dhe dy gjëra janë prej Allahut të madhëruar, pastaj lexoi ajetin e Kuranit:

“Shejtani ju frikëson me skamje e varfëri, si

dhe ju mëson të bëni vepra të pamoralshme, kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij.” (Bekare, 268)

Në një hadith të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, Pejgamberi (a.s.), na tregon se Allahu (xh.sh.), ka thënë: *“Dhuro o robi Im, sepse Unë do të jap ty edhe më shumë begati.”*

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Sadakaja nuk e pakëson pasurinë...”* (Muslimi)

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “*Shtatë persona do të hyjnë nën hijen e arshit të Allahut, atë ditë kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së Tij. Njëri prej tyre është personi i cili jep sadaka me dorën e djathtë, pa e ditur e majta.*”

Lëmosha bëhet shkak që Zoti të falë shërimin nga sëmundjet e ndryshme:

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “*Mjekojini të sëmurit tuaj me lëmoshë, mbrojeni pasurinë tuaj duke dhënë zekatin dhe përgatituni për sprovat e jetës duke bërë dua.*” (Bejhakui)

Lëmosha të shpie në mirësi dhe devotshmëri:

Kur Omerit (r.a.), i pëlqente diçka që e kishte, ai e jepte atë sadaka për hir të Zotit të Lartësuar, duke zbatuar kështu fjalën e Tij:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, për sa kohë që nuk ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...” (Ali Imran, 92)

Aishja (r.a.), para se të jepte sadaka, e merrte monedhën dhe e parfumoste. Kur e pyetën përse e bënte këtë gjë, ajo tha: “E bëj, pasi ajo do të bjerë në dorë të Allahut, para se të bjerë në dorën e të varfrit.”

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “*Çdo vepër e mirë dhe e hairit konsiderohet sadaka.*” (Buhari, Muslim).

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*T’i buzëqeshësh vëllait tënd është sadaka. Të urdhërosh një person të bëjë një punë të mirë dhe ta pengosh atë që të bëjë një punë të keqe, është sadaka.*”

Të udhëzosh njeriun që ka humbur rrugën e drejtë është sadaka. Të largosh gurë dhe ferra nga rruga, edhe kjo është sadaka...” (Tirmidhiu)

Ebu Lejth Semerkandi ka thënë: “Jep sadaka, pa marrë parasysh nëse dhuron pak apo shumë para, sepse sadakaja ka dhjetë të mira, pesë prej të cilave i takojnë kësaj bote, ndërsa pesë të tjerat i takojnë Ahiretit. Sa i përket të mirave që i takojnë kësaj bote, ato janë:

1- Pastron pasurinë. Pejgamberi a.s. ka thënë: ‘Njeriu gjatë shitblerjes flet fjalë të kota, betohet dhe gënjen. Këto pastrohen me sadaka.’

2- Sadakaja e pastron trupin prej gjynaheve, ashtu siç na mëson Allahu kur urdhëron e thotë: **‘Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën do t’i pastrosh ata dhe do t’ua rrisësh veprat e mira..!’** (Tevbe, 103)

3- Largon belatë dhe sëmundjet. I Dërguari i Allahut ka thënë: ‘Shërojini të sëmurët tuaj edhe duke dhënë sadaka.’

4- Sadakaja i lumturon të varfrit. T’i bësh besimtarët të lumtur është një prej veprave të mira.

5- Shton bereqetin në pasuri. Allahu (xh.sh.), thotë: **‘... Ai ua zëvendëson atë që ju e ndani ndër të varfër..’** (Sebe, 39)

Sa u përket pesë të mirave në Ahiret, ato janë:

1- Sadakaja do t’i bëhet hije dhuruesit të saj në Ditën e Gjykimit, kur nuk ka hije për t’u fshehur nga nxehtësia e madhe e asaj dite.

2- Dhuruesi i sadakasë ka për të dhënë llogari më të shkurtër sesa njerëzit e tjerë.

3- Peshon rëndë në peshoren e punëve të mira.

4- Sadakaja do të bëjë që besimtari ta kalojë urën e siratit sa më shpejt.

5- Rrit gradën e besimtarit në xhenet. (Tenbihul-Gafilin)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Një njeri i cili po ecte rrugës, dëgjoji një zë që vinte nga retë: ‘Vaditeni (ujiteni) kopshtin e filanit!’ Një re u nda dhe u shkarkua duke formuar një pellg, uji i të cilit rridhte drejt një kopshti. Njeriu e ndoqi rrjedhën e ujit dhe ajo përfundoi tek një arë ku punonte një person me shat në dorë, i cili e shpërndante ujin nëpër arë me anë të kanaleve. Personi i parë e pyeti të dytin: ‘Si e ke emrin?’ Ai i tha po atë emër që kishte dëgjuar nga retë. Personi që punonte në arë e pyeti: ‘Përse më pyete si e kisha emrin?’ Ai i tha: ‘Unë e dëgjova emrin tënd të bubullonte nga retë, të cilave u thuhej se uji i tyre do të derdhej tek ara jote!’ Më pas, personi i parë e pyeti: ‘Çfarë bën me këtë kopsht?’

Unë e ndaj prodhimin që jep ky kopsht dhe e dhuroj sadaka një të tretën, ha me familjen time një pjesë të saj dhe pjesën tjetër e shes që të investoj përsëri në kopsht.” (Muslimi)

Ibn Mesudi (r.a.), ka thënë: “Nëse dëshiron ta ruash thesarin tënd aty ku nuk ta vjedh asnjë hajdut dhe nuk do të prishet kurrë, atëherë ndaje sadaka.”

Pejgamberi (a.s.), u ka thënë shokëve të tij: “*Cili prej jush e do pasurinë e trashëgimtarit më shumë se pasurinë e vet?*” Sahabët i thanë: “O i Dërguari i Allahut, nuk ka asnjë prej nesh që të dojë më shumë pasurinë e trashëgimtarit sesa pasurinë e vet.” Pastaj Pejgamberi (a.s.), u tha sahabëve: “*Pasuria juaj e vërtetë dhe e çdo besimtarit është ajo që keni ndarë (që e keni dhënë në rrugë të Allahut), ndërsa pasuria e trashëgimtarit është ajo që keni lënë për vetë.*” (Buhariu)



Qershia

VLERAT KURUESE DHE USHQYESE TË SAJ

Qershia ka origjinë aziatike, ndërsa në Evropë është përhapur rreth shekullit të dytë. Në Lindjen e Largët, sidomos në Japoni, pema e qershisë është shumë e përhapur dhe periudha e lulëzimit të saj është një nga më të bukurit e vitit. Shumë turistë vijnë nga çdo vend i botës për të parë “hanamin”, që i përkthyer në shqip është “shikimi i luleve”.

Qershitë janë shumë të pasura me vitamina, sidomos me vitaminën C. Qershitë piqen dhe gjenden nëpër tregje në periudhën maj-korrik.

VETITË E QERSHISË

Qershia përmban vitaminë C, A dhe potas. Por, në të gjenden në sasi shumë të vogla edhe minerale, polifenolë dhe fibra. Ndhmon shumë në funksionimin e aparatit tretës dhe ka efekte antiinflamatorë.

Është një frut shumë i mirë për ata që ndjekin dieta për dobësim, pasi ka shumë pak sheqer dhe kalori. Përmban flavonoidë që kanë aksion antioksidant dhe luftojnë radikalet e lira.

Sipas disa studimeve, vetitë e qershisë ndihmojnë

edhe me problemet e kyçeve, që vijnë nga artriti.

Një veçanti e qershisë është përmbajtja e lartë e melatoninës, që njihet për balancimin e ciklit gjumë-zgjim. Melatonina është gjithashtu një antioksidant i fuqishëm, që ka efekt parandalues ndaj tumoreve të ndryshme. Një veti tjetër e saj është edhe dobia që ka për të luftuar sëmundje të zemrës.

Lëngu i qershisë këshillohet për ata që vuajnë nga pagjumësia, pikërisht sepse përmban melatoninë.

Edhe bishtat e qershive kanë efekte pozitive në shëndet dhe mund të bëhen çaj, pasi kanë veti diuretike.

VLERAT USHQYESE

Qershia përmban ujë 77-87% të masës së saj, sheqer në nivelin 11-22.5%, 0.1% yndyrna dhe 0.7-1% proteina. Në këtë frut ka disa vitamina, por më shumë vitamina C dhe A. Pas potasit, që është minerali më prezent i qershisë (222 mg. për 100 g. qershi), ka fosfor (21 mg. në 100 g.), calcium (13 mg.) dhe magnez.

Shëndet i mirë nga lëngu i gjetheve të qershisë

Qershitë kanë një ngjyrë të kuqe deri në vishnje kur ato piqen. Ky frut është goxha i njohur si një burim i shumë vlerave ushqyese.

Në shumë raste qershia përdoret në formën e një çaji bimor.

Disa nga vlerat që përmban lëngu i gjetheve të qershisë janë vetitë e tij si antioksidant, përmbajtja e vitaminës A, vitaminës C si dhe minerale.

Sipas disa të dhënave të mbledhura, më poshtë do të gjeni disa nga vlerat e lëngut të gjetheve të qershisë.





DETOKSIFIKUES

Trupi i njeriut përmban shumë helme të mbetura nga shpërbërja e ushqimeve apo produkteve të ndryshme.

Këto toksina duhen të pastrohen në mënyrë që trupi të jetë i shëndetshëm dhe të shmangen sëmundje të ndryshme.

Një mënyrë e detoksifikimit është konsumimi i çajrave bimor.

Përbërësit natyral që gjenden në çajin e gjetheve të qershisë bëjnë që procesi i detoksifikimit të ndodhi sa më natyrshëm.

TRAJTON ÇEKULIBRIMET E ACIDIT URNIK

Ky çaj mund të përdoret dhe si një "ilaç" për trajtimin e acidit urik.

Pasi kjo pije përmban antho-cianin e cila shërben për të ulur nivelin e inflamacionit të kyçeve.

Njerëzit që vuajnë nga dhembja e nyjeve, kockave kanë si shkaktarë kryesor një mosbalancim të acidit urik në organizëm.

QETËSON DHIMBJET

Një tjetër dobi e çajit të gjetheve të qershisë, është lehtësimi i dhimbjeve.

Nëse ndjeni dhimbje të trupit, përpquni të pini sa më shumë nga ky çaj.

Do të shihni që dhimbja do të lehtësohet gradualisht. Gjithashtu mbetet një metodë natyrale, që mund të praktikohet nga kushdo, pa pasur efekte anësore.

NJË GJUMË PA PROBLEME

Kjo pije është e përshtatshme për dikë që ka problem me gjumin.

Kjo ndodh sepse në këtë çaj gjendet melatonina, e cila ndihmon në një gjumë të rehatshëm.

Substanca e përmendur, gjithashtu është efikase për nxitjen e trurit.

PËR NJË LËKURË TË BUKUR

Nëse doni që të keni një lëkurë të shëndetshme, por doni që të jetë diçka jo me shumë kosto, mund të pini këtë çaj bimor.

Antioksidantët që ka fryti i qershisë e ndihmojnë lëkurën tuaj të jetë me e re.

Lëngu ose çaji i gjetheve të qershisë parandalon dhe problemet e lëkurës, siç janë lëkura e thatë, kruajtje ose sëmundje të tjera.

Në fakt, nëse konsumoni qershi çdo mëngjes parandaloni dhe plakjen e lëkurës.

NJË SUPER ANTIOKSIDANT

Antioksidantët janë shumë të nevojshëm për organizmin.

Duke konsumuar ushqime dhe pije të pasur me antioksidantë, është një mënyrë për t'i përfutur në trup.

Një nga pijet është dhe çaji bimor i gjetheve të qershisë.

PAKËSON DHIMBJET E MUSKUJVE

Nëse vuani nga dhembjet e muskujve, apo keni një bllokim të tyre pas palestrës, mund të konsumoni këtë bimë.

Çaji i gjetheve të qershisë ka disa përbërës natyror që lehtësojnë dhimbjet.

Si të përgatisni lëngun e gjetheve të qershisë:

Zieni 250 ml ujë dhe më pas hidhni një lugë çaji me gjethe të thata qershish.

Ziejini së bashku për 3-5 minuta, kullojeni dhe shtoni ëmbëlsuesin e preferuar.

Rekomandohet të konsumohet një herë në ditë.



SI NDIKON MIKROGRAVITETI NË TRUPIN E ASTRONAUTËVE

Fillimet e një astronauti duken si një karrierë emocionuese dhe joshëse. Por a keni menduar ndonjëherë për rreziqet me të cilat përballen këta njerëz duke u ekspozuar ndaj kushteve ekstreme, siç janë rrezatimi dhe mikrograviteti?

Të jetuarit dhe të punuarit në mikrogravitet mund të ndikojnë në tërë trupin tuaj në mënyra të ndryshme. Nga ana tjetër, trupi i njeriut është i aftë të adaptojë fiziologjinë e tij për të mbijetuar në kushte të ndryshme.

ÇFARË ËSHTË MIKROGRAVITETI?

Mikrograviteti është gjendja në të cilën njerëzit ose objektet duket se janë pa peshë.

Ju mund të keni dëgjuar se nuk ka gravitet në hapësirë. Kjo nuk është mjaft e vërtetë. Në fakt, një sasi e vogël e gravitetit mund të gjendet kudo në hapësirë.

Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor gjendet mbi planetin tonë në një lartësi midis 320 dhe 400 kilometra mbi Tokë. Në atë lartësi, graviteti është shumë i pakët. Arsyeja e vërtetë që njerëzit dhe objektet “notojnë” në orbitë është sepse ata janë në rënie të lirë.

Ndonjëherë, astronautët duhet të kalojnë muaj të tërë në mikrogravitet, kështu që NASA dhe agjencitë e tjera hapësinore studiojnë me kujdes efektet e mikrogravitetit, në mënyrë që të mbajnë astronautët të sigurt dhe të shëndetshëm.

“Astronautët që jetojnë në stacionin hapësinor kalojnë muaj në mikrogravitet. Astronautët që udhëtojnë në Mars gjithashtu do të kalonin muaj në mikrogravitet duke udhëtuar përmes Planetit të Kuq”, raporton NASA.

CILAT JANË PASOJAT SHËNDETËSORE TË MIKROGRAVITETIT NË TRUPIN E NJERIUT?

Efektet në sistemin kardiovaskular

Nën mungesën e gravitetit, duke qëndruar në këmbë, shpërndarja e lëngjeve krijon presion më të lartë arterial në këmbë (200 mmHg) sesa në kokë (70 mmHg).

“Në Tokë, me peshën e saj normale, të gjitha ndryshimet në sjellje – të tilla si kur shtrihen, uleni ose qëndroni në këmbë, si dhe ndryshimet në nivelet e aktivitetit, siç janë përmes ushtrimit – kërkojnë që zemra dhe sistemi vaskular të rregullojnë presionin e gjakut dhe shpërndarjen duke rregulluar rrahjet e zemrës (rrahjet në minutë) dhe sasinë e gjakut që nxirret nga zemra. Këto rregullime sigurojnë vetëdije të vazhdueshme duke siguruar oksigjen në tru ose aftësi të vazhdueshme për të punuar”, përshkruan NASA.

Efektet në sistemin muskuloskeletor

Për shkak të mikrogravitetit, muskujve të astronautëve nuk u kërkohet të mbështesin peshën e tyre trupore. Për shkak të përdorimit të zvogëluar, ata mund të vuajnë nga atrofia e muskujve. Kjo mund t'i bëjë ata të paaftë të bëjnë detyra që kërkojnë fizikisht gjatë një misioni.

Është e njëjta ndjesi që ndjen pasi të kalosh tërë



ditën shtruar, dhe më pas mundohu të bësh një shëtitje menjëherë. Ndihet sikur muskujt tuaj nuk mund ta kryejnë punën e tyre siç duhet.

Për të parandaluar këto probleme shëndetësore, astronautët ushtrojnë rregullisht, duke siguruar ushtrime shumë të nevojshme në mjedisin e mikrogravitetit.

SI MUND TË PËRSHTATEN ASTRONAUTËT NDAJ EFEKTEVE TË MIKROGRAVITETIT?

Sistemet nervore të astronautit zakonisht përshta-

ten shumë shpejt. Deri në ditën e tretë të fluturimit, shumica e tyre nuk mund të ndiejnë sikletin që ndiejnë kur arriten për herë të parë në hapësirë.

Pasi të kthehen në Tokë, ata do të duhet të përballen me një proces tjetër të përshtatjes së sistemeve të tyre fiziologjike në gravitet përsëri.

Mirëpo trupi i njeriut është një makinë e jashtëzakonshme që mund të bëjë gjëra të mahnitshme. Sigurisht, kërkon shumë stërvitje dhe përkushtim, dhe kjo është diçka në të cilën shkëlqejnë astronautët.

STARLINK LËSHON ME SUKSES 60 SATELITË TË TJERË NË ORBITË

Programi Starlink i Elon Musk ka lëshuar me sukses 60 satelitë tjerë në orbitën e Tokës. Sipas mediave të huaja, kompania SpaceX e posedon lejen nga Komisioni Federal i Komunikimit (FCC), për një vjësori prej 12 mijë satelitësh – dhe shpresojnë se do të furnizojnë me internet të gjithë banorët e Tokës.

Lansimi nga Starlink mbledh në total 482 satelitë në orbitë, dhe kompania thotë se do të jetë në gjendje të ofrojë shërbim ‘të moderuar’ kur të

arrijë në 800. Projekti ka marrë kritika të gjera nga astronomët, për ndotjen e pamjes natyrore të qiellit, pasi satelitët janë shumë reflektues.

“Qëllimi i Starlink është krijimi i një rrjeti që do të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve të internetit edhe për ata që nuk janë të kyçur, dhe të sigurojë internet të përballueshëm në të gjithë globin”, tha Kennedy Space Center në një postim.

SATELITI I PARË VËZHGUES TURK DO TË LANSOHET NË VITIN 2021

Sateliti i parë për vëzhgimin e tokës të prodhuar nga Turqia me rezolucion të lartë është planifikuar për lansim vitin e ardhshëm, thanë sot zyrtarët turq, raporton Anadolu Agency.

Sateliti i ri, i quajtur “Imece”, është një hap shumë i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të sektorëve ushtarakë dhe civilë të Turqisë për imazhe me rezolucion të lartë nga teknologjia vendore, thanë pjesëmarrësit në një takim të organizuar nga Ministri i Industrisë dhe Teknologjisë, Mustafa Varank.

Punët përmblyëse rreth montimi të satelitit po bëhen bashkërisht nga ministritë e Teknologjisë, Mbrojtjes dhe Transportit të Turqisë. Pas përfundimit të suksesshëm të testeve, është vendosur të fillojë prodhimi i satelitit.





Souvenir Albania



*tregton me shumicë dhe pakicë
punime artizanale të cilësisë së lartë.*





"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orndive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëplaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mveshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress te balloreve me folje te pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina te persosur kualitet dhe cilësi te lart.






VILA DANTE
RESTORANT

 ADRESA: TUSHEMISHT, POGRADEÇ

SHOPPING HOUSE


ADRESA:
RRUGA QEMAL DRAÇINI
TEK SAHATI, SHKODËR

ÇAPA[®] musluk



REYHAN

Kosovë për herë të parë
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera
në KOSOVË

ELEGANCË, BUKURI, CILËSI DHE 5 VJET GARANCI ME ÇMIME TË VOLITSHME



ISO 9001



5 Yıl Garanti

www.capamusluk.com.tr

www.reyhan-ran.com

Armatürde Dünyaya Vurulan Marka

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni
përmes telefonave dhe web faqes.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)
1
NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Për shkak të veprave
(të këqija) të njerëzve
janë shfaqur në tokë
e në det të zeza
(bela, skamje, katastrofa,
humbje e bereqetit etj.),
e për ta përjetuar
ata një pjesë të asaj
të keqeje që e bënë,
ashtu që të tërhiqen
(nga të këqijat).”

(Rum, 41)